



*E bukur është shtëpia që pasqyron shijen tonë për jetën, kërkon dritë, ajër, lëvizje, hapje.
E bukur është shtëpia që lejon të jetosh me qiellin dhe kurorat e pemëve.
E bukur është shtëpia që ka dritë në vend të hijeve.
E bukur është shtëpia, në të cilën dhomat nuk japin idenë e burgosjes...*

Sigfried Giedon

Autore: Dr. Vera Bushati

Me pjesëmarrjen e: Albana Tollkuçi dhe Ernest Shtepani

Titulli i librit: Vilat e Tiranës, gjysma e parë e shekullit XX

Botimi i parë, Qeshor 2012

UNIVERSITETI POLIS

Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe e Politikave
të Zhvillimit Urban, Tiranë

Kopertina dizajnuar nga: Sonia Jojic, Drilon Shamolli

Dizejnim i librit: Drilon Shamolli, Gerti Struga

Ripërpunoi materialin: Ada Lushi, Anduena Dragovi, Drilon Shamolli, Gerti Struga

Redaktor letrar: Keti Sula

Shtypur nga:

Për çdo informacion kontaktoni:

UNIVERSITETI POLIS

Rruga “Bylis 12”

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Kashar, Tiranë, Shqipëri

KP 2995, Tirana Albania

Tel: + 355 (0) 4 24074 - 20 / 21

Fax: + 355 (0) 4 2407422

Cel: + 355 (0) 69 40- 88 111

web: www.universitetipolis.edu.al

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Çdo pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet me asnjë formë, elektronike apo mekanike, me fotokopje, skanime apo mjete të tjera pa marrë leje me shkrim nga Publikuesi.

Dr. Vera Bushati

Vilat e Tiranës

gjysma parë e shekullit XX

Tiranë, 2012



Të njohim vilat e Tiranës

Ky studim ka patur si sfidë të tij zgjerimin e kufijve të evidentimit e vënies në mbrojtje të një sërë ndërtimesh, që i përkasin fillimit të shek. XX, për të cilat shumë pak është folur e aq më pak vlerësuar e mbrojtur këto vepra.

Ndërmarrjet modeste të bëra nga F.I.N. (Fakulteti i Arkitekturës, viti 1988), me rezultat botimin “Historia e Arkitekturës në Shqipëri” (vitet 1912-1944) me autorë K. Miho, V. Bushati, J. Sukaj, P. Thomo, ishin një thyerje tabuje për kohën kur arkitektura e kësaj periudhe nuk studiohej e aq më pak të mësohej. Pas vitit 1992 filluan të evidentoheshin vepra monumentale të Tiranës si Bulevardi i Madh, Kompleksi i Ministrive, ndërtimet rreth sheshit “Nënë Tereza” etj. Por, pak ose aspak është folur për kategorinë bazë të formulimit të qytetit të Tiranës, banesën individuale.

Ndërmarrja e iniciativës për ta studiuar këtë kategori ndëtimore, u bë një nevojë imperative edhe për faktin se sot gjithnjë e më shumë ato po zëvendësohen në “këmbim të dy apartamenteve e një dyqani”¹ duke mos mbetur “In situ”, pjesë të arkivit material të qytetit të fillim shek. XX. Një pjesë e mirë e tyre kanë qënë banesa të thjeshta, pa vlera të veçanta, por

ndërmjet tyre ka patur ndërtesa, që pa frikë mund të hyjnë në kategorinë e monumenteve të kulturës.

Duke u ndeshur me këtë fenomen, do të doja të ndalesha në faktin e njohur se cilët janë objektet që përbëjnë kategorinë që quhet monument kulture. Etimologjia e fjalës “monumentum” rrjedh nga folja monere (latinisht) që do të thotë “të bën të rikujtos”,

që ndikon një instrument të kujtesës. Monumenti është një artefakt i çfarëdo natyre e dimensionit që risjell me anë të kujtesës etapa kohore, njerëz, ngjarje, rite, besime që janë themeli gjenealogjik i identitetit të një vendi.

Për gjatë kohës, kemi të afirmuara tre praktika të qasjes ndaj monumenteve: të studiuarit, të konversu-



Fig 1. Mozaiku antik i një vile në Tiranë



Fig 2. Ambasada e Vatikanit

¹ Film grek me të njëjtin emer



arit, të restauruarit. Studimi si etapë e parë krahas evidentimit, rilevimit, përshkrimit, duhet të marrë dritën e botimit për të ndërgjegjësuar gjithë komunitetet për vlerat që mbartin këto ndërtime. Deri nga mesi i shek. XIX, kudo në botë studimi i monumenteve përfundonte deri këtu. Historikisht është konstatuar se vetëm në fund të shek. XIX u hartuan projekte konservuese e restauruese. Sot në plan të parë del nevoja jo vetëm e kthimit të monumenteve në muze, por kërkohet që ato të rivitalizohen, duke u

ripërdorur madje edhe me ndryshim destinacioni, por pa prishur tërësinë arkitektonike. Projektet e quajtura “restyling” kanë zënë vend edhe në Tiranë. Ato shpesh janë të kujdesshme, si për shembull vila Ambasador, por ka nga ato që kanë tjetërsuar konceptin bazë si vila Nr 14, rruga “Asim Zeneli” (zona 11) me Ark. S. Luarasi apo vila Nr 11, “Asim Zeneli” (zona 11), Ark. Q. Butka (Piceri ERA). Këto “restyling” të gabuara ndërhyjnë në integritetin e monumenteve duke prishur rikujtesën, ndaj riteve shoqërore e

kushteve simbolike që ato risjellin.

Monumentet që do të marrim në konsiderate në këtë studim janë vilat ose të quajturat banesa individuale.

Çfarë përfaqësojnë këto vila?

Të jetosh në banesë individuale është një dimension, që i përshkon të gjitha kulturat, të gjitha kohërat. Banesat greke me peristil, domuset romake, vilat paladiane e deri ndërtime të kohëve të fundit, përbëjnë atë që quhet vilë (fig 2,3 & fig 4). Varieteti i këtyre vilave është përcaktuar nga ezigjencat njerëzore të kohës, të cilat kanë përcaktuar planin, volumin, mobilimin e mbi të gjitha pozicionimin sipas një projektimi më të gjërë territorial. Banesat individuale me varietetin e tyre, evidentojnë nivelin ekonomik, social të banorëve, ku kryqëzohen shumë faktorë ambientalë, etnikë dhe të zhvillimit.

Ky ka qënë edhe objektivi i punës për stafin akademik dhe studentët e Universitetit POLIS për të arritur të përzgjedhë, klasifikojë e studiojë banesat e Tiranës në harkun kohor që prej fillimit të shek. XX deri në përfundimin e luftës së II-të botërore, pas së cilës ndryshon dhe mënyra e ndërtimit të banesës në bazë të kushteve të reja politiko-ekonomike).

Vilat, që do marrim në konsideratë, kondicionohen nga zgjidhje formale, të adoptuara dhe prej materialeve që dëshmojnë në strukturat e reja, të lid-



Fig 3. Vila Sarajet



Fig 4. Vila Dr. Simonidhit



Fig 6. Rruga Barrikadave

hura këto me evolucionin e qytetërimit.

Për këtë studim jemi orientuar “nga teoria historike pozitiviste”² për të dalluar një arkitekturë vizive monumentale, ndaj asaj të përcaktuar nga materialet e përdorura dhe teknikat konstruktive të kohës, kur janë zbatuar këto ndërtime.

Duke patur parasysh se Tirana e sotme është një qytet me një stratigrafi kohore, duke filluar nga Mesjeta e deri në ditët e sotme, ia vlen t’i studiojmë mirë këto, me synimin e perspektivës për të krijuar energjikisht një identitet të ri. “Kush dëshiron të njohi Tiranën, atë të vërtetën, duhet të dijë të vështrojnë, të

2 Rykwert La maison d’Adam au Paradis, Paris 1976 fq.16)

dëgjojë, të shprehet me emocione të forta”³

Tirana që në fillim të shek. XX ka qenë një qytet me zhvillim progresiv.

“Proçesi i ndryshimit të formës urbane dhe sociale është i përshpejtuar, gjë që e bën të jetë kaotike. Tirana ende mund të konsiderohet si një “binom” i lexueshëm i fazave të ekzistencës së zhvillimeve organike spontane me pjesën e “qyteteve të themeluara” ose “të planifikuara.”⁴

Gjatë ekspeditave vëzhguese e studimeve të materialeve të botuara, qytetin mund ta ndajmë në dy

3 P. Di Nardo “Trace di un futuro” fq. 30 Aud. Nr. 11 2008

4 S. Dharmo Forum A+P 5 fq. 26, 2006

zona të dallueshme qartë: atë që përbën Tiranën me gjithë bagazhin historik, që karakterizohet nga një rrjet i parregullt dhe Tiranën e Re që u shtri në Jug të rrjedhjes së Lanës me rrjet rrugor ortogonal (fig 5). Sigurisht që disa arterie të realizuara për përshtatjen ndaj zhvillimit të qytetit kanë ushtruar një ndikim të rëndësishëm edhe në fizionominë arkitektonike të tipologjisë që po marrim në shqyrtim.

Në zonën e Tiranës historike krahas banesave tradicionale të ndërtuara në mënyrë spontane nga mjeshtra popullorë bënë pjesë dhe vila, që përbëjnë shembuj të spikatur të arkitekturës bashkëkohore. Në zonën e Tiranës së Re dominojnë vilat e ndërtuara me arkitektë vendas e të huaj sipas principeve dominuese të kohës.

Gjatë rrugëve të hapura krijohen banesa individuale me oborr nga ana e brëndshme dhe me pamje nga rruga. Në rrugën e Kavajës, rrugën 28 Nëntori, rrugën e Barrikadave, u krijuan këto tipe banesash të ngjashme në të gjithë kuadrin ballkanik të implementuara në qytetet shqiptare si Shkodra, Vlora, Manastir, Prizren, Kostur etj (fig 6).

Duke i parë në tërësinë e tyre banesat individuale mund t’i ndajmë në disa variante: në vila tradicionale të ndërtuara me mjeshtra zejtarë të kualifikuar që ndërtonin kudo në Shqipëri (dibranët) dhe në vila me arkitektë, të cilat karakterizohen nga një zgjidhje



Fig 5. Harta e Tiranës

neoklasike, ekletike si dhe zgjidhje racionaliste, të ngjashme me simotrat bashkëkohëse në Europë (fig 2,3,4).

Sentimentalizmi skenografik për të vlerësuar si duhet ambientin urban të Tiranës së Vjetër, na çon në përcaktimin puritan të një “qyteti kopësht”.

Banesa tradicionale që ndodhet në zonat e Tiranës historike e ka zanafillën tek banesa me “shpi zjarri”. Shembulli më i spikatur është ajo e Sali Shijakut. Kjo banesë popullore dallon për kompozimin e saj planimetriko-vëllimor, ku spikat hapësira e brëndshme e shtëpisë së zjarrit, që shkon në lartësinë e dy kateve. Funkcioni i kësaj banese është i lidhur me formacionin ekonomik-shoqëror feudal dhe familjen e madhe patriarkale. Për përcaktimin e kufirit të poshtëm kohor mungojnë të dhëna dokumentare. Në qytetin e Tiranës ajo ka qenë prezente deri nga mesi i shek. XX.

Elementi bazë i kompozimit ka qënë shtëpia e zjarrit me përdorim nga mbarë familja. Rreth saj janë vendosur dhomat e çifteve. Banesa me shtëpi zjarri për gjatë dy kateve së bashku me oborrin, kopshtin rreth saj është tipike për një ekonomi natyrore. Karakteristika të saj janë vendi i vatrës, që shpesh ka një karakter primitiv pa tymtar, duke e lënë tymin të kalojë jashtë çatisë, sepse oda e zjarrit nuk ka tavan. Në çati ndeshet baxha, që shërben për ndriçim. Dyshemeja realizohej prej dheu të ngjeshur. Elementi



Fig 7. Vila tek rruga “Barrikadave”



Fig 8. Zona 1, Vila nr. 25

ndërlidhës me kthinat që qëndrojnë në nivelin e dytë është shkalla dhe mafili (ballkon, galeri) , i cili qëndron arkitektonikisht si një element horizontal dhe ndërpret vertikalishtin e shtëpive të zjarrit. Edhe pse në transformim të përhershme për të harmonizuar me kushtet e kohës, kjo banesë ka shkuar drejt shuarjes, por ideja e një bërthame qëndrore, rreth së cilës vendosen mjedisë të tjera, mbetet edhe sot, si koncept i arkitekturës bashkohore.

Në rastet si vila pranë shkollës Sami Frashëri (fig 7) shtëpia tradicionale është adoptuar mirë ndaj mënyrës së jetesës së sotme. Ai, që sot është elementi më romantik, është kopshti i zhytur në gjelbërim dhe marrëdhënia e banesës në raport me të. Sot në këtë zonë historike ka shpesh ndërhyrje të pastuduara, që krijojnë një kontrast midis konfiguracionit të çatave pa fund e ndërtesave të larta të ndërnuara, që na obligon të njohim bukurinë e të parëve (fig 10). Në mjaft vila vihet re “marja në krahë” e traditës dhe modeleve të konfirmuara të saj, si p.sh, banesat e quajtura me qoshk (fig 8). Gjithnjë këto përbërës kanë qenë interpretuar si substanca bazë, të përshtatura ndaj përdorimit me gjithë mjetet figurative, pamjet efikase që janë terma tipike të gjuhës shprehëse. Këto realizime me shumë kreativitet, kanë ditur të adaptohen ndaj klimës, terrenit, rrethanave që i lindi dhe janë mbajtur me një këmbë nga tradita. Trashëgimia është si një



Fig 9. Fotografi e rrugës “Jul Variboba”

tempull që ja vlen ta mbajmë në këmbë pavarisht nga kontraditat e sotme.

Gjatë harkut kohor midis dy luftërave botërore e veçanërisht, në vitet 1930-1940 pati një zhvillim të Tiranës “në drejtim të qytetit të themeluar ndaj atij spontan”. Shëmbujt më ekzemplarë janë ato të ndërnuara në Tiranën jugore, që ndahet nga lumi i Lanës. Këtu ndaheshin në vila të vendosura në parcela të fragmentuara, ku edhe vendoset midis gjelbërimit të oborrit dhe kopshtit. Vilat janë kryesisht dy katëshe, me hyrje direkte nga rruga, të rrethuara me mure ndarëse, ku në anën e rrugës mbizotërojnë kangjellat. Vilat janë të ekzpozuar ndaj rrugës, ku spikat hyrja, të cilës i kushtohet një vëmendje e veçantë (fig 9).

Zgjidhjet e tyre planimetrike e vëllimore kanë një përshtatje ndaj mënyrës së jetesës e statusit social të poseduesit të vilës.

Zona në jug të rrjedhjes së Lanës, që njihet me emrin Tirana e Re (fig 13, 14), ishte programuar për të patur një rrjet rrugor ortogonal me parcela të ndara mirë, duke patur mundësi optimale për projektimin dhe zbatimin e vilave të reja. Të gjitha këto parcela iu dhanë me kredi nëpunësve të shtetit për të ndërnuar banesat e tyre sipas një legjislacioni të mirë përcaktuar (p.sh, vila Dr. Simonidhit fig 12. Projektet hartoheshin nga arkitektët të shkolluar jashtë Shqipërisë, ose dhe të huaj. Për sa i përket tendencave stilistike

Ordera dhe Qoshe








Fig 10. Zona e pazarit të ri

1920

1980



Fig 11. Zona 2, Vila nr. 10

vilat paraqiten më një variacion të pafund. Stile të ndryshme shfaqin aftësitë referuese dhe fermentet kulturoret që karakterizojnë jo vetëm Tiranën, por gjithë Europën në vitet 1920-1930.

Arkitektët, artistët, ndërtuesit i kanë ofruar në këtë periudhë familjeve tiranase më të mirën e eksperiencës së tyre teknike e krijuese, në tërësinë e qytetit, brenda kopshteve, në mes të gjelbërimit, apo dhe gjatë rrugës janë ngritur rezidenca të stileve arkitekturore nga më të ndryshmet orientale, neoklasike eklektike e moderne.

Banoret e Tiranës kryeqytet kërkonin të shpreheshin arkitektonikisht me qasje në tendencat nacionale, që përbënin ndërjegjen intuitive, si dhe me shfaqje të admirueshme të stilit modern. Në mjaft objekte shohim një rikuperim të traditës të shtëpive tiranase, duket iu qasur eksperiencave moderne racionaliste (fig 13).

Ndarja me të kaluarën pa kuptuar mirë fenomenin urbano ambiental që i lidh ato shfaqje, pa analizën e abstraksionit intelektual nuk do të na lejonte të kup-

tonim raste shëmbullore të arkitekturës moderne⁵

Zona jugore i afron vëzhguesit struktura ndërtimi të larmishme, por inkuadrimi natyror i ofron kaltërsinë e qiellit dhe gjelbërimin, që përbejnë një trinitet të vecantë. Idea e qytetit kopësht e dalë në fund⁶ të vitit 1898 prej Howardit, për të përmirësuar rritjen kaotike të qendrave urbane, duke programuar lejimin e grupimeve të ndërtimeve në mes të gjelbërimit rreth qytetit, iu përshtat mjaft mirë ndërtimit të Tiranës së Re.⁶ Këto banesa të lagjeve të sistemuara mund të përvetësonin stile arkitekturore të ndryshëm nga ato eklektike (fig 2), neoklasike (fig 13), moderne (fig 4), por zgjidhjet e tyre janë bërë në përshtatje me funksionin e fqinjësisë së tyre me ndërtesat përreth.

Kristofer Alexander shkruan: “Arti i të ndërtuarit, që i qëndron kohës në trajtën e monumentit, është ai që njeriu e ndjen veten mirë dhe që është i pranuar nga fqinjësia dhe banorët e afërt”. Pavarsisht nga stili arkitekturor i gjelbëruar për secilën vilë, kuar-

5 S.Muratoni, Studi per una operante Storia ursana di Venecia Roma 1959 fq10

6 S.Giedon Spazio tempo Architectura, Milano 1954 fq 658



2011

tieret janë koherentë si nga madhësitë, raporti bosh plot, marrëdhënien me rrugën dhe kushtet jetësore. Arkitektura e këtyre vilave është e respektueshme dhe e admirueshme për cilësitë thelbësore dhe arritjet estetike e teknike.

Cilësia e jetës në këto zona krijonte mundësinë e një ekuilibri të përsosur fizik e mental.

“Mos marrja parasysh e nevojave biologjike e psikologjike i ka sjellë jetës së qyteteve shumë dëme”⁷

Të zotëroje një vilë midis kopshtit në vitet 1920-1940 të shek. XX do të thoshte të kishe një status simbol që përbëntë një shenjë dalluese sociale” si dhe një azil paqej, ku harrohen hallet dhe jeta rrjedh e qetë”⁸

Banorët e këtyre vilave ishin politikanët, tregtarët, profesionistët, nëpunësit e shtetit, që tërhiqeshin nga mundësia e “belvivere” në vila. Sigurisht, në ditët e sotme, vila si kategori ndërtimore nuk është e këndshme në metropol. Ndoshta sot ekzistenca e një kopshti privat është anakronik. “Jeta e sotme kërkon komoditet sho-

7 R. Neutra “ Construire pour survivre Castaman 1971 Paris, Fq.157

8 E. Ingasiao Lecce 2006 Ville del Salento



Fig 12. Zona 11, Vila nr. 11




Fig 14. Metropolitani

qërör me më shumë kopshte, parqe publike”⁹

Në vilat e kohës vërejmë zgjidhje të përshtatura mjaft mirë ndaj kushteve të reja të jetës. Ndarjet e ambienteve të ditës, natës, atyre të shërbimit, të qëndrimit dhe çlodhjes janë të grupuara e lehtësisht të komunikueshme.

Interesante janë interieret e vilave. Ato transformohen krejtësisht duke zëvendësuar arredimin fiks me atë të lëvizshëm.

9 H.P. Flug Ecran Tour Colines Dduond Paris 1971 fq 8.



Fig 13. Rruga “Jul Variboba”

Principet e porositësit, tashmë të reja, kanë ndikuar për një rrugë alternative ndaj asaj tradicionale.

Interieret çlirohen nga fashaturat e drunjtja tradicionale dhe pajisen me mobilje të përpunuara, që i përgjigjen shijeve dhe kërkesave të kohës. Interieret në thelb paraqesin historinë dhe shijen e personazhit që i disponon si dhe raportin e tij me habitatin. Në vilat e reja “mishërohen” përmasat e mendimeve të atyre që jetojnë si edhe sensi për një jetë të sigurt e të qetë.

Kolltukët, dollapet, kanapetë, tavolinat, bufetë, pianot, oxhakët dhe orendi të tjera flasin për një



Ballkon me balustër



Dritare



Fig 16. Ambasada Amerikane, rruga “Elbasanit”



Fig 15. Vila e Qemal Butkës

nivel të lartë të jetës të ngjashëm me bashkëkohësit që jetojnë jashtë Shqipërisë. Thjeshtëzimi i këtyreve kontrastohet shpesh nga materialet luksoze të përdorura si mermeri, druri i rrallë, qelqi i abazhurëve etj (fig 17, 18, 19 & fig 20)

Stilisti i njohur bashkëkohor Paul Poiret thekson se “sipërfaqet e pastra, materialet e zgjedhura, qartësia, rregulli- kjo është shtëpia ime logjike e gjeometrike. Këto mënyra jetese dokumentohen edhe në fotot e kohës, ku mund të krijojmë një kontest urban dhe jetësor. Fotografia pas Luftës I Botërore si shprehje e veçantë e artit, bëhet instrument për shtresa të ndryshme sociale, duke ndihmuar të zbulohet jeta reale dhe kërkesat për mirëqënie. Këto dëshmi të kohës faktojnë edhe shkallën e zhvillimit të fotografisë, ku mjeshtrit dalin nga laboratorët e tyre dhe bëjnë reportazhe për të dokumentuar evente e ndërtime të ndryshme, por nuk mund të kuptohet gjithë ky zhvillim i shtëpisë individuale pa marrë parasysh faktorin e specialistëve të shkolluar në hartimin e projekteve arkitekturore e konstruktive të kohës.

Përdorimi i materialeve të reja, e veçanërisht betonit të armuar, kërkojnë llogaritje të imta dhe zgjidhje të skemave konstruktive racionale.

Kontributi i arkitektëve dhe inxhinierëve luajti një rol të rëndësishëm në arkitekturën e vilave. Ato përfaqësonin një klasë profesionalistësh të përgatitur teorikisht, të përditësuar me teknikat e reja dhe të formuar me ide novatore në shkolla prestigjioze.

Arkitektët shqiptarë ishin projektuesit e shtëpive dinjitoze. Do të vemë në dukje rolin e madh të arkitektëve, si S. Luarasi, A. Lufi, Q. Butka, K. Sotiri, Dh. Dhespoti, H. Kerciku etj. Këta arkitektë i përkasin bashkësisë së intelektualëve shqiptarë të pas pavarësisë, e cila e formuar përgjithësisht në perëndim, ishte natyrisht mbështetje e sigurt për përparimin e vendit.¹⁰

Këta arkitektë pionerë dhanë kontributin e tyre pikërisht në vitet, kur edhe arkitektura europiane ndiqte shinat e Arkitektures moderne. Arkitektët shqiptarë shfaqën “vlera avanguardë” në dizajnin arkitekturor, si në plan, volum, marrëdhënie interier-



Fig 17. Parapet shkallës, Zona 11, Vila nr. 11



Fig 18. Tavolinë për makinë shkrimi

Shkallë interieri dhe eksterieri







Fig 19. Mobilje të Ambasadës Amerikane

eksterier dhe në simbiozën midis traditës popullore e rajonale me karakterin minimalist të arkitekturës moderne. Sigurisht veprat e arkitekturës shqiptare në harkun kohor 1920-1940, duke ecur në harmoni me ato evropiane, përfaqësojnë stile hibride e influenca bashkëkohore.

E rëndësishme është se ndyshe nga krijimtaria në arkitekturën zyrtare që përfaqon stilin neoklasik, arkitektët vendas gjetën shprehjen e tyre të plotë pikërisht në trajtimin e vilave të Tiranës.

Nga hulumtimet në terren e në arkivë, kanë spikatur emra të arkitektëve të huaj si Bruzini, Nathan Wyeth, që ndërtoi ambasaden amerikane (fig 18) duke qënë dhe projektuesi i zyrës ovale të Shtëpisë së Bardhë apo si arkitekti, që projekttoi Vilën e Dr. Simonidhit (fig 13).

Arkitektët italianë luajtën një rol të veçantë me idenë e “romanizimit” të Tiranës, që parapërgatitej t’i ankesohej Italisë Fashiste. Ndërtimi i grup banesave

të quajtura kompaunde, si pallatet e Xhenjos, Avacionit, Lanës Merkati etj. Me apartamentet sinjorile, komode krahas frymës racionaliste, ka në tendencë për të mishëruar imazhin e pushtetit, i cili evolon nga ëndëruet romak perandorak, në atë imperial fashist. Të gjitha mjetet kompozicionale, e teknikat ndërtimore, cilësisht të përsosura, janë vënë në shërbim të kësaj ideje qëndrore.

Përsa i përket galerive linguistike shohim kapitete, pilastra, qoshe, mensola që me logjikë paraqesin rolin valent, simbolik, statik e viziv. Shpesh dekorit prezantohet me një geometri komplekse të prejardhur nga shumë burime arkitektonike duke e vështirësuar klasifikimin historik preciz. Duhet theksuar se shpesh ky dekor bëhet thjesht butaforik pa përmbajtje strukturore, që sipas Laugierit arrin lehtë të dallosh pjesët, që hyjnë estetikisht në kompozim të një orderi arkitektonik me ato që janë shtuar jo nga nevoja, por

thjesht nga kapriciot.¹¹

Në këtë hapësirë kapim elementë që përsëriten shpesh, si qoshet e mureve të punuara me stuko, që kanë të njëjtin konfigurim dhe duket qartë se i përka-sin të njëjtës kohë dhe janë punuar nga të njëjtat organizata mjeshtrash. Kornizat e dritareve kanë një dekor të veçantë. Ato zbukurohen me motive gjo-metrike të stilizuara apo floreale të mirëfillta të frymë-zuara kryesisht nga natyra përreth. Balustra me trajta të ndryshme me alternimin e tyre ritmik pasurojnë shkallët, ballkonet e mjaft vilave.

Interesante janë rastet e trajtimit dekorativ të kolonave të vendosura në hyrje të banesës apo pilastrave, ku si motive janë orderat klasik apo kompozitet e tyre të sukseshme.

Ndeshim kolona neo-dorike, neo-jonike, kom-

11 Laugier essai sur l architecture Paris 1753



Fig 20. Tavinë

pozit të orderit të madh, të stilizuara etj. Dekori që paraqitet në kangjellat e oborreve apo në ballkone e parapete përfshijnë tipe tradicionale, neoklasike, Arti i Ri, Art Deko e deri në ato më moderne.

Duhet përmendur puna e mjeshtrave, që përdorin hekurin e rrahur, të cilët e ngrejné në nivel artistik formën e tyre, duke shfaqur një interesim publik për artet “minore” e duke rivlersuar artizanatin ndaj formës thjesht industriale.

Dyshemetë dhe tavanet e banesave i gjejmë me një dekor të përshkallëzuar duke filluar nga trajtat tradicionale e deri në format neoklasike etletike. Dyshemetë me granit të derdhur në vend paraqesin mjaft tendenca bashkëkohore të dekorit të stilit Art Deko (vila Nepravishta). Por në këtë vazhdë mund të rreshtojmë dyshemetë me parket të rimesuar (Pallati i Zogut) me figurat gjeometrike e deri tek ato të shtruar me pllaka çimentoje me ngjyra, ku bashkimi i tyre sjell plane, që vizualisht përceptohen mjaft harmonishëm.

Krahas dekorit shohim edhe shfaqjet moderne të thjeshtësisë ekstreme.

“Lufta kundër ornamentit, sipas Loos, duket në materialet që vlerësohen për pastërtinë e tyre”.

Kështu, në mjaft ndërtime kemi shfaqje të bukurisë së mermerit, drurit masiv, gurit të skuadruar, tullës dhe terrakotës, ashtu siç janë, pa u veshur e stilizuar, pra, pa rifiniturta hipokrite.

Në këto vila janë hequr të gjitha imitimet e panevojshme të stileve të tejkaluara duke ndjekur trendin e modernes.

Puna e realizuar nga studentët e Universitetit POLIS për grumbullim e gjithë materialit faktik në vënd, me rlevime konkrete e fotografi, gjurmimet, puna në arkiva, intervistat, dizenjot, vlerësimet teorike, janë një studim i udhëhequr nga pedagogët e lëndës së Historisë së Arkitekturës dhe Artit si dhe janë përkrahur fort nga drejtuesit e këtij institucioni.

Ju ofroj që ta njihni këtë punë duke shpresuar se është vënë një gur më shumë në historiografinë e kulturës materiale shqiptare.

Dr. Vera Bushati



Foto të kohës të marrë nga arkivi i familjes Pernaska





Tirana e ardhmërisë dhe “qyteti-kopësht”

Një nga kërkesat kryesore të Planit Rregullues të '42-it, i cili shënoi edhe reformimin e Tiranës së Vjetër në dimensione metropolitane, ishte ripropozimi i atij karakteri unik dhe të pazëvendësueshëm prej qyteti-kopësht. Është i rëndësishëm të theksohet fakti që, intuita gjeniale e arkitektit të ish-Zyrës Qëndrore për Ndërtimin dhe Urbanistikën, Bosio, siç shprehet edhe ai vetë, ishte se e pa në vizionet e tija të arrira metropolin e ri shqiptar, në sembiancën e dyzuar ose në dualitetin dinamik dhe dialektik të një zemre urbane të mirë strukturuar (theksuar), kompakte dhe të pastër nga pikëpamja gjeometrike, të rrethuar nga indi i butë i Tiranës së Vjetër, ind i cili u rimbart në trajtat e tij pa çënime themelore (flas për atë pjesë të Tiranës së Vjetër tek rruga e “Dibrës”, që pjesërisht gëzojmë

edhe sot), dhe u reflektua sipas aksit të risistemuar të Lanës, në trajta më të rregullta, për të na dhënë atë, që sot e identifikojmë si Tirana e Re.

Ideali i qytetit kopësht, u ndërthurr njëkohësisht edhe me qëllimim dhe shpresën e kohës, për dhënien e një karakteri sa më bashkëkohës Tiranës, që përthyer ndryshe mund të konsiderohet si krijimi i atij profile, që do ta nënshtronte kaosin urban prej fshati apo province, duke e kthyer atë në qytet perëndimor. Zgjerime të shumta, të cilat do t'i jepnin qytetit frymëmarrjen metropolitane të munguar, u përkufizuan jo vetëm përtej pengesave natyrore si p.sh, Lumi i Lanës, me zhvillimin e Tiranës së Re, por edhe përgjatë arterieve kryesore rrugore të rikonceptuara rishtaz, si p.sh, rruga e “Durrësit”, rruga “Viale Mus-solini” (sot e “Kavajës”), rruga historike e “Dibrës”,



ose aksi primitiv i Tiranës i quajtur ndryshe dhe rruga e “Barrikadave”, rrugë e cila më pas u devijua nga aksi i fuqishëm brazilian.

Ngritja e objekteve publike si dhe të atyre përfaqësuese, paralelisht me rikonceptimin e fasadave urbane jo me vetëm mure e qerpiç, u dha këtyre rrugëve karakterin publik të dëshiruar. Rrethinat e tyre u plotësuan me banesa, të cilat në fazën e parë u përqëndruan kryesisht përgjatë ose në brezin e parë të rrugëve të sapohapura, ndërtime që relativisht mund të konsideroheshin kuinta urbane me karakterin e tyre inovativ prej “perëndimi modern” pjesë e një morie të madhe objektesh kryesisht vila dhe objekte publike, që valëvitnin identitetin e tyre të ri nëpërmjet një shumëllojshmërie stilesh dhe dekoresh të stilit “Novecento”.

Arkitektë të huaj apo vendas ndikuan më pas në rinovimin dhe pasurimin e ideve të kohës. Ndërtime të tilla u përqëndruan gjithandej, si objekte të veçantë apo ansamble të vërteta, përmendim këtu Pazarin e Ri dhe vilat përreth, objekte në brendësi të Tiranës së

Vjetër, ansamblet përgjatë rrugës “Asim Vokshi”, “Durrësit”, “Mine Peza”, “Kavajës”, “Hoxha Tahsin”, “Qemal Stafa”, “Tefta Tashko”, gjithë zonës së përqëndruar përgjatë rrugës “Punëtorët e Rilindjes”, gjithë kompleksit një familiar në gjirin e Tiranës së Re, në brezin e dytë përgjatë aksit strukturues të qytetit, etj.

Pothuajse të gjitha objekte përfaqësuese dhe dëshmi historike të evolucionit të traditës së arkitekturës tiranase. Mund të hipotezohet kështu, sepse vila e re qytetare mori një zhvillim bazuar në mënyrë unikale në arkitekturën tradicionale tiranase. Në shumë raste ajo nuk ishte gjë tjetër, veçse shtëpia prej qerpiçi, së cilës i ishin mbivendosur elemente dhe dekore të importuar me vulë italiane. Gjithashtu ruhen nëpër Tiranë edhe shembuj interesantë të një arkitekture totalisht inovative, në shkallë më pak evidente, ndoshta se sa u shfaq në arkitekturën publike të komisionuar drejtpërdrejt nga shteti i asokohe.

Por pati edhe shembuj, ku elementi autokton u ndërthur bukur me atë internacional, nëse flasim për

stil floreal, duke dhënë arkitekturë hibride, por unikale, shprehje e një arritje të kohës dhe e arkitekturës autoktone shqiptare. Mjafton të analizosh ndërthurjen e disa elementëve, ku çatia e shtëpisë ka vokacion dhe aspekt formal kryesisht otoman, portali i hyrjes dhe hapjet në fasadë me karakter gati neoklasik, zbatuar me rregull arkitektonik rigoroz e proporcione të pazakonta, deri edhe tek detaji i vëmendshëm i paturave apo i kornizave, të gjitha të përdorura në një gjuhë shprehëse arkitektonike të lidhur mirë, duke dhënë vepra të realizuara dhe lirike.

Ashtu si shumë të tjera, shprehen të qarta në stereometrinë e tyre, me një unitet formal tipik urban, me veçantësinë se janë vila të konceptuara për të luajtur rol në fasadat urbane, ku ndryshe nga shtëpia tiranase, e cila i fshihet qytetit, ato reklamojnë fytyrën e tyre me arkitekturë delikate, detaje dhe ballkone të mirëmenduar, ku shprehet qartë tendenca e tyre për t’u ekspozuar.

Kjo strukturë rrugore dhe indore trashëgohet edhe më pas, gjatë konceptimit të planeve rregulluese të mëvonëshme si dhe krijon rrjetën, ku zhvillime të





tjera morfologjike e ndërtimore i përmbahen këtij rrjeti duke zëvendësuar indin e vjetër urban me ndërtime tipike plurifamilare të gjysmës së dytë të shekullit. Edhe ato pozicionohen kryesisht përgjatë akseve kryesore rrugore duke krijuar quinta urbane të vazhduara, por që në brendësi të zonave të përcaktuara ruajnë, pothuajse në mënyrë elokuede dhe të vazhdueshme indin origjinal të shtëpisë me qerpiç ose sistemin e vilave të qytetit –kopësht”.

Ndrydhja e indit kopësht në brendësi të kuartalleve të reja është ende evidente dhe shpreh aktualisht konfuzionin funksional dhe strukturor në pothuajse të gjitha njësitë urbane tiranase pa dallim, si kronologjik, ashtu edhe tipologjik.

Është aktual fakti që, pothuajse të gjitha tendencat e përditshme për ekspansion si dhe të kërkesës për ndërtim e rindërtim janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen në dëm të qytetit kopësht apo të atyre ndërtimeve të ulëta një ose dy katëshe të çfarëdo lloj kategorie qofshin, që janë edhe më të lehta për t’u tjetërsuar. Produkt i saj është një densifikim shpesh herë i pajustificuar i zonave të ndryshme të banimit, që jo rrallë herë sjell probleme të mobilitetit të brendshëm për të mos përmendur mungesë të theksuara në pajisjen me të gjitha elementet e nevojshme të mobilimit dhe mjedisit urban.

Por, kjo lloj tendence për ndërtim, shtysë dhe pasojë e zhvillimeve ekonomike dhe urbane sidomos të 15 vjeçarit të fundit e justifikuar për prirjen e saj pozitiviste e progresiste të pashmangshme të kohës, nuk përlligjet me faktin se shpesh herë mjafton vetëm sasia e m² më të shumtë për të bërë që të veprojmë verbazi kundrejt çfarëdo lloj arkitekture “të vogël”, ku justifikon vetëm fakti se ajo është e vjetër. Ka një lloj inercie në këtë verbim të pagjasë, edhe nga fakti se përherë tendencat konservative dhe restauruese dhe për pasojë edhe brumosja etiko-profesionale e gjithë brezit të arkitekteve apo ndërtuesve kanë qenë drejtuar ose kundrejt objekteve të legjitimuar të lashtë, ose kundrejt asaj arkitekture madhore, që hynte në “istancat e mbrojtjes” shpesh herë e ndihmuar vetëm për pasojë të dimensioneve të saj.

Vlen për t’u përmendur se iniciativa të tilla mbrojtëse dhe promovuese janë ndërmarrë në rang urban edhe pse shtytja për implementim e ndërtim është e


papërmbajtshme shpesh herë. Mjafton të përmendim zonat nën mbrojtje, si tek rruga “Skënderbej”, zona përgjatë rrugës së “Durrësit”, zona tek “Hoxha Tahsin” apo “Shkolla e Kuqe”, zona e “Radio-Televizionit”, etj. Është kërkesë e kohës që studime të mirëfillta me karakter të theksuar, promovues dhe implementues vlerash të ndërmerren edhe nga institucione të mirëfillta shkencore.


Besoj se tanimë të gjithë jemi të bindur se qyteti-kopësht vazhdon të ekzistojë dhe në një përqindje ende të konsiderueshme ai është indi thelbësor i qytetit, ku në pjesë të veçanta të tij vazhdon të ruajë konsistencë dhe unitet morfologjik të konsiderueshëm. Përpos vlerave urbane të pamohueshme dhe faktit se vazhdon të jetë një nga hallkat kryesore në evolucionin urban dhe arkitektonik të qytetit, qyteti kopësht ngërthen në vetvete ende shembuj ekselentë të një arkitekture të rrallë dhe unike për të cilat duhet drejtuar vëmendja e merituar. Ka ardhur koha që këtyre shembujve ende çuditërisht në këmbë t’u jepet rëndësia që mbartin. Ato janë mbartëse të gjurmës së kohës në një moment kyç të zhvillimit modern të qytetit në kuptimin metropolitan të tij, duke përfshirë në brendësi të saj elemente unike dhe të pazëvendësueshëm, pa të cilat Tirana e ardhmërisë nuk do të kishte kuptim.









Jemi mësuar ta shikojmë Tiranën e sotme si një kantier të përhershëm, ku ajo vetë në çfarëdo lloj sembiancë të vet përpiqet pafundësisht t’i shpëtojë një imazhi të saj përfundimtar. Shpesh herë ç’ka shikojmë në tendencat e vazhdueshme për zhvillim është përpjekja për kontrast, dualizëm apo shumë fytyrësi, palinses tendencash të reja apo imitacionesh, Tirana e ardhmërisë mbart pjesë të larmishme mozaiku, është një patchwork i madh, ku veten e gjejnë pa ndonjë dialog ose më mirë në monologë të veçuar të gjitha fazat e histories, ku ka kaluar e ndeshur jo vetëm ajo, por i gjithë vendi ynë e pse jo pjesë e pandarë e saj janë dhe vilat që me originalitetin e tyre, shprehen si përfaqësuese të denja të një arkitekture cilësore dhe historike.

Ark. Albana Tollkuçi

Ndarja e zonave



	Zona 1 faqe 32-71
	Zona 2 faqe 72-93
	Zona 3 faqe 94-119
	Zona 4 faqe 120-131
	Zona 5 faqe 132-157
	Zona 6 faqe 158-173
	Zona 7 faqe 174-195
	Zona 8 faqe 196-211

	Zona 9 faqe 212-229
	Zona 10 faqe 230-253
	Zona 10 faqe 254-287
	Zona 12 faqe 288-313
	Zona 13 faqe 314-371
	Zona 14 faqe 372-401
	Zona 15 faqe 402-437
	Zona 16 faqe 438-461



Metodologjia dhe procesi i studimit

Gjatë procesit të studimit të Vilave në Tiranë, që i përkasin periudhës 1912-1942, u pa e nevojshme që informacioni të përpunohej në një vëllim që do të dokumentonte këto tipologji.

Disa prej fotove në këtë libër janë marrë vetëm pak kohë para shkatërrimit të objekteve. Studentët kanë dokumentuar imazhe të rëndësishme, të cilat japin idenë e asaj çfarë ishte më parë.

Ndarja në 16 zona e qytetit të vjetër, si në figurë, është ndarje konvencionale, që shërben praktikisht për studimin në zonë sipas Tipologjive. Në këtë mënyrë është më e lehtë për t'u lexuar tipologjia e banesave në Qytetin Kopësht si një entitet më vete, formuar në kushte specifike, me karakteristikat përkatëse, ndryshe nga tipologjia e zonave pranë sheshit "Avni Rustemi". Shpesh herë për ndarjen e Zonave ndikojnë kufijtë natyrorë apo rrugë magjistrale, përtej të cilave ndryshimi është i ndjeshëm.

Grupe me 4 deri 10 studentë kanë zhvilluar punë të përbashkët brenda grupit.

Zonat variojnë në përmasa nga 200 m në disa qindra metra në gjatësi dhe përbëhen nga parcela, ku ndodhen disa vila. Në shumicën e zonave ekziston tekstura tradicionale, por në pjesën më të madhe kjo teksturë është e çjerrë nga ndërtime të viteve 60 apo ndërtime të pas viteve '90. Në disa zona, si përgjatë rrugës së "Kavajës", vilat kanë mbetur në formën e ishujve në dendësinë e lartë urbane, ndërsa në zona

me pranë Pazarit të Ri, gjendet një teksturë urbane më e ruajtur me ishuj të ndërtesave të larta me tendencë zgjerimi. Deri diku Tirana me çatitë tradicionale perceptohet si e tillë.

Në secilin rast studentët duhet të bënin një përlogartitje të saktë të vilave që ndodheshin në zonë, një proces skanues, i domosdoshëm në aspektet e dokumentimit. Prosesi i skanimit përfshin vizitat në terren dhe hulumtimin e hartave të vjetra historike për të shënuar evoluimin e zonës dhe marrja e informacionit nga banorët e zonës dhe përcjellje e asaj që quhet memorie kolektive e zones.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është vlerësimi i shndërrimeve dhe përshtatjeve apo shtesave, krahasimet në kohë të fasadave dhe të kuptuarit e kualitetit të ndërhyrjes. Krijimi i ndjeshmërisë dhe të kuptuarit e ndërhyrjes është element i rëndësishëm për studentët e vitit të parë dhe të dytë.

Rilevimi i disa prej vilave me të rëndësishme, gjatja e dokumenteve të vjetër si dokumentet e pronësisë, apo planimetri të kohës evokojnë një proces të qartë të akt-marrëdhëniesve projektim-shitje në vitet 30, një proces interesant, i cili dukej me qartë në vilat e Zonës Jugore të Tiranës. Nga teknikat grafike tek mënyra e realizimit, të objektit qasja moderniste është evidente në këto zona.

Në zonat më tradicionale vihet re realizimet e mjeshtrave, kryesisht teknikat tradicionale të ndërtimit, materialet e përdorura. Njohja e kësaj gjuhe

dhe vënia në evidencë grafike atje, ku përdoret është një tjetër proces njohje, të cilën disa grupe studentësh kanë kaluar.

Nëse një studim tjetër më i thelluar do të mund t'i vlerësonte si monumente një pjesë të ndërtesave, atëherë do të ishim në prag të zgjidhjes së disa prej problemeve më të rëndësishme.

Pjesë e studimit është dhe kuptimi i vulnerabilitetit të disa ndërtesave për t'u shkatërruar ose transformuar, që varet nga disa faktorë, si të ardhurat e banorëve, vendosja pranë rrugës, përdorimi mix me biznese në katet përdhe, numri i kateve, mënyra e ndërtimit, konfliktet e pronësive, etj.

Konfliktet e pronësive shpesh herë kanë sjellë ngrirjen e situatës, e cila kërkon menazhim më të mirë dhe ndjeshmëri më të lartë nga organizmat përgjegjës.

Në disa raste studentët kanë propozuar projekte konceptuale mbi mënyrën e përdorimit apo transformimit të disa prej vilave e parcelave, që do të krijonte vlera më të larta estetike dhe do të kualifikonte më tej. Këto projekt-ide mund të thellohen e përpunohen më tej në një ekspozitë në terren, e cila do të ndihmonte në koordinim të përbashkët me banorët lokal dhe autoritetet lokale, nga ku mund të lindë një diskutim dhe proces aktiv mbi ruajtjen dhe shtimim e vlerave për vilat e gjysmës së parë të shek 20.

Ark. Ernest Shtëpani

ZONA 1


Universiteti POLIS

Përpunoi: *Andrea Naçi*

Punuan: *Andrea Naci, Alma Kaziu, Arnold Pulaj, Bruna Arkaxhiu,
Edon Bardoniqi, Edona Shehaj, Getoar Besimi.*



Zona 1




Pozicionimi i zonës në raport me qytetin /Punoi: G. Struga

Karakteristikat e Zonës

Zona nr. 1 që përfshin pothuajse gjithë qendrën e Tiranës, kufizohet nga lumi Lana në jug, Stacioni i Trenit në veri, bulevardi “Zogu i Parë” si dhe nga rruga e “Barrikadave”, përfshinë tipologji të ndryshme të objekteve karakteristike të ndërtimeve. Kjo zonë ka patur një zhvillim të rëndësishëm, sidomos pjesa rreth pazarit të vjetër, fatkeqësisht është shkatërruar plotësisht. Ka mledhur përreth vetes objekte të veçanta, si Xhamia,

Kulla e Sahatit apo dhe trajektore të rëndësishme, si rruga e “Dibrës”, “Barrikadave”, “28 Nëntori”, bulevardi “Zogu i Parë” etj. Qëllimi i studimit konsistonte në evidentimit të banesave të periudhës 1912-’44, analizimin e tyre duke vënë në dukje tipologjinë e ndërtimit, karakteristikat si edhe marrëdhënien e tyre me ambientin. Informacioni është si rezultat i analizimit të detajuar në terren.



Vendndodhja e vilave



Rruga e “Barrikadave” ndodhet në kryqëzimin midis rrugës së “Dibrës” dhe rrugës “Luigj Gurakuqi”. Ajo është një ndër rrugët më të hershme në Tiranë. Në vitet ’20-30 me ndërhyrjet që u bënë në disa nga rrugët e Tiranës, edhe rruga e “Barrikadave” pësoi ndryshime. Ajo kishte një gjërësi prej 15 m dhe gjatësi 725 m. Ndërtesat ishin të vendosura në drejtim gjatësor, ngjitur me njëra-tjetrën, gjë që arriti deri në ditët tona. Kjo ngjitje fillonte, që nga sheshi përpara xhamisë së vjetër

dhe mbaronte deri në kryqëzimin me rrugën “Bajram Curri”, nga krahu i qendrës. Ndërsa, në krahun lindor, ndërtimi ndërpritej jo vetëm nga kjo, por dhe nga rruga “Luigj Gurakuqi”. Disa nga ndërtesat kryesore në rrugën e “Barrikadave” janë shtëpia e Petrelajve, Permanenti apo dhe Bomboneria etj., por shembja e pjesës më të madhe të tyre filloi rreth viteve ’80. Shtëpia e Petrelajve nuk ka pësuar ndryshime, Permanenti nuk e ruan më funksionin e mëparshëm, ndërsa Bomboneria nuk

ekziston më. Materiali i ndërtimit që përdoret më shumë është beton armeja. Dritaret janë të rrethuara me kornizë të përpunuar. Ballkonet kanë parapet me hekur të rrahur, që u fut në përdorim në shekullin XIX dhe të gjithë janë të pajisur me një konsol, kjo për shkak të hedhjes së soletave në drejtim të rrugës. Ballkonet janë të ngushta, me gjërësi që varion nga 80-90 cm, rrallë në 1m. Një tjetër zbulurimorë është prania e pilastrave, që dalin si imitim i orderit.



Një mori rrugësh si ajo e “Durrësit”, “Elbasanit”, “Dibrës”, “Kavajës”, “Shëngjergjit” etj., kryqëzoheshin të gjitha në qendër (Pazari). Pra, qendra e qytetit është pazari, ku zhvillohej njëkohësisht si aktiviteti prodhues dhe ai tregtar. Pazari i vjetër me dyqane, galeri dhe strehë druri, sipas de Granit është prishur më 1905 dhe është rindërtuar mbi bazën e hershme. Pazari i rindërtuar në vitet ’60 u shemb për ndërtimin e Pallatit të madh të Kulturës dhe sistemimin e sheshit “Skënder-

be”. Pazari i Tiranës shtrihej brenda hapësirës së kufizuar nga balli i banesave të krahut perëndimor të rrugës së Barrikadave, të atij juglindor të rrugës “Bajram Curri”, rrugës “28 Nëntori” dhe një pjese të sheshit të dikurshëm të qendrës së Tiranës. Ky Pazar zinte një sipërfaqe prej 2-3 ha dhe përbëhej nga ndërtesa të ulëta qerpiçi e tulle, njëkatëshe, rrallë dykatëshe. Ato ishin të vogla, ngjitur me njëri-tjetrin në të dyja anët e rrugëve, që dalloheshin sipas zejeve të ushtruara. Me

këto përmasa dhe numrin e njohur të dyqaneve, i cili nga fundi i shek. XIX arriti në më shumë se 700 lokale, konsiderohet si treg mjaft i madh për qytetin dhe trevën e tij.

Studim Vila nr. 25



Fotografoi: D. Shamolli



Hyrje anësore



Fotografi e vjetër



Planimetri

Vila e marrë në studim sot quhet Akademia e Shkencave. I përket periudhës para viteve '44, ka qënë Rezidenca e mbretit Zog. Eshhtë objekt dykatësh i mirëmbajtur dhe rikonstruktuar pjesërisht. Çatia është katër ujëse, e veshur me tjegulla qeramike, mbajtur mbi traërë druri. Ka dekorim të veçantë të eksterierit me detaje të shumta, siç vërehet edhe në stilizimin e fundshkallëve në formën e gjysmë-rrathëve etj.

Detaje të interierit





Studim Vila nr. 3





Përdorimi i harkut në hyrje



Pamje

Vila e marrë në studim ndodhet në rrugën e “Barrikadave”. Kjo vilë filloi të ndërtohet në vitin 1943 nga një arkitekt italian. Ka qënë në pronësi e një familjeje të pasur në Tiranë, më pas është kthyer në një kopësht për fëmijë të sëmurë mendor dhe tashmë banohet nga pronarët. Përbëhet nga dy kate dhe një bodrum, të treja me një kubaturë të lartë, është e pasur me dekoracion të larmishëm, ku kollonat vishen me pllaka dhe shkallët me mermer.

Studim Vila nr. 4



Pusi




Shkallët hyrëse

Vila e marrë në studim është e familjes Farka dhe ndodhet në rrugën “Çerçiz Topulli”. Kjo banesë është ndërtuar në vitin 1926, që prej asaj kohe deri sot është banuar nga familja Farka. Mendohet se arkitekti i kësaj banese është italian, por nuk është informacion i sigurt. Vila banohej nga zonja Hatixhe Farka (IJE). Kjo godinë ka shërbyer si bazë e luftës Nacional Çlirimtare dhe për të gjendet shumë material historik. Duhet thënë se janë gjetur detaje, të cilat paraqesin qartë tipologjinë e banesës tiranase, si egzistenca e pusit. Një tjetër element i veçantë arkitetkonik është kati i parë, i cili nuk është i plotë, por zhvendoset nën sipërfaqen e terrenit. Trajtimi i fasadës ballore është mjaft i larmishëm, filluar kjo nga kornizat e dritareve, shkallët, elementet e shkallëve, pusi. Porta ka një trajtim interesant, pasi ruan autenticitetin.



Dekorim i kolonës dhe balustra



Pamje e derës së jashtme


Studim Vila nr. 6




Skicoi: A. Naci

Vila 6 ndodhet në rrugën “Dervish Hatixhe”. Përballë saj është Konsultorja dhe në krahë të saj gjendet vila 5 (me karakteristika të njëjta, vetëm se është rikonstruktuar më vonë). Është një vilë e tipit të banesës me qoshk. Konstruksioni- Muret janë të ndërtuara me qerpiç rreth 40 cm. Çatija është e mbuluar me tjegulla qeramike dhe e mbështetur në trarë druri. Hyrja për në banesë bëhet me ndihmën e dy shkallëve që të çojnë në ballkon. Këtu kemi zëv-

endësimin e qoshkut me ballkon të hapur, mbështetur mbi kolona. Pas ballkonit gjendet një dhomë e madhe dhe në të dy krahët e saj gjenden dy të tjera, kjo për katin e dytë. Ndërsa, në katin e parë janë vetëm katër dhoma në të dy krahët, kjo për arsyen se, hapësira e qendrës zëvendësohet me shkallët. Ka një ndarje simetrike të hapësirave të brendshme dhe mendohet se ka shërbyer për dy vëllezër.



Detaj i rilevuar dritareje / Rilevoi: A. Naci



Skicë dritareje / Rilevoi: A. Naci



Dekori i pllakave



Pamje e vilës



Shkallë të brëndshme



Pamje e hyrjes



Dera e jashtme




Detaj i kolonës

Studim Vila nr. 11



Vila e marrë në studim ndodhet në rrugën e "Barrikadave" dhe është banesa e familjes Petrela. Është një objekt i ndërtuar para 200 vjetësh dhe mendohet të këtë qenë godinë njëkatëshe me qerpiç. Është ndërtuar nga Cen Elezi. Para 70-80 vjetësh ajo u ble nga familja Petrela dhe nga familja Konçi. Në këtë periudhë vila ka marrë trajtimin aktual, të paktën në aspektin arkitektonik. Ky objekt është klasifikuar monument kulture i kategorisë së parë në vitin 1980

dhe është nën mbrojtjen e Institutit të Monumenteve të Kulturës. Muret perimetrale kanë një trashësi prej 50 cm. Planimetria ka qenë e ndarë në dy pjesë. Sapo sheh fasadën ballore vërehet një disnivel në lartësitë e dy kateve. Lartësia e katit përdhe është rreth 2.70 m, ndërsa lartësia e katit të parë është 3.70 m. Ka çati me sipërfaqe 600 m². Karakteristikë në ndërtimin e kësaj çatie janë trarët me dimensione 5 x 15 cm me dru lisi.



Detaj dritareje / Arkivi i Institutit të Momnumenteve




Dera e jashtme




Shkallë të brëndshme



Pamje kryesore 1




Pamje kryesore 2




Pamje nga mbrapa



Pamje anësore



Planimetri e katit përdhe




Prerja A-A


Studim Vila nr. 15




Sapet



Planimetri e katit përdhe /Rilevoi: A. Naçi



Planimetri e katit parë /Rilevoi: A. Naçi



Skicoi: A. Naçi

Vila e marrë në studim gjendet në rrugën "Spiro Dedja", shumë pranë "Bulevardit Zogu I". Është rikonstruktuar për shkak të dëmtimeve të marra gjatë luftës. Kjo vilë i përket vitetve 1890, pothuajse 120-vjeçare. Konstruksioni- Vilë dykatëshe e mbuluar me çati druri dhe trarë të dalë jashtë (e rikonstruktuar pjesërisht). Muret janë ndërtuar prej metariali

qerpiçi, i cili justifikon trashësinë e mureve prej 60 cm. Kemi dhe elemente horizontale prej druri për funksion antisizmik. Këtu kolonat kanë formë të veçantë, ato nuk janë plotësisht katrore, por këndet e tyre janë të rakorduara. Tavani është prej druri dhe aty ku ai bashkohet me muret kemi cepa të harkuara, kjo për arsye se "mjeshtrat" nuk mund të bënin kë-

din e drejtë dhe kur suvatonin i bënin me forma cilindrike. Hapërsirat: Të gjitha dhomat vijnë njëra pas tjetrës. Karakteristikë është dhe një dhomë e veçantë, që shërben si depo, e cila imiton qemerin cilindrik. Në katin e parë, i veçantë, është një hamam, që tashmë ka ndryshuar funksion dhe është kthyer në dhomë gjumi.

Studim Vila nr. 16




Fotografoi: D. Shamolli




Detaj i portës

Vila e marrë në studim është vilë tre katëshe e familjes Petrela, e cila ka qenë e përbërë prej dy pjesëve (deri para 7 vjetësh, e verdhë dhe rozë, ngjyra në fasada) gjendet në kryqëzimin e dy rrugëve kryesore, rruga e “Barrikadave” dhe “Dibrës”. Më parë ka qenë e ndarë në raport me lartësinë, ku njëra pjesë në dy kate dhe tjetra në tre. Tashmë është rindërtuar pjesa e dykateve dhe është bërë njësh me tjetrën. Është e ndërtuar në vitet 1927 dhe meqë karakteristike për rrugën e “Barrikadave” ka qenë dyqan poshtë e banim sipër, e njëjta gjë është dhe për këtë vilë. Vlen për t’u përmendur detajimi i veçantë i të gjithë godinës si në eksterier, ashtu dhe në interior, ku bien në sy ballkonet ekstravagante të saj.



Planimetri e katit përdhe & prerja A-A



Planimetri e katit dytë




Studim Vila nr. 24




Pikturoi: O. Foto

Ajo ngrihet në qendër të qytetit të Tiranës, dikur në rrugën “Alqi Kondi” e tani në rrugën “Abdi Toptani”. I takon banesave të mbyllura të shtresës së pasur feudale, të ndërtuara gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX-të. Sipas Prof. Emin Rizës, ky tip përfaqëson banesën tipike tiranase me dhomën e zjarrit. Ajo ka planimetri drejtkëndëshe të rregullt. Është ndërtuar me mure qerpiçi dhe skelet druri në katin e sipërm.

Muratúra shkón me gjerësi 60-70 cm, qerpiçët lidhen me llaç balte përzierë me kashhtë. Themelet ndërtohen me gurë lumi e lidhen me llaç balte, ngrihen rreth 30-40 cm nga niveli i tokës, më pas vjen një brez druri dhe muret. Banesa është e tipit me çardak në një krah. Kati përdhe formohet prej hajatit dhe katër ambienteve. Shkallët e hapura dyrampëshe në ballë të çojnë në çardakun e mbyllur të katit.



Planimetria e katit parë /Rilevoi: E. Kovaci



Planimetria e katit përdhe /Rilevoi: E. Kovaci



Tavani prej druri



Oxhaku

Studim Vila nr. 22



Druga "28 Nëntori", 1930, në krah të majtë vila nr 22



Rruga "28 Nëntori", 2011



Shkallë të brëndshme

Vila në studim është pallati “Vllazën Kaceli” ndër-
tuar nga fundi i viteve ‘20 dhe projektuar nga një
arkitekt italian. Ajo është ndërtuar nga familja autok-
tone tiranase Kaceli, së bashku me familjen Laca, e
ndarë në mes në mënyrë simetrike. Pamja perëndi-
more e saj është pjesë e siluetës së qytetit të Tiranës,
ku dikur ka qenë e shkruar me shkronja të mëdha
“Vllazën Kaceli”. Kontrukcioni dhe hapësirat: Ob-
jekti është projektuar me pesë kate. Dy katet e para
janë dyqane. Katet e tjera shërbejnë për banim. Në
fasadën kryesore ka ballkone me material hekur, dri-
taret dhe dyert. Nga ana konstruktive është ndjekur
parimi “i mosfshesjes së konstruksionit” duke bërë të
dukshëm në pamjen kryesore trarët dhe kolonat.

Studim Vila nr. 1



Vila e marrë në studim gjendet në fund të rrugës së “Barrikadave”, pranë stacionit të trenit. Vilë është në pronësi të një doktori. Ajo është vilë dykatëshe me bodrum, e përbërë nga një çati katër ujëse. Veçanti e saj është se në planimetri ka përdorim të harkut në të dy katet.



Studim Vila nr. 2



Vila e marrë në studim gjendet në fund të rrugës së Barrikadave pranë stacionit të trenit. Është një vilë dy katëshe me bodrum dhe me çati katër ujëse. Bie në sy dekorimi që kanë dritaret apo këndet e çatisë me trarë druri, si dhe ballkoni gjysmërrethor në ballinën e vilës.

Studim Vila nr. 7



Fotografoi: G. Struga

Vila 7 ndodhet në rrugën “Dervish Hatixhe”. Është vilë e tipit të banesës me qoshk. Konstruksioni- Muret janë të ndërtuara me qerpiç rreth 40 cm. Çatija është e mbuluar me tjegulla qeramike dhe e mbështetur në trarë druri. Hyrja për në banesë bëhet me ndihmën e dy shkallëve, që të çojnë në ballkon. Këtu kemi zëvendësimin e qoshkut me ballkon të

hapur mbështetur mbi kolona. Pas ballkonit gjendet një dhomë e madhe dhe në të dy krahët e saj gjenden dy të tjera, në katin e dytë. Ndërsa në katin e parë ka vetëm katër dhoma në të dy krahët, kjo për arsye se, hapësira e qendrës zëvendësohet me shkallët. Ka një ndarje simetrike të hapësirave të brendshme dhe mendohet se ka shërbyer për dy vëllezër.


Studim Vila nr. 8




Kjo vilë e marrë në studim gjendet në rrugën "Der-
vish Hatixhe". Është vilë një katëshe me hajat, e ndër-
tuar me mjeshtër rreth viteve 1940 dhe është rikon-
struktuar pjesërisht. Konstruksioni: Muret janë
ndërtuar prej një material qerpiçi, i cili justifikon
trashësinë e mureve të jashtëm rreth 40 cm. Tavani
është prej druri dhe çatia është e mbuluar me tjeg-

ulla prej qerpiçi të harkuara. Ka, gjithashtu, një kolo-
në në hajat, e cila mban ngarkesën e çatisë. Hapësirat.
Përfshihen në një oborr të ndarë. Ka një portë, që të
fut në oborr.

Studim Vila nr. 10



Rilevoi: A. Kaziu




Rilevoi: A. Kaziu

Vila ndodhet në fillim të rrugës “Bardhok Biba”. Ajo është ndërtuar me “mjeshtëri”. Në fillim ajo i përkiste vetëm një familje, tani është përshtatur për dy familje dhe është e ndarë në dy oborre. Në rilevim përfshihet vetëm njëra pjesë e saj. Muret janë ndërtuar me tulla dhe llaç, çatia katër ujëse, tavanet janë prej elementësh druri. Kati përdhe është i përbërë nga tre hapësira kryesore. Korridorin (hapësira qendrore) mundëson lidhjen e dhomave. Sapo futesh, në krah të djathtë ndodhen shkallët, që bëjnë lidhjen me katin e parë. Planimetria e katit të parë është e njëjtë me atë të katit përdhe, me një ndryshim, ka një aneks nën shkallë.

Studim Vila nr. 12



Objekti ndodhet në rrugën e “Barrikadave”. Është rikonstruktuar pjesërisht dhe mirëmbahet. Mendohet të jetë ndërtuar rreth viteve 1860. Është shpallur monument kulture. Tani ajo shërben si Teqe.




Planimetri e katit përdhe /Rilevoi: A. Ago


Studim Vila nr. 13



Fotografoi: D. Shamolli



Planimetri katit përdhe /Rilevoi: E. Shehaj



Planimetri kati parë/Rilevoi: E. Shehaj


Vila në studim ndodhet në rrugën “Bardhok Biba”. Një pjesë e vilës është rikonstruktuar së fundi, por gjithsesi detaji i studiuar është paraqitur edhe në foton më poshtë. Në foto, gjithashtu janë të paraqitura edhe planimetri të dy kateve të vilës. Kjo është vilë me një sipërfaqe relativisht të vogël. Në planimetrinë e katit të parë ndodhet banjoja dhe dy dhoma, njëra prej të cilave dhoma e gjumit dhe tjetra dhoma e ditës, të cilat lidheshin me anë të një derë të madhe, sa faqja e murit. Në planimetrinë e katit të dytë ndodhej vetëm një dhomë, e cila lidhej me shkallët me anë të një korridorit të ngushtë, në këtë kat ndodhej, gjithashtu edhe një derë e vogël, e cila të çonte në tarracën e vilës. Struktura duket qartë që është betoni i armuar dhe tulla. Interesante është zgjidhja këndore e qoshes së rrugës.

Studim Vila nr. 14




Fotografi: G. Struga

Vila në studim ndodhet në rrugën “Spiro Dedja”. Mendohet të jetë shkolla e parë në Tiranë. Planimetria përbëhet nga një hapësirë qendrore, e cila mundëson lidhjen me dhomat, që ndodhen në të dyja krahët. Gjithsej në katin përdhe gjenden katër dhoma. Këtyre të fundit u janë shtuar edhe katër hapësira të tjera para disa viteve. Muret janë ndërtuar me qerpiç të lidhura me elementë druri. Tavani është ndërtuar me elementë druri, gjithashtu. Kjo banesë imiton shumë mirë banesën me qoshk, por me karakteristika të veçanta, si rasti i qoshkut, ku ky i fundit nuk është i theksuar, pra nuk është i dalë, por ndjek drejtimin e mureve të dhomave anësore. I kushtohet rëndësi kornizave të dritareve, të cilat paraqiten të përpunuara. Ballkoni konsol është pajisur me parapet hekuri të rrahur.



Studim Vila nr. 17



Skicoi: G. Besimi



Pamje


Vila është vilë dy katëshe dhe gjendet pranë bulevardit “Zogu i Parë” dhe ka në të dyja krahët e saj ndërtesa të viteve pas luftës së II Botërore. Kjo vilë është rreth 100 vjeçare (sipas banorëve të vjetër të zonës), të cilën e dëshmon materiali dhe gjendja në të cilën ndodhet. Është ndërtuar me material qerpiçi në pjesën e sipërme dhe material guri në pjesën e xokolit, me një lartësi 120 cm. Përmban, gjithashtu, disa breza druri me funksion antisizmik të vendosura në lartësinë e një gjysmë kati. Tavani është prej druri, ashtu si dyshemeja. Çatia është e mbuluar me tjegulla vendi dhe mbahet mbi trarë druri. Me kalimin e kohës është shtuar dhe një pjesë në fasadën ballore. Kati i parë është rrënuar pothuajse plotësisht.

Studim Vila nr. 19



Fotografoi: G. Struga

Vila e marrë në studim ndodhet në rrugën “Bardhok Biba”. Po t’i referohemi aspektit kompozicional, banesa me qoshk paraqitet krejtësisht ndryshe, shfaqet si një dukuri, që nuk ka lidhje me tipologjinë. Kjo banesë paraqitet me një kompozim të thjeshtë e të qartë, ku dallohen tre pjesët përbërëse: ajo qëndrore me funksion ndërlidhës dhe dy anësorët me funksion banimi. Këtu kemi zëvendësimin e qoshkut me ballkon të hapur. Një ndër karakteristikat e tjera është edhe përdorimi i harkut të mbështetur mbi kolona në vend të arkitraut. Vihet re trajtimi i qosheve me dekor si dhe dekori i përdorur në hyrjen e vilës.




Skicoi: A. Naci

Studim Vila nr. 20



Fotografoi: G. Struga

Vila në studim ndodhet në rrugën e “Dibrës”, në krahun e djathtë të 15-katëshit. Një tjetër tip i banesës me qoshk, që tashmë është rikonstruktuar duke ruajtur përsëri të njëjtin kompozim. Në këtë banesë dykatëshe kemi përsëri zëvendësimin e qoshkut me ballkon të hapur të mbështetur në kolona, që i përshtaten thjeshtësisë dhe qartësisë që e karakterizon. Në këtë banesë kemi trajtimin e njëjtë të të katër cepave duke mos shfaqur asnjë veçanti ndërmjet tyre. Duke iu referuar pamjes së paraqitur më poshtë, vërehen ndryshimet, që shfaqen midis saj dhe ndërtesave në tërësi, si nga mënyra e ndërtimit, karakteristikat si dhe altimetria.




Skica e hyrjes /Skicoi: B. Arkaxhiu

Studim Vila nr. 23



Fotografoi: D. Shamoli



Ndodhet në rrugën “Abdi Toptani” me një zgjidhje mjaftë moderne. Të bie në sy trajtimi i qoshes si në katin përdhe, ashtu edhe në katin e parë. Linja e kornizës së dritareve është lajtmotiv dekorativ i vilës.

Fotografi të vilave



Vila nr. 5, rruga "Dibrës" /Foto grafoi: G. Struga



Vila nr. 21, rruga "Bardhok Biba" /Foto grafoi: D. Shamolli



Vila nr. 22, rruga "Bardhok Biba" /Foto grafoi: D. Shamolli



Vila nr. 26, rruga "Murat Toptani" /Foto grafoi: G. Struga

Përmbledhje



Kjo zonë karakterizohet nga banesa të ulëta një deri në tre kate për periudhën në fjalë. Është e pasur me një sërë banesash me tipologji të ndryshme, ku dominon banesa me qoshk. Sipas kronologjisë relative, themi se banesat me qoshk renditen pas tipave të banesës me hajat dhe asaj me çardak. Lindja dhe zhvillimi i këtij tipi lidhet me fillimin e marrëdhënieve kapitaliste në Shqipëri, kryesisht në qytete, që nënkupton rritjen e qyteteve në aspektin ekonomik si dhe shkëputjen e tij prej ekonomisë bujqësore, rritjen e borgjezisë qytetare si dhe rënien e sistemit të esnafëve. Por nuk mungojnë dhe banesa me arkitekturë moderne. Këtë lloj banese kemi në rastet e Konsultores dhe vilës nr. 5. Në to vihen re tipare të arkitekturës funksionaliste, si detaje të tipit ballkone, harqe apo dritare të kompozuar në mënyrë të veçantë në ndërtesa. Në banesat e vrojuara shohim se shumë prej tyre janë realizuar me mjeshtra. Në këtë tip ndërtesash kemi një thjeshtëzim të objekteve në fjalë, banesave, në kuptimin që, problemeve të shumta u jepej zgjidhje tradicionale. P.sh, në disa prej banesave, duke mos ditur të bënin këndin e drejtë në cepin ku bashkohet taveni me murin, ata i jepnin formë të rrumbullakët me anë të shisheve. Tjetër tip i takon banesa me oborr të brendshëm. Ndërtimet me mjeshtra kanë si karakteristikë muret e trasha, përdorimin e qerpiçit si dhe brezat antisizmik. Çatitë janë mbuluar me tjegulla prej balte të harkuara dhe mbahen nga trarë druri etj.


ZONA 2

Universiteti POLIS

*Përpunuan: Ada Lushi, Anduena Dragovi, Drilon Shamolli, Gerti Struga,
Punuan: Anduena Dragovi, Eneida Çela, Fabiola Meçaj, Gidian Haderaj, Idit Riza,
Nelson Sejdo, Neshat Malasi, Nexhmi Tupja.*



Zona 2



Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoi: G. Struga

Karakteristikat e Zonës

Zona që do të trajtojmë, ajo nr. 2, shfaqet si zonë interesante përse i përket ndërtimeve. Si vendndodhje rrethohet nga katër rrugë të rëndësishme e të përshkueshme, të cilat do të ndikojnë më pas në trajtat tipologjike të banesave. Konkretisht, zona ndodhet e kufizuar nga rruga "Reshit Petrela" në pjesën veri-perëndimore, në veri-lindje nga rruga "Siri Kodra", në jug-lindje nga

rruga e "Dibrës", me rrugën e "Barrakadave" në jug-perëndim. Këto dy të fundit përfaqësojnë dy akset më të rëndësishme të zonës, për vetë faktin se, karakterizohen nga një tipologji e rëndësishme e ndërtimit të banesave buzë rrugës. Gjithashtu, këto janë dhe akset e vetme të planit urbanistik të vitit 1914. Këto dy rrugë përbëjnë dy akse gjeneruese të qytetit në përgjithësi, por edhe të zonës në veçanti. Nga ana



skematike zona paraqitet me një drejtkëndësh pothuajse të rregullt nga ana e jashtme, por në brendësi rrugët dytësore nuk kanë rregullsi. Përsa i përket tipologjisë së banesave në zonë, kemi të bëjmë me një diapazon të gjerë të tipeve. Me rëndësi të veçantë paraqiten banesat dykatëshe, të cilat kanë akses të drejtperdrejtë me rrugën. Krijimi i këtyre tipeve krijon mundësi në zhvillimin e skemës të banimit në katin e dytë dhe zhvillimin e aktivitetit tregtar në katin e parë. Prania e dyqaneve e bën zonën me aktive dhe luan rol të madh në zhvillimin e zonës dhe qytetit. Tip tjetër i banesave është ajo e banesave tradicionale të zonës, të cilat dallohen për një dekor interesant. Kjo zonë jep, në terësi, një panoramë të të gjitha tipeve të banesave, si ato me apo pa arkitekt. Zona jep, gjithashtu, edhe një tablo të gamës së gjërë të detajeve arkitektonike, që paraqesin në vetvete evolimin e trashëgimisë arkitekturore si në zonë, ashtu edhe të qytetit.

Përsa i përket tipologjive të banesave të zonës nr. 2 duke u nisur nga pozicioni i tyre, mund të bëjmë një ndarje në kategori të vilave. Konkretisht:

- Vila që ndodhen anës rrugës
- Vila tradicionale: a) Vila me shtëpi zjarri
b) Vila me qoshk
- Vila me arkitekt: a) neoklasike
b) moderne

Duke u bazuar në këto kategori, që kanë si qëllim kryesor studimin e tipeve të zonës nr. 2 dhe evidencimin e vlerave unike arkitekturore, më poshtë do të bëhet nën-ndarja e shoqëruar edhe me materialin fotografik.

Studim Vila nr. 1, vilë tradicionale, pronësi e Sali Shijakut



Në zonën 2 të gjitha ndërtesat paraqesin një interes të veçantë për sa i përket shumëllojshmërisë së tyre, por në mënyrë të veçantë do të trajtohen dy vila, të cilat konsiderohen më të plota. Këtu i referohemi anës së mirëmbajtjes të vilës si dhe materialeve të disponueshme për vilat. Vila 1, është vila e piktorit të njohur Sali Shijaku dhe ndodhet në rrugën “Siri Kodra”. Ndërtimi i saj i përket vitit 1400. Shtëpia shërben si restorant tradicional dhe si galeri arti, ku janë të ekspozuara 100 punime në pikturë. Është konsideruar si shtëpia më e vjetër në Ballkan. Mbrohet nga organet shtetërore për vetë vlerat arkitektonike. Vila për nga tipologjia e saj është vilë me shtëpi zjarri. Në fasadën kryesore vërehen elementë interesantë të arkitekturës tradicionale, si brezi i veshur me gurë deri në 30 cm, dritaret e drurit, të cilat për efekt sigurie janë të mbyllura me elemente dekorative hekuri të rrahur. Element tjetër me rëndësi është mozaiku me gurë lumi në oborr. Për sa i përket interierit të vilës janë interesantë elementi i oxhakut dhe shkalla prej druri. Realisht shtëpia ruhet në gjendje mjaft të mirë, ku vlerësohet çdo element arkitektonik.



Fotografoi: A. Dragovi



Detaje të interierit

ZONA 2






Fotografoi: A. Dragovi




Studim Vila nr. 14





Planimetria e katit përdhe



Planimetria e katit parë

Kjo vilë është ndërtuar në vitin 1929-1930 nga inxhinieri A. Pashallari për Xhavit Stermasin që punonte si telegrafist. U ndërtua si shtëpi banimi me dyqane poshtë dhe pavarësisht ndryshimit të pronarëve, struktura ka ndryshuar shumë pak. Vila është trekatëshe me zgjidhje planimetrike në formë drejtkëndëshi. Ambientet lidhen me anën e holleve të vegjël që bëjnë edhe shpërndarjen e dritës, e cila realizohet edhe nga hapje të mëdha që janë në çdo dhomë, verandës, ballkonit si edhe tarracës. Materialet e përdorura janë tulla për veshjen e mureve, beton armeja në zbukurimet e dritareve, hekur i rrahur,

druri, qeramika si edhe granili. Hyrja është e theksuar nga shkallë elikoidale të zbukuruara me balustra baroke me përpjekje për gjeometrizim të formave të rrumbullakosura. Porta është me elemente neoklasike. Shpërndarja e funksioneve në vilë ndryshon sipas kateve. Në katin përdhe ishte pjesa e dhomës së pritjes, ngrënies dhe kuzhinës, ndërsa në katin e parë dhomat e gjumit. Dhoma kryesore kishte dalje direkt në taracë, e cila mund të arrihej edhe nëpërmjet një holli. Bodrumi përdorej si depo ushqimesh, kuzhinë dhe lavapjatë.

Detaje eksterieri

ZONA 2



Detaje interieri




Studim Vila me arkitekt, Vila nr. 10



Kjo vilë mendohet të jetë punë e ark. Qemal Butka dhe mendohet të jetë porositur nga Musa Juka, atëherë funksionar i shtetit. Në këtë periudhë vendin kryesor në ndërtim e zënë vilat, të porositura nga funksionarët e lartë të shtetit, intelektualët si dhe njerëzit e kamur të kohës. Vilat e projektuara në këtë periudhë, sidomos ato të ark. Butkës, dallohen nga një trajtim arkitektonik dhe funksional i veçantë. Rëndësi paraqet edhe

kostruksioni, ku në këtë rast është i kryer nga vetë arkitekti Butka. Vërehet një larmi elementesh arkitektonikë në fasada, duke filluar që nga detajet deri tek elementet e reja arkitektonike, risi për banesat e kohës. Po të vërehet me kujdes në fasadën ballore shfaqet elementi i ballkonit në katin e sipërm, i përfshirë me shumë finesë në kornizën e fasadës, që në një moment, aty për aty, të kujton pallatet aristokrate të Firences së




Medici-ve. Eshtë për t'u nënvizuar dekoracioni i pasur në elementet e dritareve, derve, kolonave dhe elementi i shkallës, si risi totale për periudhën e kohës në Tiranë dhe Shqipëri. Vërehet një elegancë në përpunimin e elementëve arkitektonikë, duke përmendur, në veçanti elementin e dritareve, ku arkitekti e përdor në fillim si modul të vetëm, pastaj e dyfishon dhe kthehet sërisht në përdorimin e modulit fillestar.


Vila nr. 7, rruga “Abdulla Gjinali”



Fotografoi: D. Shamolli



Planimetria e katit përdhe



Planimetria e katit përdhe



Vila jashtë zonës 4, rruga “George W. Bush”



Fotografi të vilave


ZONA 2



Vila nr. 4 , rruga "Abdulla Gjinali"



Vila nr. 2, rruga "Mahmut Fortuzi"



Vila nr. 9, rruga "Isa Boletini"


Fotografi të vilave



Vila nr. 11, rruga "Siri Kodra"



Vila nr. 12, rruga "Zenel Baboçi"





Vila nr. 5, rruga “Siri Kodra”



Vila nr. 6, rruga “Abdulla Gjinali”



Fotografi të vilave



Vila nr. 8, rruga "Isa Boletini"





Vila nr. 13, rruga “Qemal Stafa”



Vila nr. 15, rruga “Shënasi Dishnica”



Vila nr. 16, rruga “Luigj Gurakuqi”



Vila nr. 17, rruga “Luigj Gurakuqi”

ZONA 3

Universiteti POLIS

Përpunoi: Vullkan Qerimi

*Punuan: Anisa Simixhiu, Berald Zeko, Ilia Vangjeli, Ina Kosta, Isa Ukperaj, Klaudia Veizaj,
Klaudio Ruçi, Marsed Lukaj, Jesuida Zemani, Vullkan Qerimi*



Zona 3




Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoi: G. Struga

Karakteristikat e Zonës



Zona në studim pozicionohet në pjesën verilindore nga qendra e Tiranës, pra nga sheshi "Skënderbeu", e cila është e konturuar në formë delte dhe si e tillë kryqëzohet me rrugët "Tafaj" dhe "Dibrës" dhe e mbyll konturin e zonës brinja tjetër e rrugës "Thanas Ziko". Mesin e zonës e ndan aksi tjetër rrugor – "Ali Pashë Guçia", ndërkaq nga këto rrugë derivojnë arterie të tjera në forma të ndryshme trajektuese. Në këtë periudhë vëre-

het se vilat janë komplekse e me prirje të ndryshme. Kjo arkitekturë u përpunua nga mjeshtra, arkitektë dhe inxhinjerë të shkolluar dhe karakterizohet nga një zhvillim historiko-shoqëror i paqëndrueshëm në etapa të caktuara, sidomos në atë midis dy luftërave botërore. Arkitektët dhe inxhinjerët vendas, të pakët në numër dhe që e filluan veprimtarinë pikërisht gjatë kësaj periudhe, nuk kishin arritur të formonin një fizionomi vendase, sidomos në fillimet e tyre, kur ende ruanin



Legjenda:

- Banesa Vernakolare
- Banesa me mjeshër
- Banesa me arkitekt



ndikimet nga shkollat, ku ata ishin formuar. Lindja e kërkesave për gjini të reja arkitektonike, nga njëra anë dhe shtrirja gjithnjë e më shumë e veprimtarisë së inxhinjerëve dhe arkitektëve të shkolluar, nga ana tjetër, sollën ngushtimin e sferës së krijimtarisë së mjeshërave popullorë, sidomos në qendrat qytetare, duke u kufizuar kryesisht në ndërtimet fshatare, ndërsa në qytet, në ndërtimin e banesave.

Në periudhën pararendëse ishte kristalizuar një tipologji relativisht e përparuar e banesës popullore në qytet dhe pjesërisht në fshat. Rritja e mundësive

teknike e teknologjike të ndërtimit dhe shtimi i llojeve të materialeve të përdorura, dhanë mundësinë e përqëndrimit të vëmendjes dhe të aftësive profesionale të mjeshërave popullorë në përpunimin e detajit arkitektonik, ku dhe filluan të marrin vlera të paravura artistike. E reja në këtë arkitekturë u bë më e dallueshme në rritjen e kërkesave për teknikat e reja ndërtimore, përdorimi i gërshetuar midis materialit rrethor tradicional dhe atij modern.

Pëlhura urbane e zonës dhe karakteristikat e parcelave



Pëlhura urbane e zonës ka një larmi karakteresh të tipologjive të ndryshëm kohor. Nga tipet me karakter vernakular, organikë (sidomos gjatë shek. XIX), pastaj vijnë banesat me mjeshtëri (fillimi i shek. XX) dhe më pas, kryesisht pas viteve '20, ku dhe fillojnë e variojnë tipe të tjera të ndërtimeve, me projektues.

Rruga e “Dibrës” dhe rruga “Tafaj” kanë formën e rrugëve radiale, të cilat të çojnë drejt qendrës së qytetit, ku më parë ndodhej edhe Pazar i Vjetër. Rruga “Thanas Ziko”, që lidh këto dy rrugë, shërben si model për krijimin e rrugicave në zonë me të njëjtin drejtim, të cilat mund t'i ndajmë në dy kategori që: bëjnë lidhjen e dy rrugëve kryesore dhe të çojnë në një banesë të vetme.

Rrugët dhe struktura e tyre në zonë

Muret e larta që rrethojnë banesat i japin zonës një karakter intim dhe pak të aksesueshëm nga rruga. Kjo njëllojshmëri në gjithë zonën sjell dhe mbizotërimin e një monotonie, e cila thyhet vetëm nga kalldrëmi karakteristik dhe dyert e ndryshme artizanale. Një element tjetër, i cili bie në sy është edhe prania e oborreve brenda perimetrit të banesave të pasura me drunjë frutorë. Zona, që më parë karakterizohej nga banesat e ulta një-dy katëshe, tashmë ka filluar shndërrimin e saj në një zonë me banesa të larta shumë familjare duke prishur harmoninë e mëparshme.


Mënyra se si zhvillohej struktura urbanistike, krijimi ose tentim-zgjerimi i arterieve kryesore i rrjetit rrugor të zonës, ngrinin kërkesa të reja dhe ndaj arkitekturës së banesave që mbushnin këto rrugë. Tashmë vendosja më e zakonshme e banesave ishte me orientimin e pamjes kryesore ndaj rrugës. Ato dilnin drejtpërsëdrejti në rrugë, ose ishin pak të futura brenda një oborri të vogël, që dilte përpara.

Oborret kryesisht janë të rrethuara me mure të ulëta, ku shpesh haset ndonjë kangjellatë transparente. Lidhur ngushtë me këto kritere bëhet edhe trajtimi i oborreve të banesave. Parcelat e vogla përpara konsiderohen jo si njësi ekonomike, kopësht apo punishte, por trajtohen si lulishte me pjesët e lëna për lule dhe rrugicat e shtruara për kalime, ndërsa tek-tuk ngrihen drurët me qëllim dekorativ.



Rruga “Thanas Ziko” dhe arteriet e saja

Pozicionimi i oborreve ndaj rrugës



Skicoi: Marsed Lukaj

Lagjet që përshkohen nga rrjeti rrugor i zonës, i cili pavarësisht nga drejtimi i arterieve që ka në zonë, duket se tenton t'i ruajë ato forma të rregullta geometrike. Rrugët, në përgjithësi, ndërpriten në kënde të drejta, ku si rezultat derivonin parcela të vogla drejtkëndore. Kryesisht janë të kthyer me pamje ballore nga rruga. Përpunimi arkitektonik i pamjeve anësore, madje edhe i atyre të prapme dhe i portave të oborrit, kontrasti i teknikës së muraturës së banesave dhe të mureve që i rrethonin, kanë arri-

tur ta thyejnë ritmin monoton, që mund të përsëritë motivi i njëjtë, ku në përgjithësi nxjerrin një fasadë të pasur. Edhe pse kishte ndryshime dhe ndërhyrje në zonë gjatë periudhave të ndryshme kohore, tek një pjesë e madhe e vilave nuk ndikoi që të pësonin ndryshime në përkatësinë e tyre. Me gjithë ndërhyrjet e reja tipologjike, nuk u arrit të ngushtoheshin sipërfaqet e oborreve të vilave të vjetra në zonë. Kjo bëri të ruhej zona bazë e përkatësisë së tyre fillestare.



Gjatë kësaj periudhe, mënyra se si dekoroheshin apo suvatoheshin elementët e jashtëm të ndërtesës kishin një rol të rëndësishëm se si dukeshin, ose se çfarë pamje kishin vizualisht fasadat. Pjesa vernakolare e ndërtimeve, të cilat ishin të ndërtuara me qerpiç, suvatimi thuhet nuk aplikohet, me kalimin e kohës, kur filluan të ndërtoheshin tipe të reja ndërtimi, si ato me mjeshtëri dhe me projektues apo arkitekt, ndërtimi që bëhet me tulla, krijoi një fushë të gjërë të zbatimit të elementëve dekorative në suva. Elementët që do t'i nënshtroheshin përpunimit dekorativ parapërgatiteshin që gjatë ndërtimit të muraturës. Mbi këtë sipërfaqe bëhet mbushja me suva dhe pastaj duke kaluar shabllonet mbi to, u jepet elementëve forma sipas dëshirës. Nënshtrimi i përkujdesjes dekorative me teknikë aplikimi të materialeve të reja sa vinte e avancohej.

Elementi i dritares filloi e krijoi motive në formë vetulloreje sipër hapësirës së dritares, ku në disa raste në skaje tek-tuk edhe në mesin e e kësaj kornize dalin pilastra, të cilat nuk zbresin deri në fund të dritares dhe trajtoheshin herë me kanelura e herë me korniza të dyfishta me përpunime të lakuara etj.

Elemente të tjera të fuqishme të përpunimit dekorativ ishin kornizat, në mënyrë të veçantë ato nën çati, ku në tipologjitë e reja materiali i ri i përdorur në ndërtim e bënte të panevojshëm nxjerrjen e strehëve të gjëra mbrojtëse për dallim nga tipologjitë e vjetra, që trajtoheshin me më shumë kujdes në këtë pjesë. Si rregull korniza nën çati lidhej me pilastrat e dala në qoshe dhe ndonjëherë edhe në mes të fasadës dhe krijohet kështu një konturim i sipërfaqeve, ku shpërndahen elementë arkitektonikë dekorativë dritaret dhe relievet e ndryshme.



Studim Shtëpi zjarri- Banesë vernakolare



Banesa me shtëpi zjarri, është një nga tipologjitë më të vjetra të banesave ilire. Ato gjenden në Radovinë, Donja Dolina, zhvillohet më tej në Kasopë, Çukën e Ajtoit, Oraion dhe shfaqet përsëri në banesën tiranase në shekullin e XVIII-XIX. Në këtë banesë, shtëpia e zjarrit luan rol shumë të rëndësishëm në organizimin hapësinor, por edhe në organizimin e jetës së banorëve dhe këtë e dëshmon edhe fakti që merr emërtimin si “shpi zjarri”, pra kjo kthinë merr përsipër atributet e tërë banesës. Shtëpia e zjarrit është nukli, i cili mbledh përreth tij gjithë familjen, ose miqtë duke shërbyer si një hapësirë ndenjeje, ngrënie (kuzhinë), ngrohje, (madje në lashtësi edhe fjetje). Në këtë kuadër shumëfunktional, kjo dhomë, luan një rol tepër të rëndësishëm.

Në rastin e banesës së zbuluar në rrugën “Thanas Ziko”, prona e Egerem Shatkut, ish shtetas maqedo-


nas, daton rreth vitit 1860. Shtëpia e zjarrit ka një lartësi njëkatëshe, rreth 4-5 m dhe planimetri drejtëkëndore. Vatra e devijuar nga hyrja, për të shmangur rrymat e ajrit, me dy dritare në të majtë të hyrjes, i ka shërbyer familjes si një hapësirë gatimi, ngrohje dhe grumbullimi. E ndërtuar me qerpiç, pa tavan, ku çatia nuk është totalisht e puthitur me muret në mënyrë që të largohet tymi i zjarrit të vatrës dhe është e ndërtuar me dru mareje dhe dushku. Megjithatë sot kjo shtëpi zjarri rezultonte në pjesën e pasme të banesës, mendohet se hyrja ka qenë e pozicionuar ballë kësaj dhome, nga do të kalohej në një korridor, i cili bënte shpërndarjen për në dy kthina të tjera të vendosura përballë njëra-tjetrës në mënyrë simetrike. Tuelalet ndodheshin i shkëputur nga pjesa tjetër e banesës në zonën më fundore.



Planimetria

Vila në rrugën "Thanas Ziko" - Pronë e Eqrem Shatkut / Skicoi: K. Ruçi


Studim Shtëpi me hajat - banesë vernakolare




Banesa me hajat, pasardhëse e shtëpisë së zjarrit, gjithashtu një tipologji shumë e vjetër është takuar për herë të parë në vendbanimin e Oraionit. Hajati nuk është gjë tjetër, veçse një hapësirë, e cila shërben si një nukël shpërndarjeje si dhe për të shmangur rrymat e ftohta. Tek banesa jonë, ajo është një hapësirë e mbuluar në pjesën e sipërme dhe e hapur në anën ballore, ku mbajtja realizohet përmes dy kolonave. Prej këtij hajati bëhet shpërndarja simetrike në dy hapësira; djathtas, dhoma e pritjes, me lartësinë e një kati e gjysëm, me dritare në krahun ballor të banesës dhe oxhak; majtas realizohet hyrja në një kat

gjysmë të nëndheshëm, që ka shërbyer si depo për grumbullimin e gjërave, ushqimeve, etj, dhe përmes shkallëve ngriheshëj në një kat të plotë që shërbente për fjetje. Shkallët e jashtme për të hyrë në këtë kat, ishin shtuar më vonë. Kuzhina dhe banjat ishin të shkëputura nga banesa, të vendosura në të majtë të oborrit, i cili zinte hapësirën më të madhe të parcelës. Banesa është e ndërtuar me qerpiç dhe çati druri. Elementët tek dritaret janë ruajtur prej origjinaleve. Banesa me sipërfaqe 315 m², i përkiste Met Pampurit, të ardhur nga Dibra e Madhe rreth viteve '25.

Planimetria





Fasada / Skicoi: J. Zemani



Fragmente nga shtëpia vernakolare - Pronë e Met Pampurit

Studim Shtëpi me oborr - banesë me oborr të brëndshëm




Shtëpi me oborr të brëndshëm

Një nga shembujt më tipik të kësaj zone është banesa me oborr të brëndshëm. Duke qenë se të gjitha banesat një deri në dy kate të kësaj zone ishin të rrethuara me mure, ishte e vështirë të kuptoje nga jashtë tipologjinë e banesave, por sapo kalon këtë mur, pothuajse të gjitha banesat janë të njëjta. Banesa, që morëm në studim përbëhet nga dy nukle kryesore. Pjesa majtas përdoret kryesisht për dhoma dite, ngrënie, ndejtje, ndërsa nukli i dytë përdoret për dhoma gjumi. Në mes qëndronte shumë i veçantë oborri i gjelbëruar me pemët e limonit. Meqë dy nuklet funksiononin si të veçuara edhe tualeti ishte jashtë. Banesa me oborr të brëndshëm vjen pas atyre

vernakolare dhe para banesave me mjeshtër. Ajo i përket viteve 1900, ku duket degradimi i tyre i pjesshëm edhe në muret e trasha, murin e qoshes (gjithmonë më i zbukuruar se të tjerët). Çatia e kësaj banese ishte dy-ujëse, por duhet thënë se jo të gjitha banesat me oborr të brëndshëm kishin të njëjtin organizim. Mund të ishin të përbëra edhe nga një nukël i vetëm, që i vjen përqark oborrit në formë të drejtë ose "L". Pas kësaj tipologjie banesash dallohen ato me mjeshtër, sidomos për mënyrën e ndërtimit. Kjo dallohet që në detajet e banesës si dekoracionet, muri i qoshes më i përpunuar dhe është më e menduar mënyra e organizimit të brëndshëm.




Studim Banesa me mjeshtër




Vila në studim pozicionohet në veri-lindje të Tiranës, pikërisht 100 metra në afërsi të kryqëzimit të rrugëve “Siri Kodra”, “Tafaj” dhe ajo e “Dibrës”. Kjo banesë dibrane e Mesjetës së vonë lidhet pothuajse me periudhën e pushtimit osman, e cila kishte krijuar kushte për një ekonomi të mbyllur familjare dhe i jepte banesës një sërë funksionesh. Kjo vilë kufizohet në veri me rrugën e “Dibrës”, e cila ka influencuar në shtrirjen e oborrit të vilës, në drejtim të jugut. Vila është afro 150 vjeçare, e ndërtuar me qerpiç, në përbërjen e saj ka edhe ndërhyrje të tjera me qëllim rikonstruktimi. Është një vilë e ndërtuar me mjeshtër dhe ka pasur ndërhyrje rikonstruktuese të vazhdueshme në periudha kohore 5 vjeçare. Banesa është

e organizur në mënyrë të tillë, që të gjitha funksionet e veta t i përmblihte në oborrin e vet. Është një vilë me oborr të brendshëm. Gjithashtu, vila në vetvete është me dy kate banimi, një korridor qendror edhe dy dhoma ndenjeje në çdo kat të saj. Kati i parë i banesës ka një shtesë aneksi, i cili më vonë kthehet në ballkon. Kati përdhes i banesës aktualisht ka funksion miks (banim+biznes), ndërsa ai i parë ka vetëm funksion banimi. Kati përdhe i banesës nga ana e veriut përdoret për qëllime biznesi dhe nga drejtimi i jugut për qëllime banimi. Gjatë viteve ’80 në vilë është bërë një shtesë, duke rinovuar kuzhinën dhe tualetin e saj. Ndërkohë në oborr gjenden elemente të pasura natyrale.

Interier dhe eksterier




Planimetri e katit përdhe



Planimetri e katit parë




Skicoi: I. Vangjeli




Skicoi: Ilia Vangjeli


Studim Banesa me arkitekt




Rreth viteve '30, banesat ndërtoheshin nga arkitektë të shkolluar, duke shënuar fundin e asaj, që ne e quajmë arkitekturë popullore. Elementët strukturalë të kësaj tipologjie kryesisht janë me drunj, tulla, qerpiç dhe muraturat janë të ndërtuara me gurë të lidhur me breza druri dhe fugatoheshin trashë. Në vilën e marrë në studim, pjesa e çatisë ishte kryesisht me elemente druri dhe e mbuluar me tjegulla vendi. Sor këto karaktere tipesh ruhen të fragmentuara. Vila në studim ndodhet në rrugën "Thanas Ziko" në pronësi të Kadri Spahiut, 81 vjeçar (me prejardhje nga Prizreni), projektuar nga një arkitekt italian (nuk dihet emri i projektuesit). Është orientuar nga pjesa veri-perëndimore, e ndërtuar në vitin 1930, periudhë, që përkon me stilin modern të arkitekturës. Fillimisht kjo vilë ishte projektuar për familje, por më pas pësoi ndryshime. Banesa ka një oborr të vogël, e pasur me elementë të ndryshëm natyral, pemë me fruta të ndryshme dhe lulishte. Skema e ndërtimit të banesës është si vilë dy katëshe, ndërsa jashtë, nga ana e majtë derivon aneksi me përmasa 2 m x 3 m, vazhdon kuzhina dhe më pas këto i ndan tualeti, që është afër portës kryesore. Pjesët që përmendëm gjenden jashtë banesës dhe disa prej tyre janë shtuar në kohëra të ndryshme. Duke u nisur nga planimetritë, kati përdhe ka dy dhoma me përmasa 5 m x 4 m, pra janë simetrike dhe korridorin, i cili është në mes të dhomave me përmasa 3 m i gjerë dhe 5 m i gjatë. Kështu është i ndërtuar edhe kati i parë në plan. E tillë ishte kjo skemë në projektimin fillestar, por më pas babai i Kadri Spahiut e ndau vilën në dy pjesë. Mënyra e ndarjes së shtëpisë u bë në mes, koridori u nda përgjysmë si lartë dhe poshtë dhe u shtuan shkallët nga jashtë, për të pasur qasje direkte në katin e parë. Është e pasur me elementë dekorativë, sidomos në pjesët e dyerve dhe dritareve, që rrethohen me fashatura të dekoruara në pjesën e sipërme, ndërsa dritaret anësore janë të dekoruara me motive floreale. Këta elementë dekorativë janë të ripërpunuar nga origjina e tyre, por gjithmonë duke ruajtur gjuhën pamore.




Planimetri e katit përdhe




Planimetri e katit parë



Pamje ballore



Pamje nga sipër / K. Ruçi




Aksonometri / K. Ruçi




Studim Banesa me arkitekt



Vila në studim është pronësi e familjes Veriu, ndodhet në rrugën “Tafaj”, në anën veriore të saj. Banesa paraqet fazën më të përpunuar të variantit që po analizojmë. Ajo është e tipit një familjar me oborr të brendshëm. Vila është e projektuar në 14-II-1934 nga arkitekt italian. Edhe kjo vilë përkton me frymën moderne. Ndonëse ruhet në mënyrë të veçantë për kompozimin planimetriko-vëllimor dhe trajtimin arkitektonik e dekorativ të njësive dhe elementëve përbërëse të banesës në periudha të ndryshme kohore, banesa ka pësuar ndryshime dhe është ndarë në dy kate duke u kthyer banesë e tipit dy familjar. Shkallët e brendshme hiqen dhe për të hyrë në katin e sipërm janë ndërtuar shkallë të jashtme. Kjo banesë nuk ka pësuar ndryshime vetëm në elementë arkitektonik, por edhe në dekor, për shkak të rikonstrukcioneve gjatë viteve. Ndryshohet dizajni dhe dritareve, gjithashtu në anët e mureve shtohen dekore. Në shkallët e shtuara çatia mbahet nga dy kolona të stilizuara të orderave pa kanelura me bazament dhe kapitel me motive floreale. Planimetria e vilës ka një zgjidhje simetrike, me një korridor në mes dhe dhomat anash. Në çdo dhomë ka oxhak dhe tavani është prej druri, ndërsa çatia është me tjegulla. Vila ndodhet në një zonë urbane, ku lartësia e ndërtesave nuk i kalon tre kate. Diferencimi i teknikës dhe i trajtimit të dy kateve është i theksuar nga një kornizë, që qarkon gjithë vilën tek pamja ballore, ku dhe ruajnë kornizimin e vjetër të fashaturave të trajtuara mirë estetikisht për periudhën që i përkonte.




Planimetri e katit përdhe



Planimetri e katit parë




Pamjo ballore





Vila e vendosur me kontekstin


Studim Banesa me arkitekt





Në vitin 1931, inxhinier Pashollari, kryearkitekt i Bashkisë së Tiranës, projektoi tri vila të njëjta, i cili vazhdoi më tej së ndërtuari edhe me vilën e madhe, të bukur e funksionale të tij. Në vitin 1933 rruga “Tafa” mori formë. Gjatë viteve 1937-1938 u bënë kanalizimet dhe më vonë u asfaltua. Në trojet e Prezave u ndërtua shkolla “Er’hem Toto”. Në vitin 1939, italianët ndërtuan aty barakat për karabinierë me kuaj, pastaj erdhën karabinierët këmbësorë. Mbas çlirimit po aty u ngrit Kursi i Shoferëve, ku sot është shkolla “Partizani”. Sipas projektit të arkitektit Anton Lufi, vila e fokusuar për studim u ndërtua në vitin 1935, një vilë e bukur dykatëshe e dr. Anton Ashtës. Ai ishte mjek mariollog, doktor i shkencave, studiuar në Romë. Falë kontributit të tij dhe të bashkëpunëtorëve, në vitin 1960 sëmundja e malaries në Shqipëri u konsiderua e zhdukur. Djali i tij, Zef Ashta, u bë

ekonomist i zoti, por edhe “Mjeshtër i madh i shahut”. Në këtë shtëpi banonte edhe z. Pjerin me znj. Antoneta, motra e Kardinal Koliqit dhe shkrimtarit Ernest Koliqi, si dhe vajzat e tyre, Terezina, Luiza dhe Jola. Vila është dy katëshe me siperfaqe 370 m². Aktualisht në të jeton i biri, Zef Ashta. Ka një ndarje të përcaktuar mirë të funksioneve, ku ambientet e ditës të përbëra prej 4 dhomash janë të përqëndruara në katin përdhe, ndërsa ambientet e natës, gjithashtu 4 dhoma, janë të vendosura në katin e parë. Për sa i përket dekoracionit vila është mjaft e detajuar, përmendim këtu detajin e hyrjes dhe të ballkonit, i cili është zbukuruar me elemente në formë birilash. Detaje të tjera interesante janë zbukurimet sipër dritareve të ashtuquajtura “elikoidi i Arkimedit” si dhe dekorimet me motive floreale. Tri kolona ndeshen në verandë, të cilat kanë funksion konstruktiv.






Planimetria e katit përdhe







Planimetria e katit parë



Bodrumi Prerja






Detaje




Skicoi: M. Lukaj



Skicoi: M. Lukaj

M. Lukaj



Skicoi: M. Lukaj



Skicoi: M. Lukaj

M. Lukaj

Përmbledhje



Megjithëse zona është shpallur historike, është lënë totalisht në harresë, duke i zënë banorët në kurthin e të jetuarit në kushte jo të sigurta e jo të shëndetshme.

Qëllimi i kërkimit është evidentimi, njohja dhe ruajtja e vlerave arkitektonike, që kanë arritur të ruhen deri në ditët e sotme, për të krijuar një album në trajtën e një harte referuese, dokument edhe për të ardhmen. Përsa i përket punës në terren dhe mbledhjes së informacioneve, na është dashur të hyjmë në kontakte me banorët e zonës përkatëse, të cilët janë treguar mjaft të gatshëm për të bashkëpunuar e informuar, madje duke krijuar afrimet, treguar pakënaqësitë e tyre lidhur me punën e organeve përkatëse për rikonstruktimin dhe mirëmbajtjen e banesave. Pothuajse të gjitha familjet e intervistuar, shprehen se megjithëse zona është shpallur historike, është lënë totalisht në harresë, duke i zënë banorët në kurthin e të jetuarit në kushte jo të sigurta e jo të shëndetshme.

ZONA 4


Universiteti POLIS

Përpunoi: Emel Peterci, Erida Hoxha

Punuan: Egi Bozo, Eranda Janku, Fiona Imami, Fiordi Mata, Imeldi Sokoli, Kejt Dbrami, Rudien Cali, Shpendi Balilaj



Zona 4



Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoit: G. Struga

Karakteristikat e Zonës

Q ë të kuptosh dhe interpretosh në mënyrë të duhur një arkitekturë, është e rëndësishme që ajo të vlerësohet në aspektin historik të zhvillimit. Kjo lidhet si me faktorë njerëzorë, ashtu edhe me faktorë të tjerë të pashmangshëm natyrorë apo të lidhur me klimën dhe pozitën gjeografike. Ajo, që analizës sonë i intereson

është vështrimi mbi zhvillimin e indit urban të zonës rrethuese të sheshit "Avri Rustemi". Për të kuptuar më mirë marrëdhënien që ekzistonte mes qytetarit tiranase dhe zonës, ku banonte, duhet studiuar e analizuar tipologjia e banesës tipike tiranase, në aspektin kompozicional të jashtëm të saj dhe në atë të organizimit të brendshëm.

Vendndodhja e vilave



Kompozimi i vilave




Mur i lartë me qerpiç
Materiale: guri, qerpiçi, çatma
Çati me tjegulla të kuqe
Shtëpi me një - dy kate

Nga ana e jashtme elementi i parë përcaktues i banesës tiranase është pozicionimi i saj në fund të oborrit, larg rrugës si dhe muri i lartë rrethues prej qerpiçi. Ky dëshmon për një ndjesi intimiteti, që përkon me kulturën tiranase të kohës. Nga rruga, nëpërmjet një porte të madhe, e dallueshme në plan nga një çati mbuluese, kalohet në oborrin e brendshëm, që konsiderohet hapësirë pozitiv-negative e rendit të parë. Këtu është lartësia e murit rrethues dhe e drurëve të lartë, ajo që e bën oborrin komplet intim e të përdorshëm vetëm nga pjesëtarët e familjes. Kalimi për në hapësirën e brendshme bëhet nëpërmjet një shtojce tjetër, që është Hajati. Ky, si hapësirë pozitiv-negative e nivelit të dytë, nga pikëpamja psikologjike të krijon idenë e hyrjes brenda në shtëpi, si një lloj atriumi, a verandë e mbuluar nga sipër me çati. Hajati paraqitet në disa nivele përpunimi, që nga më i thjeshti, me ngritje minimale nga niveli i oborrit dhe një rrjesht kolonash në krye, në më të ndërlikuar, ku ndërfiten edhe elementë të çardakut. Në këndvështrim të organizimit të brendshëm, elementi thelbësor i shtëpisë


tiranase është dhoma e zjarrit, rreth së cilës kryhen aktivitetet kryesore të përditshme. Në mure gjenden dollapët, kurse sergjenët, dybeku, etj, përbëjnë këndin e ngrënies dhe gatimit. Në shtëpitë dykateshe mafili përbën korridorin e orientuar drejt odës kryesore, ku bëhet komunikimi me dhomat e gjumit. Pra, nga pikëpamja e rangut funksional, dhoma e zjarrit, meqë ngrihet edhe në dy kate, merr përparësi, më pas renditet mafili, i orientuar drejt dhomës së zjarrit dhe në fund hapësira e gatimit, e punëve, që është e orientuar nga hajati. Me zhvillimet e mëtejshme ekonomike, shtëpia tiranase pësoi ndryshime të shumta. Së pari u shtuan aktivitetet tregtare. Deri atëherë tregtarët shisnin vetëm në hapësirën e tregut, që ishte shndërruar në nuklin ekonomik të qytetit. Më pas filluan të integroheshin minidyqane në oborret e shtëpive, me dritare të hapur nga ana e rrugës. Kështu u rrit aktiviteti e dinamizmi në rrugët e ngushta dhe u shtua një zgjerim i shtëpisë, që përdorej si dyqan zejesh, etj.. Zona në studim, duke patur edhe shtëpi të vjetra, pritej të shpaloste tipologji më vete.



Hajat
Çardak i vogël pranë dhomës së miqve
Çardak i madh
Skema me një e dy krahë



Hajati i poshtëm me funksion pune
Shkallë e orientuara në drejtim të kundërt me hyrjen e hajatit
Çardaku me funksion çlodhës e estetik



Mbulim në tre anë me mure
Parmakë druri në anën e lirë
E ngritur në katin e dytë

Planet rregulluese



Pamje e sheshit “Avni Rustemi” nga perëndimi



Pamje e sheshit “Avni Rustemi” nga lindja



Pjesë e planit urban të 1923, qendra dhe pazari

Do të ishin ndërhyrjet italiane ato që do t'i ndryshonin komplet fytyrën Tiranës së vjetër, duke i dhënë asaj një penelatë dekorative e fryme perëndimore. Në periudhën gjatë luftërave botërore, nisën të implementohen në Tiranë planet e para rregulluese:

Plani i parë, viti 1923, nga arkitektë austriakë

Plani i dytë, 1926, implementuar sipas ideve të Masterplanit të Brasinit

Plani i tretë, 1928, nga arkitekt Kohler

Plani i katërt, 1929, pas shpalljes së A. Zogut mbret

Këto plane, përgjithësisht, kishin synimin e ndryshimit të fasadës prej tjegullave të kuqe të Tiranës së vjetër, duke i dhënë një pamje të re qytetit. Ndërhyrjet kryesore ishin ato në qendrën e qytetit dhe fillojnë me ndërtimin e bulevardit, shoqëruar me prishjen e pjesëve të xhamive dhe pazarit të vjetër, krijimin e akseve kryesore radiale e planifikimin e zgjerimit lindor e verior të qytetit në rrugë kuadratike. Në planin e dytë flitet për herë të parë për krijimin e sheshit “Skënderbej”, në formë shumëkëndëshi të parregullt, gjithashtu përmendet sheshi “Avni Rustemi” si përfundim i një aksi rrugor radial të fuqishëm, që nisej nga qendra.

Ndërkaq në vitin 1928 plani parashikon një sërë ndërtimesh të tipit vila të arkitekturës bashkëkohore. Këto do të formëzonin një tip të ri banese në Tiranë dhe ndikimi i tyre do të arrinte deri aty, sa të përpuheshin godinat e vjetra me elementë dekorative të periudhës italiane.

Vila nr. 1, rruga “Xhorxh Martini”



Vila nr. 5, rruga “Fadil Rada”



Vila nr. 3, rruga “Hoxha Tahsim”

ZONA 4



Vila nr. 6, rruga “Hoxha Tahsim”



Fotografi të vilave



Vila nr. 3, rruga "Tefta Tashko"



Vila nr. 4, rruga "Fadil Rada"



Vila nr. 7, rruga "Hoxha Tahsim"



Vila nr. 8, rruga "Tefta Tashko"



Vila nr. 9, rruga "Tefta Tashko"



Vila nr. 10, rruga "Tefta Tashko"




Vila nr. 11, rruga "Tefta Tashko"

ZONA 5

Universiteti Polis


Përpunuan: Anduena Dragovi, Gerti Struga

Punuan: Aristeia Dinaku, Eriketa Rrenjollari, Ira Shalzi, Irista Zusi, Jona Qirici, Smeralda Lami



Puno: A. Dragovi

Zona 5



Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoi: G. Struga

Karakteristikat e Zonës

Zona në studim ndodhet midis rrugëve “Ferit Xhajko”, “Dibrës”, “Siri Kodra” dhe “5 Maji”. Në gjenezën e saj, kjo lagje e sotme e Tiranës, ka qënë një zonë periferike e qendrës së vjetër historike. Në të vërehen tipologji të ndryshme ndërtimesh me karakter banimi. Mënyra si ka evoluar qyteti i Tiranës, të bën të mendosh se edhe kjo zonë ka zhvillim normal të niveleve urbane. Banesa

tipike e Tiranës e asaj kohe ishte një ose dy kate, e ndërtuar me qerpiç dhe të distancuara nga njëra-tjetra, me kopshte të rrethuara, me mure relativisht të ulta, të cilat zgjateshin rrugëve. Këtë tipologji e gjejmë ende në ditët e sotme, të paktë në numër, edhe pse numerikisht përbënte objektin kryesor të qytetit. Në aspektin urbanistik, banesa qëndronte terësisht pasive, për shkak të tërheqjes së saj nga rrugët kryesore. Me kalimin e


Vendndodhja e vilave



kohës këto raporte ndryshojnë. Më pas filluan të ndërtoheshin banesa, që dalin në ball të rrugës dhe me pamje kryesore të drejtuar ndaj saj. Dyqanet tek Pazari i Tiranës shtriheshin brenda hapësirës së kufizuar nga rruga e “Barrikadave”, rrugës së “Dibrës”, rrugës së sotme “Luigj Gurakuqi” dhe prej një pjese të sheshit të qendrës së Tiranës, duke u shkëputur nga qendra e

qytetit dhe duke dalë në buzë të rrugës. Këtë tipologji, ku kati i parë është dyqan dhe kati i dytë për banim, i vemë re të ndërtuara përgjatë rrugës së “Dibrës”. Në ditët e sotme, këto objekte arkitekturore-historike, po lihen pas dore. Shumë prej tyre janë prishur për t’i lënë vendin një ndërtimi të ri.

Analiza



Viti 1939



Viti 2011

Metamorfoza e sistemit rrugor

Zona konturohet nga tre akse kryesore: rruga “Ferit Xherko”, që është pjesë e unazës së madhe të qytetit, “Siri Kodra” dhe rruga e “Dibrës”. Dy të parat janë akse dytësore, të cilat bëjnë mbylljen e kësaj hapësire urbane, ndërsa rruga e “Dibrës” përbën një aks gjenerues të qytetit në tërësi dhe të zonës në studim. Ky aks është baza prej nga lind vetë kjo hapësirë urbane, për shkak të rëndësisë së saj në periudha kohore të ndryshme. Është aksi i vetëm që bënte pjesë në planin urbanistik të 1914. Zona, në veçanti, nuk ka bërë pjesë në asnjë plan urbanistik të mirëfilltë.

Deri para viteve 1939 plani ekzistues arrinte të plotësojë kërkesat për një popullsi të vogël në numër dhe kryesisht të përfshirë në afërsi të qendrës së qytetit. Rrjedhimisht të gjitha aksat e tjera rrugore kanë ardhur si pasojë e ndërtimeve të mëtejshme të bëra në zona të ndryshme.

Kjo rrugë është ndërtuar në një sistem kodrinor, gjë që pasqyrohet dhe në hartën e vitit 1939, pasi rruga ndjek terrenin. Në rrugën e ditëve të sotme, që është përfshirë në një plan rregullues, kjo gjë nuk ndodh. Në një formë skematike shohim se zona për-



Viti 1939



Viti 2011


faqësohet nga një trekëndësh, pothuajse kënd-drejtë, që konturohet nga këto tre akse, duke formuar tri nyje shpërndarje kryesore dhe me një aks gjenerues dhe lidhës të hapësirës brenda kufijve me vetë qytetin e Tiranës. Nga një analizë më e detajuar e sistemit rrugor, me anë të evidentimit të rrugëve ndihmëse të brendshme shohim se ekziston tendenca për të ruajtur një sistem kuadratik të rrjetëzuar, që ndiqet nga vetë objektet. Në hartën e ditëve të sotme ky sistem ka dendësi më të madhe, nisur nga rritja e objekteve në këtë hapësirë.



Viti 1939



Viti 1939




Viti 1939


Metamorfoza e bosh-it

Deri në 1939, për shkak të një popullsie jo të madhe në numër, raporti i hapësirës bosh-plot është shumë ndryshe nga gjëndja aktuale e viteve të fundit. Deri atëherë shfrytëzimi i tokës ka qënë i kufizuar, rrjedhimisht edhe hapësirat boshe ishin më të shumta në numër. Duke marrë parasysh edhe buxhetin e shtetit të atëhershëm shqiptar, ndërtimet e progra-


muara nga vetë shteti ishin të limituara dhe të përqëndruara kryesisht në afërsi të qendrës. Rrjedhimisht e gjithë pjesa tjetër, me përjashtim të ndërtesave private, përbënte një hapësirë rurale të pashfrytëzuar. Sot ky raport ka ndryshuar, madje ka arritur edhe në atë fazë, ku nuk respektohen më as kufijnjtë e shfrytëzimit të tokës dhe as hapësirat publike.



Viti 1939



Viti 1939



Viti 1939

Metamorfoza e plot- it

Deri në vitin 1939 përqëndrimi i objekteve ka qënë në brendësi të akseve kufizuese dhe në afërsi të nyjeve kryesore, me përjashtim të objekteve të ndërthurura midis banimit dhe tregtisë, objektet e tjera

ruajnë një farë distance nga rruga, duke rritur intimitetin brenda banesës. Sot është rritur dendësia e banesave dhe objekteve tregtare duke u prirur për t'u zhvilluar në drejtim të akseve.

Metamorfoza e ngritjes në vertikali

Pas viteve 1939 rritet rëndësia e vendosjes së disa limiteve në lidhje me ndërtimet private dhe publike. Ishte në fuqi ligji, i cili nuk lejonte ndërtimin e objekteve më të larta se dy kate. Shumë rrallë mund të gjeje një objekt që ishte trekatësh, ndërsa objektet njëkatëshe përfaqësoheshin nga banesat e vjetra të familjeve me të ardhura modeste. Prania e një ligji të

tillë tregon ndryshimin në vlerësim të vëtë hapësirës urbane. Në gjithë zonën gjejmë objekte një - dykatëshe, të cilat ofrojnë në pamje ndryshe nga kjo e ditëve të sotme. Silueta e qytetit në këtë zonë ishte uniforme. Sot objektet janë të lartësive dhe tipologjive të ndryshme, që të largon nga imazhi i Tiranës së dikurshme.

Tipet e banesave



Kur përdorim termin shtëpi, ndodh të krijoshë në mendje imazhin e shtëpisë së fëmijërisë. Shtëpia nuk është vetëm objekti, i cili plotëson nevojën e njeriut për t'u strehuar, por është vendi në të cilin njeriu krijon botën e tij individuale duke e personalizuar atë. Shtëpia është ajo që përfaqëson një kulturë, një

traditë dhe përcjell me anë të formës, detajeve atë që i përket historisë. Në këtë zonë të Tiranës gjejmë forma dhe tipe të ndryshme të banesave, të cilat kanë të përbashkëta dhe dallime nga njëra-tjetra, por gjithësesi duke treguar një evolim kronologjik të historisë.

Banesat dykatëshe



Vila nr. 2, rruga “Dibrës”



Vila nr. 3, rruga “Dibrës”


Këto banesa kanë akses të drejtpërdrejtë në rrugën e “Dibrës” dhe bëjnë pjesë në tipin e parë të zonës, i veçantë për sa i përket ndërtimit të viteve ‘20. Mundësia e komunikimit të drejtpërdrejtë me rrugën bën të mundur krijimin e dyqaneve në katin e parë dhe zonës së banimit në katin e dytë. Krijimi i fasadave të hapura në katin e parë ishte një risi për ndërtimet e asaj periudhe. Ky element i ri që futet në banesa ndikon pozitivisht si në sistemin e organizimit të zonës edhe në frekuentimin e saj. Ekzistenca e dyqaneve përgjatë rrugës thyente monotoninë duke i

dhënë gjallëri, pasi tërhiqte më shumë njerëz dhe bënte jetën më aktive. Kjo tregon për rëndësinë që kishte rruga e “Dibrës”, si një rrugë tregtare e asaj kohe. Kjo mënyrë konceptimi i ka mbijetuar kohës, pavarësisht ndërhyrjes në fasada, pra konceptimi i tyre mbetet i njëjti. Vendosja e njëpasnjëshme e këtyre objekteve krijon një lloj vazhdimësie. Hyrja për në banesë bëhej nëpërmjet një oborri, që ndodhej në pjesën e prapme të objektit, ndërsa hyrja bëhej nga dera në pjesën anësore të fasadës.


Studim Vila nr. 1, pronësi e familjes Petrela




Pamje




Vila në studim ndodhet në rrugën e “Dibrës” me komunikim të drejtëpërdrejtë me rrugën. Është vilë banimi, ku hyrja bëhet nga mbrapa, kati i parë shfrytëzohet për dyqane dhe kati i dytë i rezervohet totalisht banimit. Rol të rëndësishëm për zhvillimin dhe përhapjen e kësaj tipologjie ka luajtur afërsia me rrugën, që përbënte faktor të rëndësishëm në zhvillimin e tregtisë. Ka sipërfaqe trualli prej 624,60 m² dhe sipërfaqe ndërtimi prej 309 m².



Planimetri e katit përdhe



Planimetri e katit parë



Pamje

Banesa tradicionale



Vila nr. 12




Skicë e vilës nr 12


Në foto është paraqitur një ndërtim me qerpiç, nga i cili mund të dallojmë linjat horizontale të drurit të vendosura në largësi 80 cm nga njëra-tjetra. Kemi të bëjmë me mënyrën tradicionale, ku dallohen kornizat e drunjta, çatija vendase, që është pak më e dalë përpara për mbrojtjen e materialeve të ndërtimit të banesës, të cilat nuk janë shumë rezistente. Objektet e mëpasme flasin për një zhvillim të mëtejshëm të arkitekturës së periudhës. Pra, pas viteve '20 futen ornamentet me linja të drejta të trajtuara në mënyrë më delikate. Linjat elegante të kornizave shoqërojnë dritaret. Një element i veçantë, që dallohet dhe tregon për futjen e teknikave të reja dhe rrit nivelin e ndërtimit është elementi i ullukut, që bën të mundur

mbledhjen e ujit të shirave. Ky tip banese tregon tendencën e arkitektëve për një afrim më të madh drejt perëndimit. Në këtë zonë gjejmë shumë vila, tek të cilat mund të dallojmë elemente të banesave tradicionale. Mund të përmendim çatinë ose kornizat e dritareve, të cila me ndryshime shumë të vogla ruajnë ende traditën. Hyrja për në banesë bëhet në të majtën e fasadës nëpërmjet një oborri. Në këtë rast nuk mund të lëmë pa përmendur çatinë tradicionale, kornizat e dritareve, të cilat në pjesën e sipërme kanë çelësin, detaje të vogla të zbukurimoreve, pa harruar edhe ekzistencën e ullukut, i cili edhe në këtë rast flet për një stad tjetër të zhvillimit teknik.

Studim Vila nr. 12, rruga “Zoi Xoxa”



Skicoi: A. Dinaku




Detaje të vilës

Banesa që paraqitet në foto nuk ka akses të drejt-përdrejtë me rrugën kryesore. Një detaj i veçantë, të cilin mund ta gjejmë edhe në vilat e tjera vendase është elementi që ndodhet në murin rrethues të oborrit dhe që simbolizon të drejtën e pronarit të shtëpisë për të shfrytëzuar të gjithë ambientin që e rrethon duke përfshirë edhe murin rrethues.

Studim Vila nr. 7, rruga “Dibrës”

ZONA 5



Fotografoi: A. Dragovi



Skicoi: A. Dragovi

Objekti që shohim në foto është një ndërtim tre katësh me fasade jo simetrike. Hyrja për në këto banesa bëhet drejtpërdrejtë nga rruga kryesore, në pjesën anësore të objektit. Një tjetër element i veçantë në këtë objekt është krijimi i një verandë në katin e sipërm. Në këtë banesë mund të dallojmë elemente, të cilat kanë qënë më të përdorshme në kulturën italiane. Në fasadë shohim një dritare rrethore, e cila i jep dritë hapësirës së shkallëve. Ndërtimi është me tull, që duket nga zhveshja e fasadës anësore.

Vila me arkitekt



Vila nr. 16, rruga "Musa Agolli"

Në këtë grup banesash dallojme vila, të cilat janë të projektuara nga arkitekte. Për nga mënyra e trajtimit të tyre, elementet e përdorura duken qartë së objektet i përkisnin shtresës së lartë. Kjo ndoshta bën të mundur krijimin e vilave, të cilat ndjekin më tepër tendencat e kohës dhe shprehin në një farë mënyre jo vetëm karakterin e arkitektit që e krijon, por edhe të vet pronarit të banesës. Fakti që, një pjesë e këtyre vilave u përkiste një shtrese më të lartë të popullsisë, mund të themi se, sërisht kemi një tregues për rëndësinë e rrugës, në të cilën ato janë vendosur.




Vila nr. 14, rruga "Zoi Xoxa"



Vila nr. 15, rruga "Musa Agolli"

Studim Vila nr. 5, rruga “Dibrës”



Kjo vilë është një nga vilat më të veçanta të kësaj zone për nga mënyra e trajtimit të saj. Kemi të bëjmë me vilën e violinistit të njohur Tedi Papavrami. Në foto mund të dallohen detajet dhe mënyra e veçantë e kompozimit të tyre. Nga elementë të veçantë, si grilat apo oxhaqet mund të kuptojmë një ndikim të arkitekturës italiane. Lidhja e tre dritareve me kornizë në fasadën anësore tregon kujdesin me të cilin janë trajtuar pjesët e veçanta të vilës.

Punoi: A. Dragovi

Studim Vila nr. 4, rruga “Dibrës”





Vila nr 4 është vilë e ndërtuar në vitin 1926. Ajo ndodhet në buzë të rrugës së “Dibrës”. Fillimisht ka qënë pronë e avokatit të njohur të kohës, Kristo Floqi. Më pas u shndërrua në kopësht fëmijësh, por sërisht mori funksionin si ndërtesë banimi. Megjithëse në ditët e sotme ajo është rikonstruktuar tërësisht duke funksionuar si bar-restorant. Pas rikonstruktimit ka ruajtur thuajse tërësisht formën e saj të mëparshme. Vila Goldi është një vilë me tre kate, ku kati i tretë është shtesë e kohëve të fundit. Në origjinalin e saj ka qënë me dy kate dhe bodrum. Bodrumi ekziston edhe sot, por me ndryshimin se është gërmuar më shumë. Pra, në bodrum dhe në katin e përdehe ndodhet bari dhe restoranti, ndërsa në katin e parë dhe të dytë ndodhet hoteli. Nëse pamja e jashtme e vilës nuk ka ndryshuar shumë, planimetria e saj ka pësuar disa ndryshime. Përpara vilës ka një kopësht relativisht të madh, ku pjesa më e madhe e oborrit shfrytëzohet për parkimin e makinave. Vila rrethohet nga kangjella me hekur të rrahur. Ka një hyrje në bodrum dhe dy hyrje të tjera në katin e përdehe, ndërsa ngjitja për në katet e mësipërme bëhet nga brenda ndërtesës. Në qoftë se do të shohim fasadën e saj vërejmë se është e stilit eklektik. Fasada është punuar me disa kanale të gdhendura horizontale.

Ndërtesa përbëhet nga dritare të mëdha, të cilat ndodhen në të gjitha anët. Dritaret rreth e qark kanë një kornizë, e cila ia thekson dhe më shumë formën drejtëkëndore. Korniza është e punuar hollë me disa elementë në trajtë kanalesh të gdhendur në të, njëjloj si në fasadë. Kjo përsëritet në të gjitha dritaret e vilës. Në të dyja hyrjet për në vilë janë shkallët dhe rreth



tyre kanë parmakë, të cilët nisin me një gdhendje të geometrizar të përbërë nga elementët e kubit dhe një sferë, që shtojnë më shumë monumentalitetin hyrjes.


Në katin përdhe ka dy pjesë të vilës më të dala në formë pesëkëndëshi, ku hapen me anë të dritareve. Rreth perimetrit të vilës ka një konizë të vazhduar, e cila thekson ndarjen e katit përdhe me katin e parë. Korniza përbëhet nga triglife dhe metope të stilizuara. Ajo që bie më shumë në sy tek fasada e kësaj vile është ballkoni i katit të dytë, që në pjesën balllore të vilës ka një si pasqyrë baroke të stilizuar, me stemë dhe vitin e ndërtimit të vilës, 1926. Rreth pasqyrës ka dy statuja të geometrizaruar të ngjashme me ato tek hyrja e katit përdhe dhe e katit të tretë që ngjason pak a shumë me katet e tjera. Në interiorin e vilës mbizotërojnë punimet e drurit, ndërsa në katin përdhe, ku ndodhet dhe restoranti vërehen punimet me mermer, pllaka qeramike, kolona korintike etj. Në pjesën e sipërme, ku ndodhet hoteli mobilimi është kryesisht me imitacione të mobiljeve të vjetra.



Smeraldo
Lomi



Detaje



Skicoi: A. Dragovi




Skicoi: A. Dragovi

Në dritare mendojmë se kemi të bëjmë me përdorimin e një moduli që është sa gjysma e saj. Është i vetmi rast i përdorur në zonë, një zgjidhje e mirë për marrjen e dritës dhe ajrimin e banesës. Nga detajet e tjera kemi arkitekturë neoklasike, me përdorimin e elementeve gjeometrike, kryesisht format rrethore e trekëndore të brendashkruar formave drejtkëndëshe. Më poshtë, kemi elementin e një ballkoni të dalë jashtë në formën e një konsoli, duke bërë hapjen e objektit ndaj rrugës. Dera e jashtme e punuar me

hekur të rrahur, me stile floreale, lejon transparencë të oborrit me rrugën. Tek banesa vihen re elemente të dekorit dhe ndërtimit të kohës. Kemi elementin e kornizës, që shfaqet në pjesën e kontureve të fasadës. Përdoret hekuri i rrahur, element që do vihet gjithnjë e me shumë në përdorim. Interes të madh paraqesin edhe elementët dekorativë në pjesën e sipërme të dritares. Zona jep mundësinë e konstatimit të “bashkëjetesës” së tre stileve të ndryshme.



Skicoi: A. Dragovi



Skicë dritareje / Skicoi: A. Dragovi

Përmbledhje



Fotografoi: A. Dragovi

Sado të vrullshme të jenë zhvillimet në arkitekturë, ato duhet të hasen me barrierën e përshtatjes me morfologjinë urbane dhe kriteret e ndërtimit...

Përsa i përket trajtimit të zonës, në fillim u fol me trajta të përgjithshme për panoramën historike të Tiranës dhe zonës në studim, analiza e hartografisë, një analizë e elementëve fizikë të rrugëve dhe tipologjive të ndërtimit të banesave duke përfunduar me detaje të elementëve arkitektonikë. Duke u nisur nga hartat e zonës, rievimi fotografik ose qoftë edhe duke e “jetuar” zonën vërehet një situatë mjaft kaotike.

Vërehet një “përleshje” stilesh, mes arkitekturës tradicionale, arkitekturës eklektike, asaj funksionaliste dhe e kohëve të sotme, që shfaqet si nuancë e funksionalistes. Si pasojë jemi përballë një pëlhure

urbane mjaft të “rënduar” që nuk të lë mundësi frymëmarjeje. Këtu jemi përballë një debati të rëndësishëm konceptual, pasi mund të thuhet fare mirë se mundësia e ndërtimit të objekteve të reja mund të interpretohet si shenjë progresi etj., por besoj se nuk bëhet fjalë për të njëjtin “sfond” pasi sado të vrullshme të jenë zhvillimet në arkitekturë duhet të hasen me barrierën e përshtatjes me morfologjinë urbane, me kriteret e ndërtimit etj. Por duhet thënë se, një nga vlerat e pëlhurës urbane, të paktën në fillimet e saj, ishte fakti i të qënurit mono-tipologjik, agregim i një tipi të vetëm që në brendësi të zonës, ruhet



akoma e tillë. Tipologjia e vilës familiare, duket sikur është akoma e “fortë” në brendësi. Shfaqen vështirësi në “leximin” e kësaj morfologjie të brendësisë të zonës pasi gjendemi në situata të vështira urbane, fatkeqësisht, falë “lirisë” së çdo qytetari për të qënë arkitekt-urbanist i banesës apo rrugës ku jeton.

Fasadat përballë rrugës, janë mjaft të ‘ngarkuara’. Në ndërtimet e reja të tipit të pallateve ose edhe të ish-banesave kolektive dallohet një ndarje skematike e tillë, ku në katin e parë kemi dyqanet dhe katet e tjera zakonisht janë të rezervuara për banim. Një tjetër çështje për diskutim është edhe pseudo-restaurimi i vilave si dhe shem-

bja e banesave të vjetra ose me vjetërsi relative për qëllime ndërtimi të hapësirave të reja dhe si pasojë humbjen e identitetit. Fenomen ky mjaft i rrezikshëm i përhapur në masë në kohët e sotme. Çështja e parë mund të krahasohet me rastin tipik të medaljes me dy anë. Restaurimi i një vile apo i një ndërtese është një proces mjaft pozitiv në vetvete. Me përjashtime të rralla, qytetari i kësaj zone tenton më shumë të “transformojë” ambientet. Kjo vërehet pasi humbet pamja e fasadës së jashtme ose është mjaft i vështirë leximi i saj, materialet origjinale të ndërtimit “zhduken” ose zëvendësohen shpeshherë me materiale jo të përshtatshme, impakti

kromatik krejt tjetër, me një ndikim negativ në “fasadën” e qytetit, pa përmendur edhe rastet, ku restaurimi është inekzistent, ku vërehen deformime të strukturës mbajtëse, (shpesh në trajtë të çarash) gjëndje jo funksionale të elementëve sekondare, shkëputje të shtresave të materialeve të fasadës, alteracion kromatik i përqëndruar ose homogjen, mund të manifestohet me morfologji të ndryshme në varësi të kushteve. Depozitimet sipërfaqësore në trajtë pluhuri etj, me shtresë variabël, njollat e pigmentizimit aksidental të një sipërfaqeje, si pasojë e prezencës së materialeve jo të përshtatshme dhe vegetacionit, etj.

ZONA 6

Universiteti POLIS

Përpunoi: Erida Hoxha

*Punuan: Desian Dyrmishi, Gledis Misja, Gjinovefa Xinxo, Romir Mazari, * Ada Lushi, Drimon Shamolli,
Gerti Struga (vila nr. 1)*




Harta të zonës ndër vite

ZONA 6



1937



1943



1953



1958



1990



Ditët e sotme

U formua si pikë takimi ndërmjet rrugëve kryesore si ajo e “Dibrës”, “Shën Gjergji” dhe e “Durrësit”. Banesat erdhën si evolim i banesave fshatare dhe kjo haset më së miri në zonën 6 pranë rrugës së „Dibrës“.

Vendndodhja e vilave





Studim Vila nr. 1



Vila nr. 60 ndodhet në anën tjetër të rrugës “4 Dëshmorët”, pronë e familjes Islamaj dhe vepër e inxhinierëve Arqile Prifti dhe Emin Toci. Ka ngjashmëri me shtëpitë tradicionale korçare. Është njëkatëshe me sipërfaqe 95 m2 dhe hyrja kryesore bëhet nga një ballkon me shkallë nga të dyja anët.

Ndërtesa kryesore përbëhet nga salloni dhe dy dhoma gjumi, ndërsa funksionet e tjera, si kuzhina, tualeti janë të përqëndruara në një ndërtesë tjetër njëkatëshe të vendosur në krah të majtë të ndërtesës kryesore. Vila është e gjelbëruar dhe ka një pus.



Planimetri e katit përdhe

Planimetri e katit parë

Vila nr. 11, rruga “Dervish Hakili”

ZONA 6



Vila nr. 15, rruga “Dervish Hakili”



Fotografi të vilave

ZONA 6



Vila nr. 2, rruga "Riza Jasa"



Vila nr. 3, rruga "Tafaj"





Vila nr. 7, rruga “Musa Maçi”



Vila nr. 17, rruga “Qemal Stafa”



Fotografi të vilave

ZONA 6



Vila nr. 4, rruga "4 Dëshmorët"



Vila nr. 5, rruga "Riza Jasa"



Vila nr. 6, rruga "Musa Maçi"



Vila nr. 7, rruga "Xhemail Tafaj"



Vila nr. 8, rruga "Tafaj"



Vila nr. 10, rruga "Ali Pashë Gucia"



Vila nr. 12, rruga "Dervish Hakili"



Vila nr. 13, rruga "Dervish Hakili"

Fotografi të vilave



Vila nr. 14, rruga "Dervish Hakili"



Vila nr. 16, rruga "Dervish Hakili"



Vila nr. 18, rruga "Qemal Stafa"



Vila nr. 19, rruga "Dervish Hakili"



Vila nr. 20, rruga "Dervish Hakili"



Vila nr. 21, rruga "Ali Pashë Gucia"



Vila nr. 22, rruga "Ali Pashë Gucia"



Vila nr. 23, rruga "Thënas Ziko"

Teknikat e ndërtimit



Me trarë të kryqëzuar



Me qerpiç me trarë linear



Me qerpiç me trarë linear

Teknikat e ndërtimit me qerpiç. Prodhimi i blloqeve të qerpiçit bëhej nga vetë banorët, meqë nuk kërkonte specializim të veçantë. Për cilësinë e baltës apo argjilës së përdorur për prerjen e qerpiçeve nuk kishte kërkesa të veçanta. Herë-herë përzierjes së baltës i shtoheshin fije kashte për një lidhje më të mirë. Blloqet thaheshin në diell. Muratura me qerpiç zakonisht ngrihej mbi një xokol të lartë, të ndërtuar me gurë, që të kapte një pjesë të mirë të katit përdhe. Përforcimi i muraturës me qerpiç bëhej me breza druri, që vendoseshin çdo 80-100 cm. Zakonisht vendoseshin dy breza në të dyja faqet e murit, të lidhura ndërmjet tyre me binarë tërthorë, por kishte raste kur vendoseshin edhe tre të tillë. Për brezat zgjidhej lëndë e qëndrueshme, pishë ose dushk dhe lidhjes së tyre i kushtoheshin rëndësi. Ato kapeshin me kllapa dhe mbërtheheshin me gozhde kovaçi. Brezat e drurit shërbenin për rrafshimin e muraturës dhe njëkohësisht luanin rolin e brezave antisizmik.

Detaje arkitektonike



Përgjatë periudhës 1930 – 1944 vihen re disa stile punimi si në zbukurimet e portikëve e deri në kornizat e dritareve. Kjo gamë e gjërë ornamentesh vjen si pasojë e stileve të ndryshme të ndërtimeve.

ZONA 7


Universiteti POLIS

Përpunoi: Erida Hoxha, Gerdi Papa

Punuan: Egla Harxhi, Erida Hoxha, Gerdi Papa, Iris Hyka, Qëndrim Gashi, Sonila Abdalli



Zona 7



Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoi: G. Struga

Karakteristikat e zonës

Në këtë zonë banesat i përkisnin kryesisht shtresave të pasura zejtare dhe tregtare. Ato u zhvilluan në disa variante të kompozimit planimetriko-vëllimor. Plan drejtkëndësh, trajtë L dhe U. Krahas arkitekturës popullore u zhvillua një arkitekturë e përpunuar nga mjeshtra arkitektë e inxhinierë të shkolluar. Ndërtimet ishin të pakta e me stil eklektik, si rrjedhojë e mungesave në traditën ndërtimore u morën për referencë format e ndërtimeve jashtë vendit. Eklektizimi ishte rryma, që u përfaqua nga borgjezia e zonës, por krahas arkitekturës së kohës

nuk shënonte progresivitet duke u shkëputur gjithmonë e më shumë nga "shtëpia prej qerpiçi". Të gjitha elementët e përdorur në plan, vëllim, detaje nuk kanë gjë të përbashkët me traditën duke penguar formimin e një fizionomie tonën përfaqësuese. Pas pushtimit italian, në zonë vihen re ndërtime të stilit neoklasicist, në të cilat kanë kontribuar arkitektë dhe inxhinierë të huaj. Në vitin '39 kjo zonë u përfshi në planin rregullues të arkitektit Bosio, i cili e konceptoi Tiranën e asaj kohë si një qytet kopësht, me ndërtime të ulta dhe në qendër një zonë intensive, duke u munduar të mos humbisnin influencat turke. Pël-



hura urbane karakterizohet nga një rrjet kuadratik gjurmët, e të cilit i kanë pothuajse të njëjtën formë edhe sot. Rreth viteve '40-'45 zbatim të gjërë merr edhe rryma funksionaliste, e cila solli një thjeshtëzim në tërësi, duke skematizuar dhe hequr dekorin. Këto vila i gjejmë kryesisht të vendosura përgjatë rrugës “Qemal Stafa”.


Proçesi kërkimor e nis rrugëtimin me vizitat e një-pasnjëshme në zonën 7 duke mundësuar identifikimin e vilave të viteve 1912-1944 në hartë. Fillimisht njihemi më nga afër me dy itenerarët kryesorë, rruga “Qemal Stafa” dhe “Hoxha Tahsim”, të cilët shërbejnë si dy kufinj gjatësorë shumë të rëndësishëm në përcaktimin dhe vendosjen e vilave. Në një nga hartat vërehet se, këto dy akse kryesore do të lidhen me njeri –tjetrin në sajë të rrugëve tërthore duke krijuar imazhin e një sistemi hipodamik (si gjurmë e parë që bie në sy për Tiranën historike). Duke mos u futur në jetën sociale, kthehemi sërish në vëzhgues të vlerave arkitekturore, që gjejmë në zonë. Pas përcaktimit të vilave dhe interv-

istave të shumta në zonë u hartuan një sërë hartash, një nga të cilat tregon, se cilat janë gjurmët arkitekturore historike që gjejmë sot.


Pa dyshim një studim historik nuk mund të mbetet pa kërkime të shumta në arkiva. Në sajë të hartave të vjetra historike të viteve '40- '43 kaluam në nivel analize për të parë se ç'pjesë të ndërtimeve të viteve '40 – '43 kemi humbur, ç'kemi sot nga kjo periudhë dhe ç'është ndërtuar në një periudhë 1-2 vjeçare. Nga një reflektim i tillë u pa se fatmirësisht kemi akoma një pjesë të mirë të tyre (pasi zona nr. 7 është një nga zonat më të ruajtura të Tiranës së vjetër). Kjo analizë lejon të kuptojmë se, në një periudhë të shkurtër kohore është projektuar nga italianët kryesisht ndërtime të tipologjive jo vila (Palazzina apo rajone policie). Ajo që na vë në lëvizje është fakti se gjatë rrugëtimin historik dhe politik të Tiranës kanë humbur disa vila të kësaj kohe, duke shfaqur haptazi fenomenin e Tiranës Metropol “zëvendësimin e vilave të vjetra me pallate shumëkatëshe- shumëngjyrëshe”.






Evidentimi i ndërtimeve ekzistuese



Sistemi rrugor



Vilat ndër vite


-  Xhamia Kokonozi
-  Vilat ekzistuese të 1940-1943
-  Vilat e humbura të 1940-1943



Kartolinë e vjetër e Tiranës




Foto panoramike e vitit 2011



Shtirirja e zonës

Studimi ynë për zonën e ndryshon këndvështrimin duke kaluar nga plani historik, identifikues, analizues i parë me syrin e një vëzhguesi tek plani i vëzhgimit ajror me syrin e zogut. Në sajë të fotove ajrore të marra në zonë vërejmë shtrirjen aksiale dhe drejtimin vizual drejt malit të “Dajtit”. Padyshim që, “Dajti”

është pika e referimit, “sinjali” në çdo pjesë të Tiranës, por në zonën nr. 7 ofrohet një shfaqje në shkallë më të madhe të majave të tij. Kjo ndodh për shkak se ndërhyrjet në këtë zonë janë më të pakta në krahasim me pjesën tjetër të re të Tiranës.






Vilat ndër vite



Ndërtimet e reja

Kjo nuk përjashton faktin e ekzistencës së këtij fenomeni që kërkon të “gllabërojë” Tiranën e vjetër me kopshtet dhe oborret karakteristike. Në foto shihet ngjyrosja e pallateve me të zeza duke pasqyruar efektin negativ, që sjellin jo vetëm në humbjen e traditës dhe vlerave historike, por dhe çrregullimet e ndërtimeve në shkallë, prishjen e teksturës së pëlhurës urbane si dhe ndryshime në nivelin e imtësisë. Të gjitha këto pasoja rrjedhin nga zëvendësimi i vilave të vjetra tiranase popullore apo të projektuara qoftë nga arkitektë shqiptarë apo të huaj (italianë) me ndërtimin masiv të pallateve deri në 15 kate me ngjyra, forma të ndryshme. Si rrjedhim, kemi rrezikun humbjen e identitetit të një nga zonave më të pasura me histori dhe tradita të Tiranës.

Kjo analizë logjike na vë në lëvizje për të parë më saktë se në çfarë shkalle janë ndërhyrjet. Në hartën djathtas shohim se zona e parë, ajo që ndodhet më afër pazarit, është pjesa me ndërhyrje më të mëdha me pallate, një fenomen që vazhdon dhe sot. Kjo për faktin se afërsia e madhe me qendrën e bën token më të kushtueshme. Në një nivel tjetër janë zonat përgjatë rrugëve, ku ndërtimet e pallateve janë në një shkallë më të vogël. Zona që kufizohet me Unazën e Vogël të Tiranës është pjesa më e ruajtur pasi kemi identifikuar ekzistencën e një rrugice të tërë, e cila është vetëm me vila të vjetra të projektuara nga arkitektë italianë. Si konkluzion, duke nisur nga Pazarit i Ri drejt Unazës niveli i ndërtimit të pallateve të reja është në rënie.



Tirana është një nga ato qytete, të cilat fillimisht kanë ardhur në jetë pa ndihmën e projektuesve duke iu përshtatur kushteve sociale, ekonomike, gjeografike. Në analizën e bërë është konstatuar se gjatë historisë së formimit të zonës, në tentativa për të krijuar hapësirë, gjenden gjurmët e një kombinimi të pjesëzave të një zhvillimi spontan dhe të organizuar, pjesëza të qytetit ideal. Fillimisht kanë qënë dy akset e rëndësishme rrugore, “Hoxha Tahsim” dhe “Qemal Stafa”, të cilat shtrihen në mënyrë paralele kundrejt njëra-tjetrës që i kanë dhënë zonës një zhvillim linear. Këto akse janë krijuar si nevojë e zhvillimit të mëtejshëm të hapësirës urbane në kuadrin e një qyteti tregtar, duke ndjekur linjat e Pazarit të Vjetër dhe xhamive. Rrjedhimisht këto rrugë kishin nevojë të lidheshin me njëra-tjetrën, në këtë pikë dallojmë se kemi dy lloje rrugicash: rrugica pa krye dhe ato që lidhin në mënyrë tërthore dy akset. Banesat e para, kryesisht janë vendosur në mënyrë sporadike dhe intuitive duke u vendosur në brendësi të zonës. Ato shtrihen përgjatë rrugicave, të cilat në përgjithësi përfundonin më pamje të mbyllur. Në këto pika fundore, pamja mbyllet me muret e shtëpive tradicionale prej qerpiçi, të cilat vendosen në grupe në mënyrë të

tillë, që dyert të jenë përballë njëra-tjetrës. Këto banesa formonin grupime të vogla, të cilat e ndanin zonën në komunitete të vogla të ndara nga njëra-tjetra, pa rrugë lidhëse, të izoluara, por në princip të bashkuara përbrenda tyre. Me hartimin e planit rregullues të vitit ‘39 të arkitektit italian Bosio, kjo zonë mori një trajtë tjetër, rrugicat filluan të ktheheshin në rrugë të mirëfillta me emërtime, të cilat mundësonin një akses të tërthortë nga njëra rrugë të tjetra. Plani i Bosios parashikonte krijimin e një qyteti kopësht, e ndër-tuar sipas një sistemi hipodamik, me parcela të rregullta, duke ruajtur elementët arkitektonikë tradicionalë. Kjo strukturë rrugore trashëgohet edhe më pas e në vijim, gjatë konceptimit të planeve rregulluese të mëvonëshme duke u ndërthurrur, e në disa vende duke e zëvendësuar indin e vjetër, të çrregullt urban me ndërtime tipike plurifamiliares. Është koha kur borgjezia kërkon të afirmohet dhe të ekspozohet dhe banesat kthejnë tashmë fasadën nga rruga kryesore. Sot gjurmët janë të dukshme me gjithë ndërhyrjet që janë bërë. Struktura ka arritur të qëndrojë në këmbë në këtë zonë, për arsyen se ruhet nga institucionet shtetërore, të cilat e kanë shpallur si zonë me vlera historike.



Ajo ç'ka vërtet është mbresëlënëse në këtë zonë është dinamika sociale, që mbart në vetvete një kompleks traditash, kulturash e vlerash të pasura, të cilat duke qënë të ndryshme reflektojnë një diversitet skenash sociale. Ajo çfarë ka ngelur nga zhvillimi spontan i qytetit me banesat tradicionale tiranase, për nga vendosja, dëshmon për një traditë të vjetër të shqiptarit, mikpritja. Gjurmët e kësaj kulture mishërohen

dukshëm nëpër rrugicat pa krye e përgjatë tyre. Gjatë eksplorimit “in situ” kemi vëzhguar se dyert e oborreve dhe të shtëpive të rrinin hapur. Me kalimin e disa prej rrugicave filluam ta shihnim këtë si një fenomen të përhapur kudo nëpër zonë. Pyetëm me kureshtje pse ndodhte kjo dhe të gjithë, sikur kishin rënë dakort për përgjigjen thonin se kështu kishte qënë gjithmonë. Këtu kuptuam se kishim të bënim



me një komunitet autokton, të cilët jetonin të lidhur me njëri-tjetrin e se për ta fqinjësia nuk është thjesht dikush që ka shtëpinë afër teje. Ato tregonin se dhe në kohë trazirash (vitet '97-'98) dyert e tyre rrinin hapur tërë kohës ku ata hynin e dilnin me njëri tjetrin. Madje bisedat me disa prej banorëve janë zhvilluar brenda ambienteve të shtëpisë. Në kohët e sotme moderne, ku njeriu sa vjen dhe bëhet më egocentrist, një fenomen i tillë tingëllon tepër abstrakt dhe gati është e paimagjinueshme një lidhje kaq e fortë midis fqinjëve.

Në krahun tjetër ndodh krejt e kundërta në banesat e ndërtuara mbas '39, banuesit nuk janë më au-

toktone, dhe sjellja e tyre është e kundërt, ata nguronin të na jepnin çfarëdo lloj informacioni dhe tregoheshin tepër të rezervuar deri tek kërkesa jonë për të bërë disa foto.

Në raport me banesat vihet re një lloj kontrasti në mirëmbajtje. Pavarësisht kushteve të këqija ekonomike konstatohet se shtëpitë e banuara nga pronarë të vjetër u kushtohet një rëndësi e madhe në mirëmbajtje, qoftë duke lyer një derë apo duke rregulluar oborrin në mënyra krejt origjinale. Në anën tjetër vihet re se një pjesë e mirë e atyre që shtëpitë i kanë marrë në pronësi para 20 vjetësh nuk kanë pasur mundësi t'i mirëmbajnë, edhe për faktin se materialet

dhe dekori i përdorur në këto raste si kapitete, friza dhe shumë elementë neoklasike janë shumë të mundimshme dhe të kushtueshme për t'u mirëmbajtur. Në rastin e shtëpive me qerpiç për ato që kanë mundur t'i rezistojnë kthimeve në pallate, shihet se pavarësisht përdorimit të një materiali popullor jo shumë rezistent, ka tentativa për të ruajtur.

Është e qartë që kemi të bëjmë me një zonë me flukse energjish të mëdha, e cila mbart vlera, identitet, potenciale kulturore e sociale të larmishme. Ndjesitë dhe perceptimet kur ndodhesh në brendësi të zonës janë të ndryshme nga qendra e qytetit, pavarësisht se ndodhet shumë afër saj.

Tipet e ndërtimeve

Vihen re tri lloje kryesore vilash: shtëpitë karakteristike tiranese me qerpiç, neoklasike, eklektike, modernizmit dhe funksionalizmit. Pas periudhës së pushtimit osman, në fillimet e viteve '20, me zhvillimin e klasës borgjeze vëmendje i kushtohet më shumë banesave. Duke analizuar ndërtesat e reja të banimit si tipologji më e përhapur, verëjme se ato sipas madhësisë, përkujdesjes në trajtimin e jashtëm dhe llojeve të materialeve të ndërtimit të përdorur shprehin fuqinë ekonomike të pronarëve dhe pozitën e tyre klasore. Ato u projektuan të tipit të mbyllur me një ose dy kate dhe me një numër të kufizuar mjedisesh. Përdorimi i teknikave dhe materialeve moderne u reflektua edhe në formulimin e brendshëm e të jashtëm të tyre.


U përmirësuan dukshëm skemat funksionale të lidhjes reciproke të mjedisëve me qendër kompozimi, hollin e përbashkët në çdo kat, lidhja e mjedisëve u bë e pavarur, dhomat u ndriçuan më mirë, pati shfrytëzim më racional të sipërfaqeve të veçantë arkitekturorë, u përmirësua dhe forma e jashtme. Në përpunimin e këtyre banesave u ruajtën dhe disa nga tiparet thelbësore të arkitekturës popullore si përputhja e trajtimit të pamjeve me funksionin e mjedisëve, thjeshtësia, përdorimi i materialeve rrethanore etj. Përgjatë viteve '25 dhe '32 u ndërtuan banesa të trajtuara me gjuhë arkitekturore të mbushur me

forma dhe elemente të ndryshëm, që duke u materializuar në shkallë të ndryshme, me përzjerje baroku neoklasiku e modernizimi formonin një masë eklektike. Mbas 1932 fillon e rrallohet trajtimi me shumë elementë dekorativë në banesa. Hapësirat e dritareve qëndrojnë në rrafshin e pastër të fasadave dhe mënjahet plastika e tepruar, kjo çoi në zgjidhje arkitekturore më të arritura. Për sa i përket fasadës së jashtme, asaj iu kushtua një rëndësi e veçantë. Sipas mendimit të kohës, një fasadë e zbukuruar shumë ishte tregues i pushtetit dhe pasurisë. Për këtë arsye, fasada kryesore orientohej nga rruga dhe përdorshin mjaft ornamente kryesisht me motive floreale. Vihen re zbukurimet në pilastra, kolona, kornizat e dritareve dhe çelësi i tyre, kangjellat, balustrat, parmakët e ballkoneve dhe të shkallëve, portat e jashtme etj. Në një periudhë të mëvonshme dallohet një pakësim i këtyre ornamentëve duke iu afruar një stili neoklasik, disi eklektik, derisa këto thjeshtësohen akoma edhe më shumë. Ornamentet e ngarkuara në elementë dekorativ zhduken. Motivet floreale i lënë vend linjave të drejta dhe të pastra, që kornizojnë elementë të ndryshëm si: dritaret, dyert. Në këtë periudhë i kushtohet vëmendje më shumë funksionit se formës. Kemi prirje funksionaliste dhe moderniste. Më pas, gjatë periudhës së pushtimit italian, shfaqet edhe një prirje drejt arkitekturës fashiste racionaliste. Këto vihen re në ndërtesat multifamiljare në formën e palazinave.

Studim Vila nr. 13, rruga “Hajdar Kërçiku”

Kompozimi pozicional i vilave me portën hyrëse, kopshtin çlodhës, ku nga njëra anë tërheq vëmendjen pusi i ruajtur dhe më tej ekzistenca e një vile e vitit 1924, të krijuar ndjesinë e kthimit në një periudhe tjetër historike të Tiranës. Të gjitha këto vlera historike të verbojnë kundrejt një fenomeni ndarës kufizues nëpërmjet një muri tulle. Le të shpjegojmë vizitën tonë. Trokasim në njërën nga portat, atë të rënë, që të linte të kuptoje se vila nuk është braktisur. Përballë nesh shfaqet një zonjë, e cila na mirëprituri me dashuri. Ishte një kënaqësi të dëgjojë si fliste me pasion dhe fanatizëm si kishte lyer me penel muret e shtëpisë së saj, për të mos humbur asnjë vlerë

dekoruese të fasadës gjatë rrugëtimit në kohë. Ajo rrefente kujdesin që i kushtonte çdo ditë kopshtit prapa shtëpisë dhe shpesh herë “grindjet” me ustallarët, që kërkonin të mbaronin punët shpejt, për efekt kohe dhe që sygjeronin “suvanë” e tavanit në vend të trarëve të drurit. Të gjitha këto përkujdesje, menjëherë, vihen re në strehën e drunjtë me elementë formalë aq të veçantë. Pllakat ekzistuese të vendosura në parahyrje ende qëndrojnë me elementin dekorues shumëngjyrësh të asaj kohe. Për zonjën e shtëpisë nuk përbënte interes marrja e hyrjeve në një pallat. Ajo dëshironte të kalonte pleqërinë e qetë në vilën e trashëguar.




Studim Vila nr. 2




Fotografoi: G. Struga

Vila në sheshin “Avni Rustemi” nuk të jep idenë e një vilë të vjetër pasi është rikonstruktuar duke i dhënë asaj pamjen e vilave të sotme. Kjo vilë është studiuar dhe projektuar ng ark. ing. Hajdar Kërciku në shtator të 1942. Duke studiuar dokumentat origjinale të mundësuara nga pronari ekzistues i saj duket qartë, që vila nuk është zbatuar si në projekt. Në projekt kjo banesë është menduar si një objekt katërkatësh me bodrum. Në fakt ajo është një vilë


dykatëshe. Gjithashtu me anë të skicës kuptohet, që projekti nuk përfshinte vetëm këtë pjesë, por vazhonte si një kompleks i tërë përgjatë rrugës, ku sot ndodhet vila e “kuqe”. Karakteristikë e këtij projekti është se arkitekti e ka përshtatur dhe studiuar me formën e sheshit. Duke studiuar planimetritë duket qartë që ato janë zbatuar si në projekt, pavarësisht se nuk janë realizuar të gjitha katet e banesës.



Planimetri e katit përdhe



Planimetri e katit parë



Pamje



Prespektivë

Hyrja qendrore ndodhet në pjesën qendrore të fasadës kryesore. Ambientet që ndodhen buzë rrugës, siç e thamë dhe më lart, shërbejnë si dyqane, ndërsa ato në pjesën mbrapa shërbejnë si magazina, siç tregohen në planimetri. Nëpërmjet shkallëve që ndodhen në pjesën fundore të hyrjes mundësohet hyrja në bodrum dhe në katin e parë.

Kati i dytë është i ndarë në dy apartamente jo simetrike me njëra-tjetrën. Karakteristikë e të dyja apartamenteve është se ato kanë korridorin në pjesën e hyrjes nga ku bëhet edhe shpërndarja e ambienteve të tjera. Sipërfaqja e apartamenteve nuk është e njëjtë.

Apartamenti i parë përbëhet nga dy dhoma gjumi, të cilat në planimetri i gjejmë me emrin ode fjetje, një sallon, ambient gatimi, banjo, depo dhe një kuzhinë. Apartamenti tjetër ndryshe nga apartamenti i parë ka vetëm një dhomë gjumi.


Duke e parë nga jashtë kjo vilë ka një fasadë të thjeshtë, ku bie në sy korniza, e cila vazhdon në të gjithë pjesën e dritareve. Gjithashtu, një karakteristikë e kësaj vile është se ajo ka një çati të sheshtë, pra me tarracë dhe jo si në planin projektues të saj, ku është e mbuluar me çati katër ujëse.

Vila nr. 6, rruga “Hoxha Tahsim”

ZONA 7



Fotografoi: G. Struga



Planimetri

Vila nr. 9, rruga “Qemal Stafa”





Fotografi të vilave



Vila nr. 5. rruga "Hoxha Tahsim"



Vila nr. 7. rruga "Hoxha Tahsim"





Vila nr. 11. rruga “Deko Rusi”



Vila nr. 14. rruga “Hajdar Kërçiku”



Fotografi të vilave



Vila nr. 1, rruga "Shënasi Dishnica"



Vila nr. 3, rruga "Qemal Stafa"




Vila nr. 4, rruga "Jani Vreto"



Vila nr. 8, rruga "Qemal Stafa"



Vila nr. 10, rruga "Qemal Stafa"




Vila nr. 12, rruga "Faik Tërnova"

ZONA 8

Universiteti POLIS

Përpunoi: Ada Lushi, Dea Buza, Drilon Shamolli, Gerti Struga
Punuan: Anilda Pulevi, Dea Buza, Egzon Pllana, Klajdi Dinellari



Zona 8



Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoi: G. Struga

Bërthamat e Para Urbane të Qytetit të Tiranës

Kjo është pikënisja dhe faktorët, të cilët i dhanë formën Tiranës dhe pozicionimin social, ekonomik, politik më të rëndësishëm të vendit. Nuklet e para, të cilat mundësuan përhapjen e 'indeve' kanë qënë pjesë, ato lidhen ngushtë me faktorë shoqëror dhe fetare të kohës përkatëse. Bërthama e parë historike e qyteti hedh shtat së bashku me ndërtimin e xhamisë së vjetër të Sulejman Pashës në qendër të strukturës së

sotme të Tiranës. Ndërtimi i xhamisë vijoi me ngritjen e banesave të tjera gjatë anës së djathtë të përroit të Lanës duke bërë të mundur zgjerimin dhe zhvillimin e qytetit. Dalëngadalë Tirana po "pajisej" me çdo shërbim dhe aktivitet që i duhet një qyteti. Ndërtimi i hanit të parë, tre furrave, banjosh publike, zgjerimi i pazarit, oborret, sheshet, varrezat, vërtetimin një jetë shoqërore në zhvillim.



Vendndodhja e vilave

Bërthama e dytë urbanistike i ka fillimet e veta në shekullin 18, e zhvendosur rreth 600 m në veriperëndim të bërthamës së parë, përsëri e lidhur me ndërtimin e xhamisë së Firës, ku sot kryqëzohen rruga e “Barikadave” me rrugën “Fortuzi”.

Bërthama e tretë do të lindë afërsisht pas 100 vjetësh, në vitin 1775, me ndërtimin e xhamisë së Zajminit, e cila më pas do të shembet për arsye të ndryshme urbanistike lidhur me takimin e rrugës së “Dibrës” dhe “Thanas Ziko”.

Bërthama e katërt e ka pikënisjen e saj nga i njëjti faktor, që formoi dhe tre bërthamat e sipërpërmendura. xhamia-shkak në këtë rast është ajo e Haxhi Ethemit e rrethuar me banesa dhe varreza meqënëse territori në këtë zonë është i favorshëm për këtë kategori ndërtimi.

Bërthama e katërt e ka pikënisjen e saj nga i njëjti faktor, që formoi dhe tre bërthamat e sipërpërmendura, xhamia shkak në këtë rast është ajo e Haxhi Ethemit e rrethuar me banesa dhe varreza, meqë territori i zonën favorizon këtë kategori ndërtimi.

Studimi i zonës




Kufizimi i zonës në studim



Indi urban



Tipologjia urbane



Organizimi i zonës sipas sistemit “ishullor”



Vazhdimësia e koridoreve hapsinore

Formimi bazë i qytetit qëndron në mënyrë të pavetëdijshëm ose jo në vendosjen në hapësirë të akseve.



Shkaqet se si vendosen në hapësirën tokësore janë të ndryshme, e pikërisht pozicioni i tyre do të kthejë këtë hapësirë pa emër në hapësirë urbane. Më tej këto akse vazhdojnë të rriten sipas drejtimeve të kërkesave të kohës, ngjarjeve social-politike dhe raporteve, marrëdhënieve me pjesët e tjera të qytetit. Në disa raste këta faktorë urbanë rezistojnë deri në ditët e sotme duke krijuar një “izolim” mbrojtës të gjurmëve dhe identitetit.

Brenda këtyre pëlhurave ka një bashkëveprim të vazhdueshëm mes elementëve të fortë urbane dhe veprimeve spontane e pa bazë të popullsisë.

Sipas studimeve të bazura në revistën “Forum A+P 5” në artikullin e Sotir Dhamos, ‘Qyteti dhe dialektika e “vetë” krijimit’ - shohim se merren parasysh studime të bëra në lidhje me pëlhurat urbane. ‘Forma’ është si rezultat i bashkëveprimit të ‘elementëve

të fortë’ të kontekstit urban me ‘forcat’ e lëvizjeve spontane të popullsisë. Dhe ky ndërveprim midis forcave spontane ndikon në formimin e një vendbanimi dhe tendencave planifikuese, ku trajton këndvështrimin e qyteteve organike.

Në fillim ajo ç’ka ekzistonte ishte thjesht një hapësirë e gjelbëruar e papërpunuar nga njeriu. Me ardhjen e individëve, të cilët vendosën të ndërtonin banesat e tyre kjo hapësirë mori dalëngadalë formën e një bashkësie të përbërë nga shumë unaza të veçuara nga njëra-tjetra. Ndërtimi i banesave të vogla nuk u bë në bazë të rregullave të caktuara, ai ishte spontan, sipas nevojave dhe ndërtimit amatoresk të vetë pronarëve. Kjo mënyrë “ishullore” bëri që të krijohej një sistem i veçantë rrugor. Shtëpitë e ndërtuara spontanisht kanë krijuar një sistem rrugor venoz, gati gati si labirinth, i cili në shumë drejtime nuk ka dalje.



Me kalimin e kohës është rritur dendësia e popullsisë në këtë zonë, si rrjedhojë edhe numri i banesave, ato i përkasin stileve të ndryshme, megjithatë i përmbahen të njëjtit tip. Ky zhvillim është i lidhur ngushtë me formimin e korridoreve hapësinore dhe duke i bërë një analizë zanafillës së tyre si dhe ecurinë mendohet se ka ndodhur një “bymim” i korridoreve hapësinore, një tendencë që kërkon krijimin e itinerareve të reja.

Kushtet e vështira financiare të banorëve për restaurimin e këtyre objekteve ka ndikuar që banorët të joshen nga ofertat e firmave të ndërtimit, të cilat i kompensojnë ato me apartamente të reja. E vetmja gjë që duhet të bëjnë banorët është t’u lënë tokën të lirë për të realizuar projekte të reja. Shembja e këtyre banesave nuk ka ndodhur për të vetmen arsye se, dokumentat e pronësisë janë shpesh të parregullta e të paqarta. Ndonëse për shumë banorë kjo gjë është diçka negative dhe penguese për progres, por nëse e marrim nga këndvështrimi i vlerave historike kjo pengesë rezulton positive. Zgjidhja e problemeve me pronësinë është rrezik për këtë zonë që transformohet nga ndërtimi i ulët, në ndëtime të larta. ‘Bymimi’ i korridoreve hapësinore si dhe kompensimi i vilave me pallate janë duke e shndërruar zonën nga sistemi ishullor, në sistem hipodamik të zonës.

Studim Vila nr. 1



Fotografói: A. Lushi

Gjendet në rrugën “Dibrës”, është ndërtuar në vitin 1933 me pronar Rrafman Tarexhepi, i cili e kaloi pronësinë për fëmijët. Sot pronarët janë pjesëtarët e Shoqatës së Çamëve. Kjo vilë i ruan ende elementët origjinalë të ndërtimit.

Studim Vila nr. 2



Fotografoi: G. Struga

Ndodhet në rrugën “Dibrës”, u ndërtua në vitin 1940 me pronar Myftuza Mazreku. Vila është trashëguar brez pas brezi nga pasardhësit pronarit fillestar dhe sot është në pronësi të Hysni Mazrekut dhe Ramzi Mazrekut. Vetëm një pjesë e vilës është restauruar.

Studim Vila nr. 5



Kjo vilë është ndërtuar në vitin 1944. Ajo është e ndarë në dy pjesë. Pronari i saj ka qenë italian, emrin e të cilit nuk arritëm ta mësonim. Në vitet e para të demokracisë ajo u ble. Kjo vilë është pjesë e një pazelli monumental të pazëvendësueshëm.

Fotografi të vilave



Vila nr. 6, rruga "Riza Cerova" /Fotografoi: G.Struga



Vila nr. 7, rruga "Riza Cerova" /Fotografoi: G.Struga



Vila nr. 8, rruga "Riza Cerova" /Fotografoi: A.Lushi



Vila nr. 9, rruga "Riza Cerova" /Fotografoi: A.Lushi



Vila nr. 10, rruga "Riza Cerova" /Fotorafoi: A.Lushi



Vila nr. 11, rruga "Muharrem Gurra" /Fotorafoi: A.Lushi



Vila nr. 12, rruga "Muharrem Gurra" /Fotorafoi: A.Lushi



Vila nr. 13, rruga "Muharrem Gurra" /Fotorafoi: A.Lushi

Fotografi të vilave



Vila nr. 14, rruga "Muharrem Gurra" /Fotografoi: A. Lushi



Vila nr. 15, rruga "Hafiz Ibrahim Dalliu" /Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 16, rruga "Hafiz Ibrahim Dalliu" /Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 17, rruga "Katër Dëshmorët" /Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 18, rruga “Katër Dëshmorët” /Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 19, rruga “Thanas Ziko” /Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 20, rruga “Hafiz Ibrahim Dalliu” /Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 21, rruga “Hafiz Ibrahim Dalliu” /Fotografoi: D. Shamolli

Përmbledhje



Vërtet është e vështirë. Askush nuk do të dëshironte të jetonte në “rrënoja të lyera”, por vallë a është zgjedhja më e mirë “pallati”? Sigurisht kushtet e jetesës së banorëve do të përmirësohen, do të zhvillohet popullsia në atë zonë, do të këtë më shumë shërbime, po historia?

Ky muze i zhytur në Tiranën moderne ka mundur të qëndrojë me tiparet e origjinës së vet pa bashkëvepruar me pjesën tjetër. Është nga zonat e pakta ekzistuese të Tiranës së vjetër, pasqyrë e së kaluarës sonë, e pse jo, krenari për vlerat e saj. Dëshmitare e evolimit të banesës shqiptare, e një tipologjie, men-

taliteti, mënyre të projektuar si dhe fillimet e një rrugëtimiti, i cili mundëson sot ngritjen e ndërtesave të larta, që gërvishin qiellin e Tiranës. Si mund të jetë copëtimi i pasqyrës historike dhe zbulimi i saj me komplekse pallatesh moderne zgjidhja më e mirë? Në cilën pjesë të Tiranës do të “zhvendoset” historia... A do të mbijetojnë gjurmët e së shkuarës, të një identiteti, në një imazh të shformuar...



Trashegimi Kulturorë. Shumë nga objektet me vlera të Tiranës nuk janë më egzistuese. Kjo zonë është ndër të paktat e mbetura, e cila tregon mënyrën e organizimit të sistemeve rrugore (spontane), që përkojnë me fillimin e zhvillimit të qytetit. Gjithash-tu, është një tregues i tipologjisë së banesës së vjetër të Tiranës.

Ndryshimet. Gjatë evolimit të qytetit disa nga objektet kanë humbur funksionin e dikurshëm, janë transformuar (shtimi i elementeve jo të ndërlidhur) ose kanë ngelur si hapësira boshe të braktisura, duke humbur vitalitetin e dikurshëm.

Jetëgjatësia. Për shkak të faktorëve të ndryshëm ekonomik, politik dhe social që kanë ndodhur gjatë viteve, këtyre ndërtesave nuk u është kushtuar rëndësia dhe kujdesi i duhur.

Por, banorët nuk i kanë lënë shtëpitë e tyre të shemben nga kalimi i kohës. Kur ecën sheh muret të lyera, mbajtëse të sajuara çatish, diku një e moshuar fshin para portës dhe, ndjesia se këto objekte-banesa do të zhduken pas ca ditësh, vitesh dhe se identiteti i tyre do të humbasë, zëvendësohet me një mendim pozitiv, me shpresën se do të përmirësohet.

ZONA 9

Universiteti POLIS

Përpunoi: Emel Peterci

Punuan: Blerti Bajo, Erjon Duro, Genc Tufi, Nadina Sula, Ona Zenelaj



Zona 9



Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Puno: G. Struga

Karakteristikat e Zonës

Zona 9 kufizohet në veri nga rrua "4 Dëshmorët" në jug nga "Qemal Stafa", në lindje nga "Thanas Ziko" dhe në perëndim nga rrua "Bardhyl". Në brendësi të saj gjenden jo pak banesa të vjetra të cilat, megjithëse nuk ndikuan në ndryshimin e fizionomisë së qytetit,

patën fuqi shndërruese të dukshme. Janë objekte, të cilat mbartin përpjekjen për t'iu përshtatur zhvillimeve dhe kërkesave të kohës. Të gjitha këto banesa, duket sikur nuk kanë asnjë pikë takimi me njëra-tjetrën, por e vërteta është ndryshe.

Vëndndodhja e vilave



Studim: Vila nr 2





Stili i banesës së zgjedhur është ai i arkitekturës italiane të viteve '40. Kjo arkitekturë karakterizohet nga racionalizmi dhe mungesa e dekorit, në mbështetje të ideve të Italisë fashiste së atyre viteve duke kërkuar krijimin e një perandorie të re romake. Ata dëshironin të rikthenin shkëlqimin dhe ekspansionin, që kishin arritur paraardhësit e tyre në gjithë Europën. Arkitektura shihej si mjete për të treguar fuqinë e pushtetit. Përveç arkitekturës dhe urbanistikës racionale, respektohet psikologjia dhe tradita e shqiptarit të lidhur me pronën private.

Kjo nuk është vilë e thjeshtë unifamiljare, por një banesë kolektive. Banesat kolektive në ato vite ishin shumë të përhapura në Itali dhe merrnin emrin Palazzetto. Ato projekttoheshin për një shtresë të ngritur të popullsisë, kryesisht në vendin tonë për gradat e lartë të ushtrisë italiane ose për popullsinë vendase me një farë pozite shoqërore. Idetë e arkitekturës italiane të atyre viteve u reflektuan edhe në planet urbanistike të qyteteve, si p.sh. të qytetit të Tiranës.

Banesat vendoseshin në qendër të oborreve, rrethuar nga gjelbërimi. Ato përfaqësojnë një tip të veçantë në ndërtim, duke unifikuar arkitekturën italiane të atyre viteve kudo që ndërtohej.

Vila Kazazi ndodhet në rrugën “Thanas Ziko”, pranë «Shkollës së Kuqe». Kjo ishte një zonë, me një numër të madh vilash, por që sot janë transformuar në pallate shumëkatëshe. Këto parcela varionin nga 1000 deri në 1500 m² duke formuar kopshte të bollshme, që më vonë nga arkitekti Bossio italian do të quhej “citta giardino”.

Vila Kazazi u ndërtua në vitet '40 me porosi të Abdullah Kazazit për të gjithë anëtarët e familjes së tij. Firma, e cila bëri projektin ishte “Edilizia Lucca & Co, Costruzioni civili, Milano”. Sot, mes shumë problemesh të pronësisë, ajo banohet nga pasardhësit e Abdullah Kazazit.

Në fillim ishte projektuar për tri vila të ndara, por nuk u pëlqye si projekt dhe u bashkuan fasadat e tyre. Ndërtesa është trekatëshe, kompleksi ka 14 apartamente, të gjitha për trashëgimtarët e familjes. Planimetria është pak a shumë simetrike dhe në dy anët ka nga 4 duplekse, që në katin e tretë shndërrohen në një apartament të madh sa madhësia e të 4 duplekseve. Pjesa qendrore përbëhet nga apartamente njëkatëshe dhe nga dy kafazë shkalle. Në pjesën e sipërme, në katin e tretë, ndodhet një verandë me kolona, ku ka akses nga të dy kafazet e shkallëve.

Detaje



Fasada kryesore: Fasada e jashtme është e stilit racionalist. Vihet re mungesa e dekoracionit, por ruan simetri në elementët e dritares dhe portës. Dritaret janë të larta, sidomos ato tek kafazi i shkallëve dhe kjo, në një fasadë të gjërë, jep idenë e ngritjes në lartësi. Ato janë prej materiali druri masiv. Janë me grila ngjyrë jeshile dhe zgara hekuri.


E gjithë ndërtesa është prej tulle, por e suvatuat nga jashtë. Elementë të veçantë janë fashat prej tulle në dukje, element që gjendet në shumë ndërtesa italiane të kohës, si p.sh. në pallatet e quajtura të Aviacionit dhe në vila të tjera të asaj periudhe.

Ndërtesa është e ngritur nga toka dhe hyrja nëpër apartamente kryhet me anën e shkallëve me parmakë të stilit racional prej betoni. Xokoli është i veshur me pllaka mermeri.

Fasada anësore. Në pjesën anësore kemi ballkone me parapet me hekur të rrahur, kurse në katin e parë ballkoni zëvendësohet me një shkallare, që të çon në një dere, e cila sot është e murosur, por duken ende shenjat e një grile. Kjo derë rrethohet me një element dekorativ prej tulle në formën e dhëmbëzave. Mendohet se shkallët janë shtuar më vonë, kurse në kohën e projektimit ajo ishte thjesht një vetratë xhami pa shkallare.



Tipologjia e banesave duplex




Në katin e parë hyn në një korridor, i cili bën shpërndarjen e dhomës së ndenjes, kuzhinës dhe një depoje. Ato janë të shtruar me pllaka me granit të cukitur dhe tek dera kanë një brez të zi. Pasi ngjitesh

nëpër shkallë, në katin e dytë gjenden tualetin dhe dy dhoma gjumi të shtruar me parket. Tualeti është gjithashtu i shtruar me pllaka. Nga njëra dhomë gjumi del në një ballkon të vogël.

Studim Vila nr. 4, rruga “Qemal Stafa”





Kjo vilë është e ndërtuar me tulla, por në ndryshim nga Vila nr. 1, i është kushtuar vëmendje përzgjedhjes së tullave si dhe kujdes në ndërtimin e saj, pasi ajo nuk është e suvatuar. Gjëja e parë që të bie në sy është hyrja e vilës, e cila është madhështore. Duke filluar që nga shkallët të punuara me mermer dhe parmakët që kanë forma të buta organike, të cilat duken sikur përqafojnë oborrin dhe bëjnë mbylljen ideale të shkallëve. Harku i madh krijon një sfond për shkallët duke të lënë përshtypjen se fasadës kryesore i kushtohet një rëndësi e veçantë. Harku është i ndërtuar me tulla të vendosura këllç. Vila është mjaft e ruajtur dhe në ditët e sotme. Edhe pse duket që është rikonstruktuar, origjinaliteti i saj nuk i është ndryshuar asgjë. Me mbarimin e shkallëve krijohet një tip verande për vilën, e cila në qendër ka një dritare dy kanatëshe dhe ka dy dyer në dy cepat e saj. Në katin e parë mbi harkun e hyrjes ka një ballkon, i cili është i mbyllur nga anët dhe vetëm në mes është stilizuar me një parmak të dekoruar me elemente që përsëriten. Kjo vilë është mjaft e mirëmbajtur në krahasim me vilat e tjera të ndodhura në këtë zonë.

Studim Vila nr. 7, rruga “Hilë Mosi”

Vila 7 është ajo që dallon më së tepërmi me të tjerat. Një nga dallimet është zgjidhja planimetrike e saj që duket qartazi edhe nga volumetria. Në ndërtimet e banesës së këtyre viteve, ato që përgjithësisht përdoren janë zgjidhjet planimetrike jo thjesht funksionale, por edhe drejtkëndore. Ndërsa në këtë rast planimetria është në formë L. Dallimi tjetër qëndron tek ballkoni, që përveç se me llozhë të stilizuar me element dekorativ të përsëritur njëri pas tjetrit, del përpara duke dhënë hije direkt mbi kornizën e derës hyrëse të banesës. Një tjetër detaj, jo më pak i duk-

shëm, është edhe stilizimi i kornizës së dritareve dyshë. Kjo kornizë nga njëra anë është e thjeshtë, me dy hapje, ndërsa nga ana tjetër kanë elementë dekorativë, të cilët përsëriten si në dritaret e katit përdhe, ashtu dhe të katit të parë. Ndarja e kateve bëhet me anën e balustrave të dukshme në fasadë. Vetë banesa nga forma e planimetrisë dhe stili i përdorur në fasadë duket që është ndërtuar për familje të një rangu të lartë shoqëror. Ajo që haset përsëri në këtë vilë është mbyllja e oborrit të banesës me mur tulle jo shumë të lartë.



Skicoi: E. Duro



Studim Vila nr. 1, rruga “Dervish Hekali”



Kjo banesë është një tip i thjeshtë vile një katëshe e ndërtuar me mure mbajtëse, me çati prej tjegulle katër ujëse. Pjesa më interesante e saj është stilizimi i kollonave të hyrjes me elementë në trajtën e unazave, të cilat vendosen në gjithë gjatësinë e kolonës dhe

krijojnë ritëm të këndshëm. Dy kolonat e vendosura në pjesën ballore krijojnë një verandë për hyrjen e banesës, e cila është e drejtpërdrejt me oborrin e banesës që është i mbyllur nga rrugët me mur tulle.

Studim Vila nr. 3, rruga “Qemal Stafa”



E para gjë që të vjen në mendje me pamjen e kësaj vile është fryma mesdhetare që mbart. Është fasada ose më mirë gjithë volumetria e saj e bardhë, që të jep këtë ide. Ndërsa nga ana ndërtimore vetë hyrja e saj është e detajuar, sepse ngrihet me anë të kolonave që përfundojnë me një harkade, e cila krijon hapje si nga ana ballore, ashtu dhe anësore. Kolonat kanë një kapitel të stilizuar. Sipër hyrjes ka një ballkon të hapur vetëm nga dy anët e tij me një parmak, i cili është

detajuar me elementë që përsëriten në gjithë gjatësinë e tij. Mbyllja e kësaj vile është me çati me tjegulla, të cilat duken se janë vendosur në mënyrë tërësisht të rregullt. Megjithatë kjo mund të jetë dhe si pasojë e rikonstruksionit që kjo vilë ka pësuar. Ndërsa mbyllja e oborrit të banesës është bërë me mur, i cili është relativisht i lartë dhe hyrja brenda tij bëhet nga një portë me kangjella.

Studim Vila nr. 5, rruga “Qemal Stafa”



Tek kjo vilë ka më tepër detaje të veçanta në krahasim me ato që pamë më sipër. Ka një zgjidhje asimetrike. Hapja qendrore është më e madhe dhe dy anësoret janë më të vogla. Interesante është dritarja

treshe me përdorimin e dekorit karakteristik. Të bie në sy korniza e dhëmbëzuar që rrethon vilën. Përdorimi i hekurit të rrahur në ballkon i bashkëngjitet dekorit të përgjithshëm.

Studim Vila nr. 6, rruga “Qemal Stafa”



Në katin e parë të kësaj vile mëse i lexueshëm është ballkoni, i cili ka të veçanta pjesët anësore, të cilat kanë formën e gjysmëharkut, ku të njëjtën formë marrin dhe profilet e hekurit, të cilat vendosen horizontalisht në mënyrë paralele me njëri -tjetrin dhe kështu formojnë parmakun e ballkonit. Kjo banesë

është objekt i restauruar, por vlen për t' u përmendur që edhe sot ajo ruan vlerat arkitektonike të kohës. Ashtu si shumica e banesave tiranase të kësaj periudhe, kjo vilë është e pajisur me oxhake. Për mënyrën e ndërtimit nuk mund të thuhet shumë, por ajo që vlen të përmendet janë fasadat e pastra dhe të thjeshta

dhe me pak hapje për dritare, ku këto të fundit janë të thjeshta dhe me korniza jo të stilizuara. Mbyllja e vilës bëhet me tarracë të sheshtë, e cila del pak jashtë konturit të mureve. Në këtë vilë ka jetuar profesor Eqerem Çabej dhe është në pronësi të vajzës së tij.

Studim Vila nr. 8, rruga “Dervish Hekali”



ZONA 9



Skicoi: E. Duro

Vila 8 është ndërtuar me tulla, sipër të cilave është vendosur një shtresë suvaje. Ajo ç'ka vërehet lehtësisht është detaji i cepave të mureve, të cilat të japin idenë e një ndërtimi me skelet mbajtës. Vërehet dekorim i ngjashëm me atë të shumë vilave të tjera të së

njëjtës kohe. Ky dekoracion është tipik i vilave të ndërtimit të kohës së Zogut, ku derdhja e këtyre formave bëhej me kallëp të veçantë, me një përgatitje prej allçie të përzierë me rërë. Kjo vilë është e mbyllur me çati me tjegulla vendi.

Studim Vila nr. 9, rruga “Sul Bega”



Kjo është një vilë e ndërtuar me qerpiç me përforcim me breza druri, të cilët lidhen mes tyre me llaç argjili. Si vilë është mjaft e thjeshtë. Ka vetëm dritare, të cilat përsëriten dhe krijojnë ritmin e vetëm në gjithë fasadën e saj. Këtu dritarja diku është me tre

kanate, diku vetëm me një. Korniza e çatisë del jashtë fasadës dhe mbahet nga trarë druri, të cilët janë lehtësisht të dallueshëm. Ajo që e bën të bukur dhe interesante këtë banesë është oborri dhe gjelbërimi.

ZONA 10

Universiteti POLIS

Përpunoi: Drilon Shamolli, Gerti Struga


Punuan: Drilon Shamolli, Edison Meçaj, Fatos Elezi, Gerti Struga, Liburn Halili, Shkëlqim Hoti, Remzi Kutrolli, Veton Ahmetaj, Xhon Kolnikaj, Zamira Abazi

Fotografiti: Gerti Struga, Liburn Halili, Veton Ahmetaj

Tirane - Rruge e Pishës



Zona 10



Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoi: G. Struga

Karakteristikat e Zonës

Zona 10 është e pozicionuar në skajin lindor të zonës së vjetër të Tiranës. Në jug është e kufizuar me lumin "Lana" dhe në veri me rrugën "Hoxha Tasim". Zona ka agreguar popullsinë tiranase pikërisht duke shfrytëzuar pozitën dhe pasuritë e mëdha natyrore, si ujëra nëntokësorë dhe bimësinë e veçantë. Banesat i përkasin të njëjtës tipologji, me oborr, kryesisht një ose

dykatëshe dhe me çati dy ose katër ujëse. Banesat krahas karakteristikave të përbashkëta kanë dhe dalime të shumta që vërehen në variacionet, të cilat i përkasin një periudhe, qoftë ajo e influencës osmane, italiane apo autoktone. Tendencat e zhvillimit të zonës po çojnë dalëngadalë në degradimin dhe zhdukjen e vlerave arkitektonike të këtyre banesave.

Vendndodhja e vilave



Pallatet mbas viteve 1945



Banesat prezente para 1937
(të identifikuara me vijëzim
tek numri)

Vila nr. 20, rruga “Vllazën Huta”



Vila nr. 42, rruga “Ramazan Dema”



Fotografi të vilave



Pamje panoramike e rrugës “Tefta Tashko” / Fotografia: G. Struga



Vila nr.14, rruga “Vllazën Huta”



Vila nr. 59, rruga “Bargjinët”



Vila nr. 4, rruga “Tefta Tashko”



Vila nr. 33, rruga “Indrit Cara”



Vila nr. 23, rruga “Vllazën Huta”



Vila nr. 40, ruga “Ramadan Dema”

Studim Vila nr. 3 pronësi e Toptanëve





Për herë të parë emri i Tiranës u përmend në vitin 1418 në një dokument të Venedikut. Regjistrimi i tokave të qytetit u bë nën sundimin otoman në vitet 1431-1432. Tirana u themelua në 1614 nga Sulejman Pasha. Dy shekuj më vonë drejtimin e qytetit e mori familja Toptani, nga Kruja. Dy lagjet më të vjetra të Tiranës kanë qenë ajo e Mujos dhe e Pazarit, të ndodhura sot në zonën mes qendrës aktuale dhe rrugës së Elbasanit. Banesa që morëm në studim ndodhej pikërisht në zonën e pazarit, saktësisht në rrugën “Tefta Tashko”. Banesa, pothuajse, ishte në gjëndje të rrënuar (fotografia më sipër) me disa rikonstruksione të vogla, si lyerja me blu e murit të jashtëm dhe mbyllja e një sipërfaqe të murit me gips apo duke u transformuar në një dyqan. Megjithatë, ajo ka ruajtur identitetin e vet historik. Ajo çfarë vërejtëm ishin dritaret e banesës (fotografia poshtë), të cilat ishin të veshura me korniza druri dhe kishin një prejardhje nga periudha otomane. Çatia është tipike e zonës me tjegulla të kuqe dhe ka çati katër ujëse.


Studim Vila nr. 58 dhe 59, pronësi e Agim Strugës




Fotografoi: G. Struga

Dy banesat ndodhen pranë rrugës “Bargjinëve“, në një nga rrugicat, që kalojnë tërthor me të. Ato janë nën pronësinë e z. Agim Strugës. Mendohet se ato kanë një vjetërsi mbi 100 vjeçare dhe gjatë gjithë jetës të tyre ato i janë nënshtruar disa rinovimeve. Në fillim, ato kanë qënë rezultat i vendosjes spontane dhe janë ngritur pa planifikim, duke u bërë shëmbull tipik i arkitekturës vernakolare. Të dy banesat kanë oborr në pjesën e përparme, i cili është i përbashkët.


Vila është projektuar me idenë se një ditë kur fëmijët të kishte familjet e tyre, ajo do të ndahej në dy. Aty vërehet prania e mureve me qerpiç, pusit dhe caracit. Këto janë karakteristikat kryesore të zonës. Këto banesa janë të pajisura me banjo në oborr, depo dhe vende për mbajtjen e druve për ngrohje. Në brendësi ndodhej gjithashtu, dhoma për mbajtjen e ushqimeve, e cila ishte pa çati. Hamami shërbente për larje. Çatia ishte e mbuluar me tjegulla të kuqe.



Planimetria hershme / Rilevoi :G. Struga



Planimetri e sotme / Rilevoi: G. Struga




Prerja A-A / Rilevoi: G. Struga



Prerja B-B / Rilevoi: G. Struga

Detaje të vilës nr. 58 dhe 59



Pamje Ballore / Skicoi: G. Struga



Pusi tregon praninë e ujërave të shumtë nëntokësore. Foto e marrë nga vila nr. 4


Fotografoi: G. Struga / Skicoi: V. Ahmetaj



Çatia mbulohet me tjegulla vendi. Tjegullat janë të bëra me qeramikë. Ato janë të vendosura njëra mbi tjetrën, e fundit është e kthyer përmbys, që ujërat e shiut të shkarkohen në ulluk.

Fotografoi: G. Struga / Skicoi: L. Halili

Detaje të vilës nr. 58 dhe 59



Pamje e vilës 58 / Skicoi: G. Struga



Pikturë me simbole fetare e vitit 1943, është dhuratë martesë për Hamid Stugën, babai i pronarit të vilës 58 / Fotografoi: G. Struga

Kjo orë i përket periudhës art-deco dhe është fotografuar në familjen e z. B. Tufina / Fotografoi: G. Struga



Qilim i të njëjtës periudhë me pikturë në anë, i cili bënte pjesë në pajën e nuses së z. Hamid Struga / Fotografoi: G. Struga

Bimët karakteristike të zonës



Dëshira për t'u ndjerë mirë jo vetëm brenda, por edhe jashtë shtëpisë i ka shtyrë banorët e kësaj zone të mbjellin kultura të ndryshme në oborret e tyre, si hardhi, limon dhe carac. E fundit është karakteristike e zonës dhe e ka sezonin e çeljes në fund të vjeshtës. Megjithatë, kohët e fundit caraci nuk shihet shpesh në oborret e shtëpive. Këtë e dëshmon edhe fakti që kjo foto është bërë në afërsi të qytetit e jo brenda tij.

Caraci / Fotografia: G. Struga



Limon / Fotografoi: Z. Abazi



Hardhi / Fotografoi: Sh. Hoti

Studim Vila nr. 19



Fotografoi: D. Shamolli

Banesa gjendet përgjatë rrugës “Vllazën Huta” dhe është nën pronësinë e F. K. Nga informacionet e mbledhura mësuam se i përket vitit 1925, ndërtuar me arkitekt. Ajo paralelisht ka një vilë të së njëjtës tipologji ndërtuar nga i njëjti arkitekt (vila nr. 20). Vila 19 shfaqet me një influencë të theksuar të arkitekturës italiane. Ajo është dy katëshe, me ballkon në fasadën balllore dhe me oborr në pjesën e përparme dhe të pasme. Në fasadën balllore vërehen dekorime lineare me vija paralele përgjithësisht horizontale. Korniza është prezente, si në dritaret, dyert, hapësirën ndarëse me katin e dytë dhe në kornizën e çatisë. Ajo që vlen të përmendet është prania e çatisë, që nuk është tipike e racionalizmit italian, por është e importuar nga tipologjia autoktone.





Fotografoi: D. Shamolli




Skica gjatë rievimit të vilës nr. 19

Rievimi i vilës nr 19 në terren, 23.04.2011


Punuan: Drilon Shamolli, Gerti Struga, Remzi Kutrolli, Xhon Kolnikaj



Planimetria e katit përdhe / Punoi: R. Kutrolli




Prerja A-A / Punoi: F. Elezi



Pamje / Rilevoi: G. Struga & R. Kutrolli

Detaje




Rilevuar në vend / Punoj: R. Kutrolli





Dritare me grila persiane druri / Fotoqrafi: D. Shamolli

Detaje



Balustër / Punoi: R. Kutrolli & L. Halili



Shtrimi i pllakave prej çimentoje / Skicoi: G. Struga

Përmbledhje

Ajo çfarë vërehet është tendenca për t'u zhdukur e ndërtimeve me vlerë historike. Jo vetëm kaq, por për t'u zëvendësuar me pallatet shumëkatëshe...

Sipërfaqja e zonës 10 është relativisht e madhe dhe përfshin në gjirin e vet një shumëllojshmëri objektsh arkitektonike. Kjo zonë është pjesë e sistemit radial të pjesës historike të qytetit. Ai është i përzgatur nga qendra në drejtim të periferisë, drejt Djatit dhe drejtohet nga bulevadi “Zhan d’Ark” dhe rruga „Hoxha Tasim“. Në kuadër të studimit tonë, veçuan një kategori objektsh të viteve 1912-1944, atë të vilave.

Këto u ndanë në dy grupe: vila me ndikim të arkitekturës italiane dhe vila karakteristike të zonës. Sipërfaqja në studim qëndron në skajin lindor të bërthamës historike të Tiranës. Lumi „Lana“ në jug ka qenë në mënyrë konstante një pengesë dhe kufi për shpërhapjen e qendrave të banuara.

Drejtimi i zhvillimit dhe zgjerimit të banesave është bërë sipas drejtimit të dy trajektoreve kryesore: rrugës “Pishës” dhe „Bamit“. Rëndësi të veçantë ka dhe rruga „Tefta Tashko Koço“ përgjatë së cilës janë vendosur vila me vlerë historike, ku spikatet vila e Toptanëve. Karakteristikë e zonës është se, të gjitha ndërtime të vjetra qëndrojnë mirë ndaj rrugëve. Ato tentojnë të kenë fasadën në një qasje të drejtpërdrejtë me kalimtarët. Prezenca e shumë shtëpive përforcohet nga prania e rrjetit rrugor të pasur me trajektore kryesore, dytësore, por edhe disa rrugë qorre. Pasuria e madhe nëntokësore është një element tjetër i rëndësishëm i zonës, që dëshmohet nga pusët si dhe nga habitati i pasur bimor. Ndër karakteristikat e tjera natyrore të terrenit është edhe pjerrësia e lehtë, e cila vjen nga „Dajti“ në drejtim të qendës, që përcakton edhe rrjedhën e lumit Lana.

Në pjesë të caktuara mund të vërehet edhe pjerrësia e tarracës lumore, e cila vërehet më së miri tek rruga “Arkitekt Kasëmi” dhe rruga “Skënder Kosturi”.

Puna rreth zonës kërkonte angazhimin e gjithë grupit, ku pikë së pari u prezantuan me zonën. Studimi filloi nga një vëzhgim i thjeshtë në terren, duke evidentuar banesat e vjetra me dokumentimin me anë të fotografive.

Kjo etapë e studimit u pasua nga një fazë shkencore

duke studiuar tipologjinë dhe tipet e banesave. Pasi evidentuam të gjithë banesat e zonës, i klasifikuam në tre tipe banesash:

Banesa të thjeshta me qerpiç

Banesa dykatëshe me dyqane poshtë

Banesa me arkitekt (influence italiane)


Gjatë punës në terren hasëm vila, të cilat kishin ndryshuar funksionin e tyre nga banim si në çerdhe, aktivitet ekonomik.

Gjithashtu, u qasëm me një tip banese të veçantë, si ajo e Toptanëve, me ndikim të dukshëm Otoman.

Tipi më i përhapur në këtë zonë ishte banesa një katëshe me qerpiç, me çati me tjegulla të kuqe dhe me oborr. Këto janë ndërtuar veçanërisht me material të vendit. Kjo vërehet në ndërtimin e mureve me qerpiç, i cili përgatitej nga disa kallëpç prizmatikë, të cilat mbusheshin me argjil të zonës, i që më pas lihej të pijej në diell. Muret e qerpiçit ishin zakonisht rreth 60-70 cm të gjërë, ndërsa qerpiçët lidheshin me laç balte të përziera me kashtë. Brezat e drurit viheshin çdo 0.7 – 1 m lartësi dhe përbëheshin nga 2 binarë, një nga brënda, një nga jashtë dhe lartësia e tyre shkonte rreth 3.5 – 4 m. Ky lloj muri kishte disa avantazhe nga pikëpamja ekonomike dhe termoizolimit.

Gjithashtu siguronte qëndrueshmërinë nga faktorët natyrorë, si termete, shi, breshër. Shumatorja e këtyre mureve formonte banesa drejtëkëndore me sip 30-55 m², me stabilitet të lartë, bazuar në ndërtimin me të njëjtin element ndërtimi. Themelet ndërtoheshin me materialet e zonës, si guri i lumit, ndërsa muret suvatoheshin me laç balte dhe lyeshin me gëlqere.

Një tip tjetër vile ishte ajo me ndikim të arkitekturës italiane. Kjo tendencë vërehet gjatë monarkisë së Ahmet Zogut. Politikat e asaj kohe mundësuan një shkëmbim kulturor mes Shqipërisë dhe Italisë. Kjo gjë shfaqet në ndërtime të reja në vend, të cilat dallonin nga ndërtesat autoktone. Rrisitë që sollti kultura e re ishin të shumta për nga teknika e ndërtimit, sidomos stili i ornamenteve dhe elementeve zbukurimorë, ku filluan të shfaqen tenden-



cat e racionalizmit italian.

E veçanta e kësaj periudhe ishte kombinimi mes elementeve autoktone dhe atyre të ardhur. Tarraca në racionalizmin italian zëvendësohet me çati me tjegulla të kuqe të zonës, gjithashtu ndërthurja e vilave me oborrin në pjesën ballore ose të pasme. Kjo lidhje nuk do të realizohej pa prezencën e arkitektit, e cila duket edhe në kompleksitetin e banesave të kësaj periudhe. Ndërthurja mes hapësirave ishte e studiuar me kujdes dhe realizuar me profesionizëm. Ndikimi italian solli elementë zbukurimorë linearë, ku filluan të shfaqen elementë të parapetëve balustër, dritareve, dyerve të zbukuruar, gjithashtu edhe pllakat e dyshemesë. Në fasadën ballore vërehej një segmentim përmes kanaleve të murit. Kanali në mur ishte horizontal me gjerësi 2 cm dhe 2 cm i thellë.

Kjo gjë, përkrah efektit estetik të hijes që krijonte, shërbente për të evokuar ngjashmërinë me ndërtimet perandorake romake. Këto kanale tentojnë të zëvendësojnë opus latericium romak ose punimin e murit me terrakotë. Duke u përshtatur në mjedisin shqiptar duhej të krijohet ideja se territori shqiptar ka qenë tokë integrale e perandorisë romake.


Në fillim të relacionit përmendëm dendësinë demografike të zonës. Për të lidhur këtë aspekt me tendencat dhe problematikën e ditëve të sotme mjafton një vëzhgim në terren. Ajo çfarë vërehet është tendenca për t'u zhdukur e ndërtimeve me vlerë historike, apo akoma me keq, për t'u zëvendësuar me pallatet shumëkateshe. Studimi ynë hapi udhën drejt këtij konkluzioni, ku kemi paraqitur përmes hartave raportin mes vilave dhe pallateve pas viteve 1945 dhe pas viteve 1990. Kjo është paraqitur në një fasadë të rrugës "Tefta Tashko Koço", ku dallohet diferenca mes historisë dhe tendencave të së ardhmes. Sipas analizës së bërë dolëm në përfundim se, arsyeja pse këto banesa njëkateshe po degradojnë dhe po transformohen në „përbindëshat“ konsumues të hapësirave publike, ato të gjelbra dhe imazhin e qytetit, është mungesa e potencialit ekonomik për t'i rinovuar këto vila me vlerë historike. Kjo vështirësi ekonomike e banorëve shoqërohet dhe nga mungesa e subvencioneve financiare nga ana e organeve kompetente. Neglizhenca e shoqërisë dhe institucioneve do të sjellë pak nga pak zhdukjen e vlerave arkitektonike të zonës dhe gjithë qytetit.

ZONA 11


Universiteti POLIS

Përpunoi: Anilda Puleri, Dea Buza

Punuan: Aleksandër Jushi, Armand Prelezi, Besjan Siriani, Brixhilda Bicaku, Dea Buza, Desian Dyrmishi, Dean Hado, Enton Nino, Elsid Kaletaj, Eriketa Rrenjollari, Emil Spiro, Erion Duro, Fiona Hoxha, Fatjon Molla, Florent Grainca, Gledis Misja, Gjinovefa Xinxo, Ira Aga, Igli Sala, Klaudia Llupo, Klevis Bregu, Lorela Malsbi, Lorena Xhaxho, Nexhmi Tupja, Rezart Struga, Salion Çizmja



Zona 11



Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoi: G. Stuga

Karakteristikat e Zonës

Në planin rregullues të Tiranës të vitit 1936 zona përreth rrugës së "Elbasanit" u parashikua të ndërtohej me vila dy katëshe, me parcela deri në 800 - 1000 m², duke formuar një zonë "City Garden" (Qyteti kopësht). Ndryshimi që u vu re, ishte krijimi i një

Tiranë të re, e cila do të përbëhej nga një qytet i mënjanuar më vete apo si quhet "qyteti kopësht". Arkitektura në këtë kohë kishte një tendencë racionaliste në bazë të projektit të Brasinit, po dhe me influenca të Bauhausit. Plani ishte për një shfrytëzim racional të mjedisit me burime të disponueshme.

Vendndodhja e vilave



Studim Rruga Jul Variboba



Fenomeni që do të studiojmë në këtë zonë ka të bëjë me transformimin që kanë pësuar rezidencat e ndërtuara gjatë viteve 1920-1940. Këtyre objekteve u është shndërruar funksioni primar që kanë pasur, nga banesa ato janë kthyer në lokale ose hotele. Vendndodhja e tyre tregon për një plan urban të organizuar. Këto objekte janë ndërtuar në mënyrë të tillë, si pjesë e planit të qytetit kopësht.

Rrugica që do të prezantojmë ndodhet mbrapa Piramidës, që e kemi quajtur “Rrugica e Pishave” ose siç quhet sot, rruga “Jul Variboba”. E quajtmë të tillë

për vetë faktin se, në kohën kur këto ndërtime janë krijuar, në oborret e tyre kanë qenë mbjellë vetëm pisha, të cilat për arsye teknike u zëvendësuan me palma. Pishat u hoqën nga ndërtesat, sepse bllokoni ulluqet dhe fusnin ujin brenda në shtëpi. Ndërtimet individuale borgjeze, që bëheshin në atë kohë, daltonin për një zgjidhje urbanistike drejtkëndore, më shtrirje të madhe, duke filluar nga rruga e “Elbasanit” deri tek kodrat e Saukut. Parcalet ishin të barabarta, mbylleshin në mënyrë kuadratoke, zbukuroheshin me kangjella, me të njëjtin ornament me derën krye-

sore dhe kangjellat e ballkoneve. Tjetër karakteristikë e vilave ishte ndarja e tyre me një mur, i cili ishte në pronë të atij që e ndërtonte. Oborrit e zbukuroar me gjelbërim, jo vetëm brenda kufizimit, por dhe jashtë saj e shoqëronin “shtëpiza” të vogla, të cilat përdorshin për gatim në ambientet e jashtme të vilës. Përsa i përket fasadës së tyre ato kanë pasur vetëm një drejtim orientimi, nga ana e lumit Lana. Në planin e Tiranës parashikohej të bëhej shëtitëtorja, ku të gjithë vilat do të kishin qasje me një hyrje nga ana e shëtitëtores. Por, ky plan nuk u realizua asnjëherë dhe për



këtë arsye disa vila kanë kthyer fasadën nga rruga duke bërë një hyrje përmes saj.

Vilat janë të vendosura në një distancë të konsiderueshme nga dera kryesore e oborrit, duke mundësuar hapësira të lira para dhe pas objektit. Gjithashtu, distanca e trotuarit me derën e vilave ishte e konsiderueshme, duke mundësuar në këto hapësira mbjelljen e pemëve të ndryshme dhe vendosje të zbukurimeve përmes dritave dhe mozaikëve, duke dhënë idenë e krijimit të qytetit kopësht. Kjo zonë e ndarë në parçela, përbëhej nga tetë vila dykatëshe, të cilat ndryshonin nga njëra-tjetra, përta i përket stilit të ndërimit. Vilat kanë detaje shumë interesante, duke filluar me ballkone në formë gjysmë harku me hekur të rrahur të stilit Art-Deco, elementë, të cilat janë të njëjtë me elementët dekorativ të derës së jashtme të

oborrit. Dritaret janë të rrethuara me një kornizë dhe bazamak të dalë pak më shumë se korniza. Ato janë me grila prej druri. Kolonat janë të veshura me terrakotë. Çatia është katër ujëse, ku del konsola me elemente mbajtës të zbukuruar. Vërehet se hajatet janë me kolona. Kemi, gjithashtu, një parapet të njëjtë tek dyert dhe tek ballkonet. Për t'u futur në derën kryesore duhet të ngjitesh në disa shkallë. Disa prej shtëpive kanë dhe oxhak. Ballkonet janë të mbuluara me çati katër ujëse, të cilat kanë një lukarn, që mendojmë se janë shtuar më vonë. Me kalimin e kohës funksioni i vilave ka ndryshuar. Ato janë kthyer në lokale, për shkak të interesave të pronarëve të tyre, favorizuar edhe nga afërsia e tyre me rrugën.

Studim Vila nr. 4



Vila 4, marrë në studim, ndodhet në rrugën “Jul Variboba”, pranë Piramidës, në afërsi të lumit të Lanës. Kjo vilë bashkë me të tjerat formojnë një bllok vilash në këtë zonë, ndërtuar rreth viteve 1912-1945. Në këtë periudhë vërehet se, këto vila janë komplekse dhe me prirje të ndryshme. Kjo arkitekturë u përpunua nga mjeshtra, arkitektë dhe inxhinierë të shkolluar.

Kjo periudhë karakterizohet nga një zhvillim historiko-shoqëror i paqëndrueshëm në etapa të caktuara, sidomos në atë midis dy luftërave botërore. Borgjezia shqiptare kishte mendimin se ishte më mirë të kopjoje të tjerët, se të krijoje vetë nga e para. Kështu që arkitektura e vendit tonë nuk shpëtoi nga ethet funksionaliste.

Kjo rrymë kaq e përhapur kishte moton e saj ‘forma ndjek funksionin’. Gjuha e re shprehëse e funksionalizmit gjeti terren të gjërë aplikimi veçanërisht nga futja në përdorim e betonit dhe hekurit. E reja në këtë arkitekturë u bë më e dallueshme në rritjen e kërkesave për teknikat e reja ndërtimore, përdorimi i gërshetuar i materialit rrethor tradicional dhe atij modern. Në këtë rrymë përfshihet edhe vila 4, që pozicionohet në bllokun e parë dhe që ka komunikim më rrugën kryesore dhe dytësore në të dyja anët e saj. Në pjesën ballore të saj ndodhet porta hyrëse për në banesë, kurse në anën tjetër ndodhet porta, që kalon në pjesën e prapme dhe që të çon në garazhë.

Në brendësi të saj, vila rrethohet nga një sipërfaqe e madhe e oborrit të brendshëm, e cila mbulohet me gjelbërim të lartë dhe të dendur. Gjelbërimi këtu është një faktor i rëndësishëm, sepse tregon kohën e gjatë të ndërtimit të vilës. Oborri është i sistemuar nga urëza, e cila konturon gjithë vilën dhe në vazhdimësi të saj, përgjatë oborrit, bënë të mundur kalimin ose shëtitjen nëpër territorin e gjelbëruar. Veshja e kësaj urëze është bërë me pllaka të vogla katrore, të cilat tregojnë se ky element është detaj i pandryshuar i projektit të vilës. Një tjetër element i rëndësishëm është muri rrethues i ambientit të vilës. Ai është i lartë rreth 50 deri në 60 cm dhe bën të mundur komunikimin midis ambientit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Kjo të krijon përshtypjen se je duke bërë shëtitje në një park të rrethuar. Xokolatura përfundon me tulla të vendosura në formë të rregullt, që ndjekin gjithë murin e vazhduar. Mbi të ngrihen disa kolona, që kanë pothuajse të njëjtën lartësi, të cilat përfundojnë gjithashtu me tullën e kuqe të vendosura në mënyrë horizontale. Ky ritëm përsëritet në të gjitha kolonat. Lidhja midis kolonave bëhet me anë të kangjellave të hekurta, të ngritura në vertikalisht, ku midis tyre kapen me anë të perçinave.

Kombinimi i tullës së kuqe me gurin është përdorur edhe në fasadën e vilës. Banesa dy katëshe ka tri hyrje për në brendësi të saj. Hyrja e parë për në banesë ngrihet nga pesë shkallë, të cilat vazhdojnë me një korridorë të gjatë dhe përfundojnë përsëri me shkallë nga ana tjetër. Përgjatë korridorit është vendosur një





bordurë e gjatë, e cila përveç funksionit ndarës me oborrin, ka dhe funksion dekorativ. Sipër saj, është krijuar një çarje, e cila mund të mbillet me gjelbërim të ulët. Muratura e kësaj bordure paralelizohet me muraturën e murit rrethues. Një element tjetër, i cili nuk ka ndryshuar është dera e hyrjes për në banesë. Dera e punuar me dru është ndërthurur me hekur dekorativ dhe xham. Këto hekura janë fiksuar në derë me anë të perçinave lidhëse. Një element i dukshëm i kësaj periudhe është dhe përdorimi i sistemit trilitik mbi portën kryesore të mbuluar me soletë beton-arme. Veshja e kolonave anësore tek dera bëhet përsëri me tullën e kuqe të vendosura në mënyrë horizontale dhe e rrethuar me gjelbërim. Detaje të tjera, të cilat kanë mbetur të pandryshuara janë dhe kornizat, të cilat konturojnë dritaret. Këto kornizime me një spesor të caktuar evidentojnë më tepër fasadën duke bërë një diferencim ngjyrash. Kornizat nuk kornizojnë

vetëm dritaret e bodrumit, të cilat janë të veshura në anësore me gurë të çukitur.

Ky lloj guri vesh gjithë pjesën e poshtme të vilës deri në njëfarë lartësie, jo shumë nga toka. Një tjetër paralelizem bëhet midis kontureve të dritareve me konturet e çatisë. Çatia rrethohet nga një kontur i dhëmbëzuar dhe nga një i dytë me i thjeshtë. Ky kontur ka një funksion dekorativ. Detaje që bie në sy janë tjegullat e vendit në çati, ku në disa pjesë janë bërë restaurime. Tjetër element konstruktiv janë dy konsolat në fasadë. Në të dy ballkonet vërehet përsëri përdorimi i tullës së kuqe dhe i hekurit. Këtu hekuri ngrihet përsëri në vertikalisitet dhe diku merr formë të harkuar. Në anën, ku janë dy hyrjet e tjera për në banesë, dallohet mbyllja e murit rrethues me mur të lartë me pilastra për arsye intimiteti nga njëra anë e saj.



Studim Vila nr. 5




Ndërtesa për rilevim është me tipologji vilë urbane. Nndodhet në bllokun e vilave pranë rrugës së “Elbasanit”, pjesë e të ashtuquajturit “Qyteti Kopësht” në planin urbanistik të 1937-ës. Është projektuar nga arkitekti italian Maxukato Luario për familjen Meksi. Punimet kanë filluar rreth 1937 dhe kanë mbaruar një vit më pas. Kjo lidhet edhe me mos-ekzistencën e kësaj vile në genplanin e vitit 1937 të kësaj

zone dhe shfaqjen e saj në genplanin e 1939. Tipologjia, siç shkruhet edhe më sipër, është vilë urbane dykatëshe multifamiljare, mendohet se ajo është projektuar për tre ose më shumë familje. Vila pozicionohet buzë rrugës kryesore “Lekë Dukagjini” si edhe përgjatë rrugës “Jul Variboba”, që siguron aksesin për gjithë këtë pjesë të bllokut të vilave dhe të nxjerr në rrugën e “Elbasanit”.




Pozicionimi i mirë në kënd me dalje në të dy rrugët si edhe situatë urbane, e cila para ndërtimit të vilës paraqitet e plotësuar tërësisht me vila (mendohet se kërkesa për këtë zonë ka qenë e lartë) duhet të ketë sjellë edhe projektimin e saj si një vilë multifamiljare. Sipërfaqja e ndërtuar zë gati 50-70 % të parcelës, ku sipërfaqja e ndërtimit për çdo kat është 300 m², pra një sipërfaqe totale ndërtimi prej 900 m². Bodrumi ka të njëjtën sipërfaqe sa dy katet e tjera. Nga ana

konstruktive kemi të bëjmë me një godinë me mure mbajtës dhe themele të vazhduara, kjo dallohet qartë edhe nga trashësia e mureve, e cila është 50 cm. Lartësia e bodrumit shkon në 2.6 m me një dalje të xokolit prej 1.2 m, ndërsa lartësia e dy kateve shkon në 3.4 m për secilin kat dhe trashësi solete prej 20 cm. Mbyllja e sipërme është në trajtën e çatisë me tjegulla, ku daljet e oxhaqeve janë të shumta, gjë e cila tregon edhe një herë projektimin e saj si një vilë



Planimetri e katit përdhe



Prerje

multifamiljare. Trajtimi i fasadave është i njëjtë, pra nuk kemi një trajtim të diferencuar sipas rëndësisë. Fasadat paraqiten të thjeshta nga ana e detajeve arkitektonike, kjo duke ndjekur rrymën racionaliste që përfshinë përdorimin e elementëve horizontal, në këtë rast linjat e ballkoneve. Gjithashtu, nga planimetria dallohet se vetëm një prej familjeve i kishte të gjitha ambientet në katin përdhe, ndërsa familjet e tjera duhet t'i kenë pasur ambientet e shpërndara në të dyja katet. Në katin përdhe janë vendosur kryesisht ambientet e ditës, ndërsa në katin e sipërm ambientet e natës. Aksesit për katin e sipërm realizohet me anë të shkallëve, të cilat janë të vendosura në tre prej hyrjeve kryesore, përkatësisht në jug, veri, perëndim. Në ditët e sotme vila paraqitet pjesërisht e pandryshuar nga projekti fillestar. Ndryshimet që ka pësuar janë në fasadë si dhe në funksionin e godinës, ku sot godina shërben si zyra, një pjesë bar-restorant dhe pjesa tjetër ka ngelur e pandryshuar, pra për banim. Në ndarjen e ambienteve të brendshme vila paraqitet

e njëjtë me projektin fillestar, pavarësisht ndryshimit të destinacionit nga banim për shërbim, nuk kemi ndryshim të planimetrisë. Ndryshim tjetër ka në fasadë, por vetëm një pjesë, e cila përdoret për bar-restorant. Detajet arkitektonike paraqiten të pandryshuara, dritaret janë i të njëjtit tip, tek grilat i vetmi ndryshim si pasojë e rikonstruksionit të ndodhur në pjesë të veçanta është përdorimi i grilave prej duralumini në vend të grilave prej druri. Evidentimi i këtyre elementëve është bërë me anë të ngjyrave, të cilat ndryshojnë si në rastin e elementeve të dritareve, ashtu edhe në atë të ballkoneve. Dritaret paraqiten dy llojesh, në formë rrethore dhe katrorë. Aksesit në vilë realizohet nëpërmjet pesë hyrjeve, nga të cilat dy ndodhen në pjesën veriore dhe kanë akses në rrugë, dy në pjesën jugore dhe nuk kanë akses të drejtpërdrejtë në rrugë, por nëpërmjet oborrit, ndërsa hyrja e pestë në pjesën perëndimore përgjatë rrugës kryesore. Vendosija e hyrjeve në këtë mënyrë, ku vetëm njëra vendoset në anën perëndimore, që shtri-

het përgjatë rrugës kryesore, mund të ketë ardhur si pasojë e përdorimit të pjesës së vilës si klinikë ose zyrë.

Ky hamendesim gjen mbështetje edhe në planimetria, ku vetëm në këtë hyrje të vilës gjendet prania e një holli të dytë. Holli vendoset në hyrjen kryesore dhe shërben si paradhomë për futjen në vilë duke siguruar intimitetin e banorëve të kësaj pjese të vilës. Ai, gjithashtu siguron aksesin edhe për dy dhoma, të cilat janë të vendosura në të dyja anët e tij. Nga këto dy dhoma vetëm njëra komunikon me pjesën tjetër të vilës me anë të një dere tjetër. Nga planimetria dallohet qartë edhe një tjetër ambient i veçantë, pozicionuar në anën veriore të vilës, që komunikon me vilën me anë të një dere.



Para rikonstruktimit




Pas rikonstruktimit




Studim Vila nr. 7





Planimetri e katit përdhe /Rilevoi: R. Stuga, Sh. Barçi, D. Djaloshi



Planimetri e katit parë /Rilevoi: R. Stuga, Sh. Barçi, D. Djaloshi

Vila është ndërtuar në vitin 1936, arkitekti i saj është Skënder Luarasi, i cili ka qënë një ndër arkitektët më në zë i kohës. Periudha kur ajo nisi të ndërtohej ishte përpara pushtimit të Shqipërisë nga Italia. Materialet me të cilat është ndërtuar janë të zonës ku ajo ndodhet, duke filluar nga tullat, tjegullat dhe drurët. Tullat janë standarte, 25cm x12cmx 6cm, prej qeramike të pjekur. Edhe tjegullat janë prej qeramike. Elementët e importuar nga Italia janë pemët ose më saktë gjelbërimi. Edhe sot, sipas dëshmisë së famil-

jarëve, një pjesë e gjelbërimit është e ruajtur si në fillim. Ngjyrat, të cilat ajo ka pasur, kanë qënë bezha dhe e bardha. Si pozicionim shtëpia është e vendosur në qendër dhe nga të katërta anët ajo rrethohet me oborr. Vila ka oborr në pjesën e përparme dhe atë të pasme. Oborri, që ndodhet në anën e pasme është më privat. Po të shohësh skemën distributive ose planimetritë kuptohet lehtësisht organizimi i thjeshtë dhe me kujdes i shtëpisë.





Kjo vilë është shembull tipik i asaj çfarë arkitektët e kohës dëshironin të arrinin, krijimin e një ambienti modern, që ruante traditën e intimitetit.

Kjo mund të vihet re në rregullsinë e linjave të mobilimit, që shoqërohet këndshëm me linjat organike të dy oborreve.

Studim Vila nr. 10

Pushtimi fashist i viteve 1939 nga Italia solli shumë risi edhe në arkitekturën e atyre viteve, që influencuan në ndërtimet e arkitektëve shqiptarë të kohës së monizmit në Shqipëri. Ndërtimet e bëra rreth viteve 1930 e më pas në Shqipëri i përkisnin këtij karakteri, ku veçohen vilat rezidenciale, të ndërtuara në blloqe të caktuara nëpër Tiranë. Një nga këto vila është ajo, e cila ndodhet në bulevardin “Papa Gjon Pali II”, përkatësisht rrugës “Lek Dukagjini” dhe “Mustafa Matohiti”. Vilë ndodhet pranë disa institucioneve të rëndësishme, si Piramida, Televizioni dhe Radiotelevizioni Shqiptarë, INSTAT, ambasada Amerikane etj. Një vilë private banimi, e cila më pas ka shërbyer për Ambasadën Maqedonase dhe sot është restorant Padam. Vila moderne e veshur me detajet e stilit racionalist është frymëzuar nga stilet e arkitektëve të kohës së fashizmit. Ajo përbëhet nga kati përdhe, kati i parë, i dytë dhe i treti. Vila rrethohet nga një kopësht me pemë nga më të ndryshme, karakteristike për vilat e zonës, ku ajo ndodhet. Ajo ka dy porta në pjesën e përparme, njëra shërbente për hyrjen e familjarëve dhe vizitorëve, pra kishte përdorim të përditshëm dhe e dyta, nga përmasat ishte më e madhe dhe përdorej vetëm për raste festash, që kryesisht organizoheshin në oborre. Gjithashtu, ajo kishte edhe një


portë në pjesën e pasme me karakter shërbimi. Oborri kishte një shtrirje rreth e qark vilës. Ai rrethohej nga mure të larta, dekoruar në stilin e arkitekturës racionaliste, ku për t'u theksuar janë detajet e kangjellave, të cilat kishin formën e gjysmëharqeve metalike, me diametër 26.5 cm, ndërsa xokoli me lartësi 1.26 cm vazhdonte me kolonat me lartësi 1 m, që lidheshin me njëra-tjetrën me kangjellat. Në oborr ndodhej një pus i dekoruar me tulla të kuqe. Vila është e mirëmbajtur dhe nuk ka pësuar ndryshime gjatë viteve, ose ndryshimet e bëra ishin në harmoni me ato origjinalet. Shkallët ishin të veshura me mermer. Mbi këto shkallë vendoseshin katër kolona madhështore, të cilat përfundonin me ballkon në katin e dytë duke formuar një portik. Kjo e fundit i jepte vilës një hyrje vërtet madhështore. Kati përdhe vazhdonte me oborrin dhe ndihmonte për shpërndarjen nëpër dhoma. Dyert e përdorura, në këtë kat dhe ato më lart, ishin prej druri cilësor. Shkallët për në katin e dytë ishin të brendshme dhe të veshura me mermer. Tek këto shkallë hasen sërish detajet e racionalizmit, siç ishte një hapësirë e vogël poshtë shkallëve, e cila shërbente si depo, gjithashtu detaje si tek shkelja e parë vazhdonte me një hark që dukej sikur e mbyllte vazhdimësinë e saj.





Ndërsa ngjit shkallët vëren tri dritare me hark, të cilat për nga gjatësia vazhdojnë në dy kate. Në katin pasues vërehet sërish e njëjta shpërndarje dhomash. Korridoret zvogëlohen gjithmonë e më shumë në katet më lartë. Gjithashtu të veçanta janë dyert e dhomave dy flegra me gjërësi deri në 120-160 cm. Ka sistem ngrohës me kalorifer. E njëjti plan përsëritet edhe në katin e tretë. E veçanta e kësaj vile është mansarda, një mini kat i vendosur nën çati, me hapje dritarësh dhe ballkonësh. Çatia është e veshur me tjegulla vendi dhe kudo në të sheh daljet e oxhakëve. Kur del nga vila surprizohesh, pasi fasada e saj tregon vetëm dy nivele, ndërsa në brendësi të saj kupton se ke të bësh me 5 nivele, përfshirë këtu edhe pjesa e mansardes. Vila është e mbushur me detaje të bukura, ku sa më shumë eksploron, aq më shumë shfaqet madhështia e saj.





Studim Vila nr. 11



Fotografoi: D. Shamolli

Vila e marrë në shqyrtim është aktualisht restorant Era. Bëhet fjalë për një objekt modern, ndërtuar si pjesë e planit urbanistik të “Qytetit Kopësht”. Vërehet funksioni primar, si ndërtesë banimi, ka ndryshuar me kalimin e kohës duke u kthyer së fundi në restorant. Më poshtë bëhet krahasimi i ndërtimit të

mëparshëm me atë egzistues. Janë bërë edhe rikostruksione të ndryshme, si në fasada edhe në planimetri. Meqënëse ndërtimi bën pjesë në të ashtuquajturin “Qytet Kopësht” duket se ka ngjashmëri arkitektonike si me vilat e zonës, ashtu edhe me ndërtimet e kësaj periudhe përgjatë rrugës së Elbasanit.

Planimetritë Originale




Planimetria e katit përdhe




Planimetria e katit parë


Pamjet Originale



Planimetritë Ekzistuese



Planimetria e katit përdhe



Planimetria e katit parë





Studim Vila nr. 14, rruga “Asim Zeneli”



Fotografoi: G. Struga

E ndërtuar në vitin 1941 e projektuar nga ark. ing. Skënder Luarasi, si vilë dykatëshe dhe funksionoi e tillë deri në 2000. Më pas u shndërrua në lokal, ku mori emrin Vila “Chocolate”. Deri atëhere ruajti të gjitha detajet origjinale, ndryshimi i vetëm që pësoi ishte funksioni. Në vitin 2010 ndryshoi pronar dhe pësoi ndryshim total dhe nga “Chocolate” u quajt

“Alejandro”. Këtij ndryshimi iu bashkangjit dhe një kat shtesë, që e ndryshoi gjithë pamjen e vilës, pasi shtesa nuk ka asnjë të përbashkët me dy katet ekzistuese. Edhe pse është mirëmbajtur ajo nuk bart vlerat e arkitekturës moderne të periudhës në të cilën u ndërtuar.



Planimetria e katit përdhe

Pamje kryesore



Fotografoi: A. Lushi


Studim Vila nr. 16, rruga “Asim Zeneli”




Fotografoi: D. Shamolli

Vila “Kaon” është një ndër vilat më të bukura të Tiranës. Një vilë që i ka rezistuar mjaft mirë kohës. Ajo u ndërtua rreth viteve 1940 nga arkitektë shqiptarë (ndoshta Q. Butka), arkitektë me vision dhe stil modern, një risi kjo për arkitekturën e Shqipërisë së asaj kohe. U ndërtua në periudhën e ndërtimit të “Qytetit kopësht” për një familje borgjezësh të pasur. Për shumë vite ajo funksionoi si shtëpi banimi, me rikonstruksione të vogla të bëra herë pas here, për ta mbajtur atë në gjendje të mirë. Problemi i vetëm i saj

ka qënë ndryshimi i shpeshtë i pronarëve, që për fat të mirë asnjëri prej tyre nuk e degradoi stilin e përdorur në fillim të ndërtimit, duke ruajtur kështu një pasuri të vërtetë. Rreth viteve të fundit vilës Kaon i është bërë një rikonstruktim, i cili ka nxjerrë në pah elementet e saj karkarakteristikë dhe tipikë të arkitekturës së viteve ‘40. Dritaret, dyert dhe elementët e tjerë konstruktivë nuk kanë ndryshuar aspak. Madje vërehen edhe oxhaqet e vjetër, që edhe pse nuk janë në funksion i japin karakterin kohor kësaj vile.




Planimetria e katit përdhe




Planimetria e katit parë




Vila nr. 11, rruga “Elbasanit”



Planimetri e katit parë



Planimetri e katit të dytë



Pamje origjinale



Pamje e përpunuar / Përpunuar: D. Shamolli & G. Struga



Kjo vilë është në pronësi të Dr. Simonidhit flet për një nga shëmbujt më të spikatur të arkitekturës moderne shqiptare. Për shumë kohë ka shërbyer si Rezidencë për Ambasadën Franceze.

Fotografi të vilave



Vila nr. 1, rruga "Jul Variboba"



Vila nr. 2, rruga "Jul Variboba"



Vila nr. 3, rruga "Jul Variboba"



Vila nr. 6, rruga "Jul Variboba" /Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 9, rruga "Papa Gjon Pali II" /Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 11, rruga "Elbasanit" /Fotografoi:G. Struga




Vila nr. 12, rruga "Asim Zeneli" /Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 17, rruga "Asim Zeneli" /Fotografoi:G. Struga

Studim Vila Ishull



Planimetria e katit përdhe

Shtirija e saj përgjatë rrugës së zhurmëshme të Elbasanit nuk përbën aspak problem për qetësinë dhe komfortin që të ofron qëndrimi në ndërtesën e tipit vilë. Një tipar të rëndësishëm, që përcjell vila është karakteri ekstensiv, vila në të cilat mund të banonin një ose dy familje. Veçori këtu është veçimi i saj, karakteristikë e banesave tiranase që në shek XIX. Kjo banesë është dy katëshe, me përmasa 12 m x 13.5 m x 7 m. Vila ka pësuar ndryshime në vite, si pozicioni i hyrjes, jo më nga rruga. Hasim forma të thjeshta geometrike në fasadë, si drejtëndëshi dhe prizmi, që kontrastojnë me dritaret e ngushta në formë harku. Arkitektura arrihet duke përdorur materiale të vendit dhe trajtimin e tyre me thjeshtësi. Zgjidhja planimetrike shfaqet e ngjashme me rastet e tjera të vilave të zonës. Në katin përdhe është një paradhomë hyrëse që të drejton në sallonin e gjerë, nga ku shkohet në dhomën e gatimit, ndërsa në katin e parë kemi dhomat e gjumit dhe banjot. Shkallët janë të zhvil-

luara mbi një sistem qemerësh dhe mund të shohim sesi drita të shoqëron në itinerarin vertikal duke hyrë përmes dritareve. Kjo zgjidhje hapësinore, që vlerëson sallonin pritës është trashëgimi e vlerave dhe zakoneve shqiptare.

Interieri paraqet interes me shtrimin e tij me granit dhe pllaka. Mobilimi modest i përgjigjet shijeve të shtresës së mesme të kohës për të arritur një jetesë të këndshme. Kësaj vile të rrethuar nga gjelbërimi nuk i mungon gjallëria edhe pse është e veçuar nga të tjerat. Arkitektura e arrirë duket në faktin që, pavarësisht kalimit të kohës, ajo është akoma e banueshme. Raste të tilla sjellin reflektime mbi situatën e tanishme urbane lidhur me vlerësimin që po u bëhet shumë prej këtyre vilave, duke i kthyer në lokale apo të tjerave, që lihen në shkatërrim total. Arkitektura ekzistuese duhet të na bëjë të mendojmë rreth vlerave të trashëguara dhe përdorimin e tyre në të ardhmen, duke reflektuar dhe vepruar.




ZONA 12

Universiteti POLIS

Përpunoi: Emel Peterci


Punuan: Amanda Meco, Eljana Zenaj, Emel Peterci, Sonila Brabollari



Zona 12

Pas shpalljes së Tiranës kryeqytet, filloi edhe procesi i hartimeve të planeve rregulluese të qytetit, të cilët do ta kthenin Tiranën në qytet modern. Kjo erdhi si rezultat i administratës të asaj kohe, që pati si qëllim krijimin e një impianti urban të mbështetur mbi parimet e një urbanistike racionale. Deri në vitet 1925, ndërtimet edhe pse nga ana stilistike ofrojnë shumë, nga ana teknike konstruktive nuk ndodh kështu. Me një vëzhgim të kujdesshëm vihet re se prapa cipës moderne fshihet një konstruksion tradicional me muraturë qerpiçi, breza, trarë druri dhe tavane me kallama sipas teknikës tradicionale. Më pas, gjatë viteve 1930 e më tej Tirana njihet me sisteme të reja konstruktive dhe teknika e ndërtimit ndryshon. Tipologjia kryesore e ndërtimeve të zbatuara janë njësi arkitekturore

me një ose dy kate, me oborr të hapur dhe apartamente kaluese me tre - katër dhoma. Vilat e ndërtuara në vitet 1912-1944 mbulohen me një konstruksion prej druri, mbi të cilën vendosen tjegullat. Strehët, si element përbërës konstruktivë të çatisë, ndërtohen për të mbrojtur muraturën, gjithashtu marrin pjesë në dekorimin e pamjes së jashtme. Në tipologjinë e vilave strehët janë kryesisht të veshura me materiale të ndryshme, zakonisht të suvatuara. Strehët të para sipas skemës statike kanë formë konsoli, ndërsa sipas traditës vendase dhe kushteve mikroklimatike janë të dala dhe të gjëra. Rakordimi i strehëve me këndet e mureve bëhet zakonisht me kënd të drejtë ose me elementë dekorues tipi kornizë me madhësi të variueshme dhe të dhëmbëzuar.




Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoji: G. Struga

Vendndodhja e vilave

Materialet që përdoren për mbulimin e çatisë janë dy: me tjegulla të lugëta vendi ose të importuara nga Italia. Çatitë janë kryesisht katër ujëse, me pjerrësi të pakët. Banesat ruajnë orientimin nga rruga kryesore duke pësuar vetëm një tërheqje të vogël. Ato ruajnë në disa vende vendosjen lineare, ndërsa në pjesë të tjera planvendosja e tyre është e çrregullt. Ajo që duhet të theksohet është larmishmëria e stileve arkitekturore që gjenden në zonë, nga neoklasacizmi në arkitekturën organike. Edhe pse në pamundësi të gjetjeve të dokumentave arkivore rreth zonës vërehet se godinat e ndërtuara janë me plot shije dhe të lënë përshtypjen se janë ndërtuar me arkitektë. Vilat në zonë janë kryesisht rezidenca të nënpunësve dhe të funksionarëve të ndryshëm të shtetit. Nga të dhënat


e pakta arkivore që arritëm të gjenim ishin ndryshimet e emërtimeve të rrugëve gjatë periudhave të ndryshme që kanë shoqëruar Shqipërinë dhe në veçanti Tiranën. Këto transformime japin rezultate negative në jetesën e përditshme në Tiranë, në këtë mënyrë krijohen konfuzione në qarkullim apo edhe në kulturën e një populli. Është e vërtetë që zona e marë në studim, është një pikë kritike e Tiranës Lindore, mirëpo mundemi që kësaj zone t'i gjejmë shpirtin e humbur pikërisht nëpërmjet identifikimit të këtyre rezidencave historike, të cilat janë me të vërtetë perla urbane e arkitekturore të një kaluare plot turbullira dhe mistere. Këto shembuj të kësaj arkitekture na shërbejnë të mësojmë nga mjeshtrat arkitektë të periudhës 1912-1944.




Studim *Vila e familjes Pernaska*



Fotografoi: G. Struga



Planimetri / Skicoi: G. Struga



Vila është mbi njëqind vjeçare dhe ndodhet në kryqëzimin e rrugës “Petro Nini Luarasi” me “Mihal Grameno”, e ndërtuar me arkitekt italian, por të pa identifikuar, madje edhe punëtorët kanë ardhur nga Italia. Ajo është njëkatëshe me një kat të nëndheshëm, bodrum. Është me xokol, me muraturë tullë veshëse. Muret suvatohen përgjatë perimetrit të ndërtesës. E veçanta qëndron në suvatimin edhe të pjesës së daljes konsol të çatisë. Vila përbëhet nga katër dhoma krye-

sore dhe një korridor i gjatë, që shërben si lidhës për ambientet. Kjo përbën edhe bërthamën e shtëpisë, e cila nuk ka mjaftuar për të plotësuar nevojat e rritjes së mëtejshme të familjes. Për këtë qëllim janë bërë shtesa të mëvonshme, të cilat në përputhje me funksionin u janë bërë edhe trajtime të njëjta arkitektonike. Profesionit i pronarit të vilës ka qënë stilist. Dritaret janë dykanatëshe me grila druri persiane, të rrethuara me kornizë të bardhë të dyfishtë.





Element arkitektonik përdorur për derën hyrëse është hekuri i rrahur, i cili merr forma të harkuara dhe të drejta, pa shumë ngarkesë. Struktura me kangjella e derës lejon shikimin në brëndësi të oborrit të vilës. Element tjetër arkitektonik i përdorur për derën kryesore të brendshme është kasa e drurit, me çarje xhami në formë elipsi e mbrojtur me kangjella hekuri. Në brendësi të vilës vërehen mjaft detaje arkitektonike, të cilat janë ruajtur. Mobiljet janë të stilit klasik, me dekorime të shumta. Të veçanta janë pikturat të varura në mur, të cilat tregojnë portretet e pronarve të shtëpisë.




Studim Vila e familjes Dusha




Vila mendohet të jetë ndërtuar para viteve 1924, kur pronar ishin një famije tiranase dhe gjatë vitit 1924 është blerë toka së bashku me ndërtesën, nga Z. Leonidha Dusha, me profesion tregtar. Banesa ka pësuar shumë ndërhyrje sidomos në pjesët anësore të saj. Gjithashtu, në pronësi të familjes Dusha ka qënë edhe një oborr i madh, i cili rrethonte shtëpinë, por

që në vitin 1968 është zënë nga një seri ndërtimesh, të cilat copëtuan oborrin. Këto copëtime çuan në minimizimin e hapësirës së gjelbërt, që rrethonte shtëpinë. Vila është ndërtuar sipas trajtës së shtëpisë tiranase. E veçanta e saj qëndron në trajtimin vetëm të pjesës ballore të hyrjes duke lënë fare të paprekur pjesën perëndimore. Elementët kryesore dekorativë



Planimetri e katit përdhe



Planimetri e katit parë



që bien në sy janë dekorimi i dritares si dhe shkallëve kryesore, të cilat janë të derdhura në beton. Ky fakt tregon për një bashkëjetesë të mirë të dy karakteristikeve të ndryshme konstruktive, e cila është ai i ndërtimit të shtëpisë me qerpiç dhe përdorimit të betonit si element sërish konstruktiv.

Kompozimi përbën një volum dykatësh, ku në

katit përdhe kemi organizimin e hapësirave ndihmëse, ndërsa në katit e parë ambientet e jetesës. Vërehet një lloj kushtëzimi i katit të parë për të ndjekur formën e katit përdhe. Ndërkohë që, kemi një organizim të mirë të ndarjeve të ambienteve duke lejuar rrjedhshmëri të aktiviteteve ditore. Në planimetri duket qartësisht forma e parë (shtëpisë së zjar-

rit), ku me kalimin kohës ka pësuar zgjerim në pjesët anësore. Teknika e ndërtimit të përdorur ka qënë ndërtimi me qerpiç dhe përforcohet me breza druri, ku si lidhës ka shërbyer balta e punuar. Çatia ndërtohet me tra druri dhe mbi të vendosen tjegullat e lugëta. Streha e çatisë është e dalë përpara për të mbrojtur konstruksionin nga agentet atmosferik.

Panoramë e rrugës “Elbasanit”



Fotografoi: G. Struga



Studim *Vila e familjes Karajani*





Para viteve '40, toka ishte në pronësi të familjes Lita, të cilët ia shiten atë familjes Karajani. Me porosi të vëllezërve Karajani u caktua arkitekti Anton Lufi të projektonte ndërtesën. Në princip, ndërtimi ngelet katror i pastër, i cili rrethohet me oborr të hapur ndaj rrugës kryesore. Përdorimi i elementeve të ndryshëm dekorativ si dritaret në formë katrore,

ballkoni në formë harku dhe katrore nuk shkaktojnë paqartësi, përkundrazi kombinohen bukur me njëra-tjetrën. Përdoret si rifiniturë guri, tulla e kuqe dhe hekuri, modernë për atë kohë. Gjithashtu, fryma moderne shikohet edhe në çarjet apo hapësirat e mëdha të dritës.




Në këtë fakt ndikon edhe përdorimi i materialeve dhe teknikave bashkëkohore, si ndërtimi me skelet betoni, me mbushje me tullë dhe laç. Ndërsa si mbulesë kemi sërish përdorimin e çatisë, e dalueshme edhe në foto. Në këtë rast nuk kemi strehë me trarë druri, por prej kallamash druri, të cilat mbuloohen me suva. Vila ka pësuar ndryshime në planimetri, duke iu përshtatur kalimit të kohës, mirëpo ka ruajtur me dinjitet stoicitetin e dhënë nga arkitekti. Vlen për t'u përmendur afërsia e saj me rrugën krye-

sore si dhe kufizimi i oborrit me mur tulle dhe hekur të rrahur. Është interesante se, ndërtesa nuk krijon një izolim ndaj rrugës, përkundrazi është e hapur ndaj saj duke njëtrajtësuar privaten me publikën. Gjatë viteve të fundit ajo është shndërruar në hostel, me një kapacitet prej 23 shtretërisht dhe ambiente shërbimi të përbashkëta. Sigurisht që në dispozicion të pushuesve është vënë edhe oborri i pasëm, i mbjellë me drurë të shumëllojshëm frutorë.



Studim Vila e familjes Bilbili




Planimetri e katit përdhe / Skicoi: D. Shamolli

Kjo ndërtesë është në pronësi të familjes Bilbili dhe është ndërtuar rreth viteve 1939. Ai që shihet lehtësisht është transformimi që ka pësuar kjo banesë. Arsyeja kryesore e këtij fenomeni, të cilin e shohim pothuajse në të gjitha vilat e kësaj zone, është rritja e familjes dhe ndarja e pronësisë në pjesë, duke copëtuar vilën që ka sjellë edhe ndryshimin e identitetit të vilës. Vila është ndërtuar në periudhën kur Tirana dhe gjithë Shqipëria ndodhej nën pushtimin italian. Si pasojë e këtij pushtimi pati edhe importim të arkitekturës moderne, e cila zbatohet në Itali. Ky zbatim ka kuptim edhe për këtë vilë, e cila mbart shumë detaje dhe teknika të tij. Në foto paraqitet planimetria e katit të parë teknik, në të cilin dallohet

korridori, nga ku kanë hyrjen tre dhomat. Ndarjet e dhomave nga vitet 1939 e deri sot kanë ndryshuar. Shtesat që ka pësuar janë edhe daljet e ballkonit. Vlen për t'u përmendur rrethimi i vilës nga të katër anët me oborr, i cili nuk i ka rezistuar edhe ky ndryshimit të viteve. Drurët frutore dhe lulet me aromë janë zëvendësuar me dyqane, të cilat janë të dhëna me qera. Në foton e tretë është vizatuar detaji i fasadës perëndimore, ku dallohet dritarja e thjeshtë dhe pa dekorime, me grile druri. Çatia është tip e vendit me tjegulla të kuqe, ku bëhet dalja e oxhakut mbi çati me linja të drejta. Streha e çatisë zbukurohet me kornizë të dhëmbëzuar dhe të lakuar. Dalja jashtë e kornizës bën të dominojnë linjat e drejta horizontale.

Studim Vila e familjes Kullolli



Viti i ndërtimit të kësaj ndërtese është 1939. Banesa është dykatëshe dhe ngrihet në një terren të sheshtë. Stili me të cilin është ndërtuar është i varfër, pa shumë ornamente dhe krejtësisht i lehtësuar nga detajet e tepërta. Të vetmet zbukurime që realizohen janë në pjesën e dritares, e cila kornizohet me një kornizë me formë të drejtë. Gjithashtu, edhe dalja e ballkonit, i cili rrethohet me hekur në formë tubi. Tjetër detaj është streha e çatisë që nuk del shumë konsol, ndërsa

çatia realizohet me çati vendi. Për sa i përket planimetrisë ajo është po aq e thjeshtë, sa dhe dekori, ku në thelb ka një korridor të gjatë, i cili lidh të katërta dhomat si dhe dy hyrjet, një lindore dhe tjetra veriore. Në këtë banesë është ruajtur oborri i madh, i cili rrethon ndërtesën. Edhe pse në gjendje të pamirëmbajtur dhe të mjerueshme, ndjesia që përjetohet në të është mjaft e këndshme.

Planimetri e katit përdhe / Skicoi: A. Lushi



Studim Vila e familjes Hasani



Është vilë dy katëshe dhe një pjesë nëntokë ndërtuar në vitet 1933-1936. Teknika e ndërtimit: sistem tra-kolonë e realizuar me tullë. Vila ka një trajtim modern, kjo dallohet edhe në konturet e dritareve, të cilat vërehen në çdo dritare. Interesant është trajtimi i dritareve të cepit me kontur të vazhdueshëm në dy

fasadat. Dritareve i vendosen grila të tipit venecian. Gjithashtu, ajo që shihet në fasadë është trajtimi me dy suva të ndryshme të katit përdhe. Vila ka qënë pronë e një gjenerali austriak, por 30 vitet e fundit vila është në pronësinë e familjës Hasani. Ajo ka pësuar modifikime të shumta.

Studim Vila e familjes Vishka



Banesa është njëkatshe e ngritur nga toka. Në fazat e para vila paraqet një banesë të rrethuar me oborr. Më pas për shkak të arsyeve ekonomike pronari i vilës ka shitur njëren pjesë të vilës. Sot në të jetojnë dy familje të ndara, të cilat i bashkon vetëm një faqe e përbashkët muri.

Studim Vila e familjes Dodbiba



Është ndërtuar në vitet 1939-1940 dhe i përket familjes Dodbiba. Vila flimisht ishte pronë e familjes Lita dhe më pas është blerë nga familja Dodbiba.

Vila mendohet të jetë ndërtuar me arkitekt italianë me porosi nga pronari. Në fillim ka shërbyer si shtëpi pritje, më pas ka marrë funksionin e ambasadës Zvicëriane.

Studim Vila e familjes Stefani



Vila mendohet të jetë realizim i viteve 1940. Volumi i vilës është trajtuar në forma të thjeshta. Vila është dy katëshe e trajtuar me çati. Fasada pothuajse, trajtohen në mënyrë të njëjtë. Çarjet janë të njëjta,

me kornizë dhe grila jeshile. Në katin përdhe hyrja bëhet me anë të disa shkallëve.

Në katin e parë dallohet një ballkon, që thyen linjat e drejta duke përdorur linja të rrumbullakta.

Vila përreth ka oborr dhe trajtohet me mure të lartë që kalojnë lartësinë e një kati. Trajtimi i hapësirave të dritës është i njëjtë. Dritaret janë të thjeshta dhe konturohen nga një kornizë jeshile.

Studim *Vila e familjes Tabaku*





Studim Vila e familjes Pasha



Vila është ndërtuar në 1938. Fillimisht toka ishte pronë e familjes Lita dhe më pas është blerë nga Abdyl Cupi. Vila është blerë dhe noterizuar në vitin 1937 dhe punimet kanë përfunduar në vitin 1938. Është e stilit të mirëfilltë modern.

Vila në rrugën “Budi“



Vila të braktisura




ZONA 13

Universiteti POLIS

Përpunoi: Dea Buza, Anduena Dragovi, Anilda Pulebri, Emel Peterci, Erida Hoxha, Gerdi Papa
Punuan: Adri Hafizi, Amanda Meço, Anilda Puleri, Anisa Spabiu, Erida Hoxha, Enia Salinllari, Eliana Zenaj, Figali Dardhaj, Florian Hysi, Gerdi Papa, Greta Disba, Gidian Haderaj, Gjergji Dushniku, Ina Musai, Iris Hyka, Juxhin Balliu, Joleza Koka, Jonian Remaçka, Klaudio Cari, Klesta Koçi, Lorin Çekrezi, Lisiëna Dimo, Lorenc Drita, Mamica Burda, Manuela Gjoka, Olesia Lami, Qëndrim Gashi, Renisa Muka, Sonila Brahollari, Sindi Toka, Tomorr Menzlexhiu,



Zona 13



Pozicionimi i zonës në raport me qytetin /Punoi: G. Struga

Karakteristikat e Zonës

Vendosja e aksit të shtërt Veri-Jug nga Brasini duket se e theksoi më tej diferencimin midis vendosjes spontane popullore në pjesën lindore të kryeqytetit të ri me pjesën tjetër jug-perëndimore të saj. Ndikimi i arkitekturës italiane në periudhën midis dy luftërave Botërore do të përforcohet me realizimin e projekteve të G. Bossios. Dora racionale italiane me parcela të mirëpërcaktuara nëpërmjet akseve përpendikulare

gjeti zbatim në planin urbanistik të kësaj zone të re të Tiranës.

Vilat e kësaj zone janë ndërtuar nga nevoja për strehim e oficerëve të ushtrisë italiane si dhe nëpunësve qeveritar. Planimetritë e këtyre vilave, në përgjithësi kanë trajta drejtkëndore, në formë U apo L. Pavarësisht risive, u ruajtën tipare të traditës të trashëguara ndër breza, por u bënë përpjekje për përshtatjen ndaj kushteve të reja shoqërore e ekonomike,

Vendndodhja e vilave

duke përdorur materiale të reja ndërtimi dhe shfrytëzuar me efikasitet tokën për zgjidhje më të mira planimetricke, duke trajtuar më thjeshtë interierin dhe eksterierin. Dallohen përmasat në përgjithësi simetrike, akset e hyrjeve dhe hapjet ndaj rrugëve. Ma-

terialet e përdorura qenë beton-arme, që mundësoi konceptimin e mjediseve me hapësira më të mëdha drite, ndërthurje me traditat e artit dhe teknikave ndërtuese të kultivuara ndër vite.






Sistemi rrugor hipodamik



Gjelbërimi



Parcelizimi i hapsirës



Pozicionimi i vilave



Lidhja e zonës me pjesën tjetër të Tiranës

Studim Vila nr. 3







Kjo ndërtesë është e vendosur në rrugën “Ibrahim Rugova”, me hyrje kryesore në zonën e ish- Bllokut, përgjatë vazhdimit të urës së re të Lanës, pranë parkut Rinia. Gjatë asaj periudhe ishte planifikuar që Tirana të kishte në një pjesë të saj, qytetin kopësht, i cili ishte ideuar me parcela drejtëkëndore për vila banimi dhe ishte pozicionuar ekzaktësisht në pjesën që sot quhet zona e “Bllokut”. E rrethuar nga gjelbërimi dhe pemët e larta, kjo godinë nuk është ekspozuar aq shumë ndaj gjithë terrenit përreth. Për më tepër fasada e saj gri, e një stili tepër të thjeshtë që e karakterizon, nuk ka lënë shumë mundësi që ajo të jetë e dallueshme. Ngjyra gri, e cila përshkon gjithë fasadën lejon të lexohen qartë linjat e holla të përdorura, si friza me të njëjtin motiv. Ky lloj konturi fragmenton gjithë vilën horizontalisht duke bërë më të lexueshme dy katet e saj nga jashtë. I njëjti motiv elegant përdoret në kornizën e dritareve, të çatisë dhe në xokolin e vilës. E gjithë kjo kornizë ndërpritet aty, ku fillojnë dritaret, dera, ballkoni, friza tjetër, etj. Thjeshtësia e kësaj vepre flet qartë për një lloj evolucimi dhe emancipimi arkitektonik të asaj kohe, që ka lënë gjurmët e veta edhe në vendin tonë. Godina lexohet si një volum i tëri, por që brenda këtij volumi dallohet edhe lëvizja e atyre volumeve më të vogla. Në fasadën kryesore që shikon nga rruga, dallohen menjëherë shkallët, të cilat i japin pompozitet hyrjes për në godinë. Korimanot e shkallës janë dhe ato të përshkura nga një motiv tjetër, por me forma të vogla gjeometrike, duke krijuar një stil totalisht të veçantë. Ky motiv vazhdon edhe në parapetin e llozhës së parahyrjes. Këtu dallojmë një kolonë, e cila është pjesë e të njëjtës zbukurimore të thjeshtë. Kapiteli i saj minimalist formohet nga i njëjti motiv i frizës, e cila është në ngjyrë të bardhë. Dera kryesore dy kanatëshe është e futur në një kornizë. Edhe në katin e sipërm llozha ka qenë e njëjtë (momentalisht është e mbyllur me një faqe muri dhe dy dritare). Ajo që bie në sy në fasadën e godinës është ngritja nga toka e katit përdhe duke lejuar të duken dritaret e bodrumit. Këto dritare janë të mbuluara me kangjella, motivi i hekurave të tyre (hekur i rrahur) është i njëjti i përdorur edhe në godina të tjera të stilit italian (Banka e Shqipërisë). Në dy katet e godinës dallohet një




lloj ritmi vertikal që përdoret për të ruajtur njëtrajtshmërinë e fasadës. Llozhat janë të vendosura në të njëjtin pozicion në fasadë duke ndjekur njëra-tjetrën në lartësi, edhe dritaret vijnë një mbi një. Dritaret e bordrumit janë të vendosura në mënyrë simetrike duke iu referuar shkallëve të hyrjes. Fasada lindore, e cila ndodhet në anën e pasme të godinës, ka një ballkon në katin e sipërm, i cili vazhdon deri aty, ku fillon dritarja vertikale. Parapeti i këtij ballkoni ka të njëjtin motiv zbukurimor me atë të parapetit të fasadës balllore. Dritarja që ndërpret ballkonin ka lartësi më të madhe se dritaret e zakonshme, ajo shërben për t'i dhënë dritë shkallëve të brendshme. Në këtë fasadë



Planimetri e katit përdhe



Planimetri e katit parë



Plani i çatisë

vërejmë se ritmi nuk ndiqet në mënyrë aq fanatike, sa në fasadat e tjera, ka një thyerje më të madhe me dritare të ndryshme dhe ballkonin vetëm në njërën anë. Në fasadën veriore ruhet i njëjti konfigurim me atë të fasadës jugore. Ajo që bie në sy në dizenjimin e formës së dritares është madhësia dhe lartësia që ka. Ato bëjnë të mundur depërtimin e madh të dritës, por përveç kësaj kuptohet edhe një detaj i psikologjisë së kësaj arkitekture, e cila ka dashur ta bëjë shtëpinë e banimit më transparente në një periudhë historike. Momentalisht vila ka pësuar ndryshime, janë shtuar ambiente dhe ka ndërhyrje të dukshme në planimetri dhe brendshme. Ajo ç'ka pronarët aktual kishin

ruajtur nga vila origjinale ishin vetëm disa dyer, shkallët e drunjtja dhe ndonjë motiv i brendshëm i kornizave të dritareve. Planimetria e vilës tregon gjithashtu, për evoluimin e konceptit të banesës. Në korridor janë shkallët që të ngjisin në katin e sipërm. Ato janë me parapet druri, punuar me dekor të thjeshtë modern, harmonizuar me të gjithë dekorin e godinës. Në të dyja anët e shkallëve janë dy dhoma të mëdha, përkatësisht kuzhina dhe dhoma e ndenjjes. Në dhomën e ndenjjes gjendet një oxhak, i cili duket në çati. Edhe në katin e sipërm vazhdon i njëjti plan. Në krah të djathtë të shkallëve është një banjo, më pas janë dhomat e fjetjes. E veçantë në këtë

planimetri është se kuzhina ndahet nga dhoma e ditës. Kjo vilë dhe të gjitha vilat e ndërtuara në këtë periudhë kanë rëndësi të veçantë për historinë e arkitekturës. Duke zbritur poshtë, ka një dalje të pasme në të djathtë të shkallëve, e cila del në oborr. Oborri është organizuar përsëri thjeshtë. Shtëpia rrethohet nga një trotuar, i veshur me pllaka tipike të kohës, me motiv klasik gjeometrik italian. Pjesa tjetër është e mbjellë me bar dhe pemë. Në pjesën perëndimore, ku oborri ndahet me rrugët ka mur rrethues, mbi të cilin ngrihet një kangjellatë me të njëjtin motiv si ai i ballkonit.

Studim Vila nr. 5






Skicë me akuaarel

Vila ndodhet në zonën e ish Blokut, në rrugën “Brigata 8”. Ndodhet pranë qendrës dhe një sërë ndërtesash me funksione të ndryshme tregtare, institucionale etj. Në afërsi të saj gjendet kulla “Sky Tower”. Shumë pranë kalon dhe një nga akset më të rëndësishëm të lëvizjes në Tiranë. Kjo vilë është me dy kate me bodrum. Ka gjashtë shkallë në hyrje të saj të trajtuar me dekorime bimore. Lëvizja bëhet me anë të një shkalle të brendshme. Arsyeja fillestare për të cilën ajo është ndërtuar është ajo e banimit. Gjithashtu, vlen të përmendet ekzistenca e një objekti jashtë ambienteve të shtëpisë, i cili përdoret në shërbim të ambienteve të tjera. Ajo funksiononte si zonë shërbimesh apo vendosjen e kaldajave që shërbenin për ngrohjen e shtëpisë. Ngrohja në shtëpi bëhej nëpërmjet oxhaqeve të veçantë në ambiente të ndryshme të shtëpisë. Vila është me mures mbajtëse. Bodrumi ngrihet mbi nivelin e tokës, që bën të mundur ven-



Parmak shkalle


tilimin dhe ndriçimin e tij. Fasada përbëhet nga dritare të vendosura pranë njëra-tjetrës me strukturë druri. Dera kryesore e hyrjes për në vilë është prej druri e pandryshuar dhe mund të themi që është një hyrje madhështore me korridor të madh dhe të lartë. Përsa i përket veshjes së dyshemesë janë përdorur pllaka vendi të vogla dhe të thjeshta. Oborri është në përgjithësi me gjelbërim të lartë dhe pa sistemim të caktuar, rrethon shtëpinë në tri anë. Kjo jep mundësi që në të ardhmen të krijohen ambiente të bukura nën qiell të hapur pasi vetë sipërfaqja e mundëson një gjë të tillë. Një kujdes i veçantë është treguar për fasadën e ndërtesës, e cila është trajtuar me sipërfaqe dhe me materiale të ndryshme. Kjo e bën atë të ruajë bukuri të veçantë edhe pse e lënë pas dorë. Gjithashtu, dritarja është e stilizuar me kornizë mermeri.



Planimetri e bodrumit



Planimetri e katit përdhe



Planimetri e katit parë



Skicë e vilës



Shkallë të jashtme




Derë e jashtme


Studim Vila nr. 10




Fotografoi: D. Shamolli



Planimetri e bodrumit



Planimetri e katit përdhe



Planimetri e katit parë

Vila në studim ndodhet në rrugën “Ibrahim Rugova”, e rrethuar nga vila të tjera të së njëjtës ide në zonën e Tiranës së re, e cila ishte paramenduar nga arkitektët italianë si “Qyteti Kopësht” i ardhshëm me një sistem rrugor kuadratik me parcela të dallueshme njëra nga tjetra, kopshte apo oborre të mëdha mbi bazën e koncepteve dhe frymës së kohës. Arkitekti Qemal Butka i vilës marrë në studim, pronë e Lame Karecos (ish ministër i Financave), është njëri prej arkitektëve më në zë e të talentuar të kohës. Kemi të bëjmë me një natyrë poliedrike, një arkitekt, inxhinier, krijues grafik i filatelisë së kohës e për më tepër (ashtu si thuhet në monografinë e tij prej Emin Rizës) një “prozator i humbur” me gjuhën e tij dinamike, sintaksë vetjake, që karakterizohet nga adhe-taria, vetëbesimi, intelijenca, këmbëngulja në rrugën e tij të vështirë, interesante, të çuditshme e eklektike. Përvetësimi i elementëve më të mirë të traditës shqiptare, e më së shumti shkollimi dhe formimi në Perëndim (Austri) i dha arkitekturës dhe kulturës shqiptare një nga figurat më të vlefshme për

kohën e breza të tërë dhe arkitekturës shqiptare baza të mira moderne.


Vila e Lame Karecos zë një parcelë, një pozicion të kënaqshëm, me distance prej 13 e 8 m nga rrugët. Sipërfaqja e parces është 200 m². Ajo zhvillohet në katin e nëndheshëm, ku ndodhet bodrumi e dy të tjerë të trajtuar mjeshtërisht. Fasada lindore, nga rruga kryesore, paraqet një karakter lakonik, por harmonik me elementë rreptësisht të thjeshtë që kanë prapa medoemos një funksion arkitektonik, duke braktisur dekorimet sunduese deri në dhjetëvjeçarin e paraardhës. Elementët si dyer, dritare apo kolona mbajtëse kanë trajtimin e tyre original në kate apo anë të ndryshme të së njëjtës fasadë duke shmangur kështu edhe më të voglin dyshim për simetri, por duke ruajtur një unitet e bashkëjetesë të natyrshme. Përballë në katin e parë vërehet një verandë e zhveshur nga teprimet që i jep volumetrisë së kësaj vile gjallëri dhe jetë në një lojë gjithësi që anon nga përbushja e funksioneve jetësore. Hyrja kryesore është e dallueshme për shkak të një ngritjeje të lehtë




Planimetri e bodrumit / Skicoi: Mamica Burda




Planimetri e bodrumit / Skicoi: Mamica Burda




Prerje



Pamje 1



Pamje 2



Pamje 3

me 5 shkallë gjysmë rrethore nga njëra anë, që është një trajtë e këndshme e pa monumentalitet. Madje një trajtim i ngjashëm vazhdon edhe në derën e sipërme të një ballkoni, që thekson ndarjen e kateve përgjatë gjithë ndërtesës me ballinën e verandës.

Një verandë tjetër majtas jep idenë e kësaj lëvizje të formëzimit volumetrik e dritë-sjellës që dikton këtë theksim kënddrejtë të masave të vilës. Çdo element lidhet me të tjerë pa ndërhyrje të panevojshme. Çdo element justifikon vetveten. Fasada jugore C-D paraqet këtë spostim interesant e të thjeshtë të planeve përpara e prapa duke përdorur të njëjtën gjuhë, por duke treguar edhe ecjen në fasadën pasardhëse, me anë të dritareve të zgjatura në të djathtë të fasadës.

Në cep dallohen shkallët hyrëse që vazhdojnë në mënyrë elegante me kolonën e copëzuar dhe i jep mbështetje ballkonit që ka një paralel të tijin në fasadën jugore. Pra, fasadat kanë korrespondenca trajtimi. E veçanta e kësaj pamje është ballkoni gjysmërrerthor, si një thyerje interesante e këndëve të drejta. Fasada veriore ka thjeshtësi më të spikatur, për shkak edhe të vendndodhjes së saj, por me dritare të një tjetër karakteri dhe element të dukshëm të bodrumit. Kolonat e verandës pasohen nga një tjetër pilaster i së njëjtës natyrë, që krijon lëvizje detajesh vetëm në katin e parë. Përsa u përket planimetrive lexojmë në to përpjekjen për të dalë jashtë skemave të simetrive imponuese.



Materialet e ndërtimit të përdorura janë beton armeja, granili i derdhur, druri e hekuri i rrahur me motive të thjeshta lineare e të harkuara si përgjigje e gjuhës arkitektonike në vilë. Edhe sot, pavarësisht ndryshimit të destinaconit të vilës dhe ndërhyrjeve, parketi, pllakat origjinale prej granili shumëngjyresh e me motive, dyert prej druri dhe parmakët ruhen ende. Parmakët me hekur të rrahur kanë motive të thjeshta, me lojra të këndit të drejtë e elementëve diagonale, ndërsa muret përgjatë shkallëve vishen me elementë mermeri të kuq. Shpesh ndeshen veshje të mureve me listela druri. Tashmë karakteri i katit të parë është transformuar gati tërësisht, duke krijuar konflikt me të dytin, i cili ruan origjinalitetin e kohës kur është krijuar.

Studim Vila nr. 11, rruga “Ismail Qemali”





Vila në studim pozicionohet në pjesën jug-lindore të Tiranës. Ky pozicion ka qënë i favorshëm si në kohën kur u ndërtua edhe sot. Kjo zonë ka qënë e populluar nga vila rezidenciale dhe kryesisht nga persona me pozitë si udhëheqësi komunist Enver Hoxha. Kjo është arsyeja pse kjo tërësi vilash ishte disi i izoluar nga bota e thjeshtë qoftë për sa i përket distancimit në largësi, qoftë edhe për nivelin ekonomik, si zonë elitare për kohën. Vila në studim është ndërtuar para luftës së dytë botërore. Fillimisht ka qenë vila e një inxhinieri italian (Berlotti) dhe është ndër

të paktat vila të ruajtura, përsa i përket elementëve arkitektonikë. Ajo është vilë trekatëshe me bodrum. Hyrjes për në vilë i paraprin një shkallë mermeri i bardhë dhe një portik, që shërben si verandë. Portiku formohet nga kolona, që vazhdojnë deri nën çati, të përbëra nga pllaka guri. Në fasadën hyrëse janë katër të tilla. Lidhja midis kolonave bëhet me një element 1 m të lartë me motiv kuadratik. Është e ndarë në tri pjesë, ku pjesa qendrore është më e dalë. Xokolatura është e përbërë prej pllakash dhe gur.

Kati përdhe kishte destinacion të ndryshëm të

Detaje interieri



përbërë prej dhomash, banjosh. Dhomat janë të shtruar me parket me motik “kurriz peshku”. Dyert janë prej druri dhe dritaret, të cilat i karakterizon i njëjti motiv dekorativ si dhe e njëjta tipologji dritare. Ndër dhomat e katit të parë mund të veçohet njëra, që ka shërbyer si studio. E veçanta e saj është se në hyrje të dhomës ka veshje druri, e cila është trajtuar me të njëjtën sipërfaqe me derën. Kasa është prej druri të errët me konture lart e poshtë të njëjtë, të

përbërë nga drejtkëndësha. Sipër saj ndodhet kasa, e cila mban grilën. Poshtë dritareve ndodhet sistemi i ngrohjes. Në të djathtë të shkallëve të katit të dytë ndodhet një korridor, i cili të çon në ballkon. Interesante tek kalon këtë korridor është një oxhak prej mermeri të bardhë, anash me pllaka mermeri jeshile. Kjo ngrihet mbi një bazament guri. Ballkoni ka dys-heme të shtruar me pllaka të bardha dhe vishnje. Duket vazhdimësia e kolonave prej guri të katit të

Detaje eksterieri



parë. Përsëri shkallët që të çojnë në katin e tretë janë prej mermeri dhe parapej druri.

Kjo veshje përfshin dy pllaka druri të vendosura njëra mbi tjetrën si dhe një “xokolature” druri. Druri është i errët dhe i lustruar. Gjithashtu, pjesa e tavanit që i paraprin derës është e shtruar me motive kuadratike druri. Në katin e tretë janë ambiente në trajtë mansardash. Dritaret kanë dalje mbi çati. Shkallët që çojnë në bodrum nuk janë më prej mer-

meri, por prej pllakash guri si dhe veshje tjetër.

Njëra dhomë mbante të gjitha tubacionet dhe lidhjet e tjera. Dritaret janë të vogla dhe drejt-këndëshe. Për depërtimin më të mirë të dritës është menduar që pjesa poshtë dritares të jetë e pjerrët. Dritarja ka dalje në xokolature e paraqitur me një zgavër në formë harku. Dyshemeja ruhet ende, e shtruar me pllaka me motive të ndryshme.

Pamje panoramike rrugës “Ibrahim Rugova”




Fotografoi: D. Shamolli




Studim Vila nr. 16



Fotografoi: G. Struga



Planimetri e katit perdhe



Planimetri e katit pare

Shumë pranë Universitetit të Tiranës, në rrugën “Vaso Pasha” ndodhet vila 19, vilë tipike racionaliste e viteve ‘40. Kjo zonë është e ndërtuar kryesisht me stilin e arkitekturës italiane të pushtimit. Historikisht ajo ka qenë një zonë e preferuar nga banorët e Tiranës, për shkak të pëlhurës urbane me dendësi të vogël, me rrjet rrugor komod, të gjelbëruar si dhe për cilësinë dhe standartin e jetesës. Mikroklima e zonës favorizohet nga prania në afërsi e parkut të madh të Tiranës. Vila nr. 19 është e distancuar rreth 18 m nga rruga dhe është mbuluar prej gjelbërimit të lartë të kopshtit të saj, ndaj nuk perceptohet lehtë prej kalimtarëve të rastit. Kjo ndoshta edhe prej faktit se hyrja e saj kryesore ndodhet në fasadën veriore. Ky objekt është vilë banimi me dy kate dhe bodrum. Mendohet të jetë ndërtuar për akomodimin e ushtarakëve të rëndësishëm italianë në vitin 1939. Vila është konceptuar si një volum gati i rregullt në të cilin vende –vende volume më të vogla hiqen për të

krijuar ballkone dhe veranda. Ai që bën shpërndarjen në kate në pjesën e jashtme është kafazi i shkallëve, i theksuar prej veshjes me tulla dhe lartësisë më të madhe në krahasim me pjesën tjetër të volumit të objektit. Ai merr dritë nga një dritare vertikale në gjatësinë e dy kateve. Fasadat nuk kanë më simetri apo dekore të ndryshme, por kemi tashmë forma të rregullta, me kënde të drejta dhe linja të qarta. Xokolatura, kornizat e dritareve dhe e derës kryesore janë të veshur me mermer të bardhë. Dritaret, si shprehje e formave të arkitekturës moderne janë të thjeshta, të gjata dhe elegante, kjo jo thjesht për anën estetike, por edhe për atë funksionale që ka të bëjë me hyrjen e dritës në ambientet e brendshme. Në fasadën lindore një hyrje e veçantë mbi disa këmbëshkallë të çon vetëm drejt ambientit të shërbimeve, ndërsa jashtë vazhdon me një oborr, i cili ofron një ambient çlodhës. Teksa kalon derën e hyrjes kryesore gjendesh në kafazin e shkallëve, i cili ofron dy mundësi: të





ecësh drejt e të zbresësh poshtë drejt podrumit ose të kthehesh djathtas e të ngjitësh disa shkallë për në katin përdhe. Shkallët janë prej mermeri dhe punuar me kujdes të veçantë estetik, ashtu edhe korimano, e cila është prej druri masiv si dhe dyert që çojnë në ambientet e brendshme.

Korimannot, të cilat janë në anën e dritares së kafazit të shkallës, janë tuba hekuri me formë që ndjek ngjitjen e shkallës. Pasi ngjit dy kate del në tarracë, kjo është dhe arsyeja pse kafazi i shkallëve është më i lartë se pjesa tjetër e objektit. Në tarracë ka oxhaqe si dhe sistem të kullimit të ujërave.

Të gjitha këto tipare racionaliste-funksionaliste nuk mund të mos pasqyrohen në organizimin planimetric. Kjo shfaqet që në hyrje, ku shkalla është njësia qendrore që bën shpërndarjen në ambientet e banimit. Pasi hyn në ambientet e shtëpisë gjendesh në një ambient që të çon në verandë dhe nëse kthehesh majtas të çon në korridorin, i cili në njërin anë ka ambientet e ditës, në anën tjetër ambientet e shërbimeve, ndërsa në fund të korridorit ndodhet tualeti, që rrethohet nga dy anët prej ambienteve të gjumit. Dhomat e ditës komunikojnë me një vetratë xhami, një veçori kjo unike. Përgjatë korridorit, si rezultat i mureve të trashë (50 cm, prej guri shkëmbor ose prej blloqesh betoni) ka pjesë të futura për vendosjen e dollapeve. Shtrimi i dyshemesë bëhet me pllaka në formë gjashtëkëndore, ngjyrë vishnje, të cilat krijojnë një ndjesi të këndshme, sidomos kur drita që vjen prej verandës bie në to. Në katin nëntokë ndodhet bodrumi, i cili ndriçohet nga një dritare që del edhe në fasadë. Ai përbëhet nga disa dhoma me funksione të veçanta për mbajtjen e sendeve të ndryshme dhe për pajisjet elektrike e hidraulike të ndërtesës.

Studim Vila nr. 1






Vila që sot njihet si “Ambasada Ruse” ndodhet në rrugën “Donika Kastrioti”. Rrethohet nga tri anë nga rrugë kryesore, në lindje rruga “Donika Kastrioti”, në veri unaza dhe në perëndim nga rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”. Formës origjinale i është bërë një shtesë në anën perëndimore, por në tërësi është ruajtur forma dhe detajet arkitektonike të projektit origjinal. Edhe fasada veriore, perëndimore dhe ajo jugore janë të thjeshta, ato përbëhen nga dritare të thjeshta të kornizuara.

Studim Vila nr 6



Vila, ku sot ndodhet Banka Botërore së bashku më një seri vilash të tjera që ndodhen në rrugën “Ibrahim Rugova” janë pjesë e një plani të madh për ndërtimin e kësaj zone të Tiranës. Ato punojnë së bashku duke krijuar një ansambël arkitekturor. Vilat janë të një tipologjie afërsisht të njëjtë dhe projektuar nga arkitektë italianë, si shumë vila të ish- Bllokut. Kjo dallohet në mënyrën se si është organizuar planimetria e Bankës Botërore. Në ato vite synohej për një planimetri funksionale. Nga ndarja e ambienteve


vërehet një ndarje e funksioneve, që i përket një shtrese elitare të shoqërisë. Planimetria e katit përdhe përmban vetëm ambientet e ditës, si dhoma e ndenjjes, studio dhe dhoma e ngrënies. Gjithashtu, gjenden dhe ambientet e gatimit, të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me dhomën e shërbimit, që ka dalje të veçantë nga hyrja kryesore. Kjo shpjegon edhe mënyrën e jetesës së porositësve. Dalja e veçantë e dhomës së shërbimit është zgjidhje praktike, që personeli i shërbimit, furnizimet dhe punë të shumta të



Planimetri e katit perdhe



Planimetri e katit pare



Prerje



Pamje



Pamje

mos kryhenin nëpërmjet hyrjes kryesore. Të gjitha ambientet lidhen me njëra-tjetrën dhe hyrjen kryesore duke i dhënë lidhje fluide gjithë hapësirës. Kur ngjitesh në katin e parë dallon sistemimin e të gjitha ambienteve të natës të vendosura në formë L në planimetri me banjo të përbashkët. E veçantë e kësaj vilë është bodrumi, i cili shërbente për të magazinuar drurin dhe produkte të tjera si dhe për lavanderi.

Vila rrethohet nga të katër anët me oborr, i ndarë në funksione të ndryshme duke filluar nga pjesa e hyrjes,

oborri i pasëm i shërbimit. Vila së bashku me shumë të tjerat kanë konceptim jo hermetik, pra projektimi nuk ndalon vetëm tek planimetria në verve, por edhe në lidhjen e saj me ambientin që e rrethon dhe përshatja e gjelbërimit e bën të kuptueshme këtë. Fasadat nuk janë të ndërlikuara, përkundrazi janë të lira, me hapje relativisht të mëdha dhe me dalje në një ballkon në fasadën balllore. Dallohet një ndërturje midis hapjeve të mëdha drejtkëndore me hapjet harkore, që i japin asaj identitetin si vilë e frymës italiane.

Studim Vila nr. 9, rruga “Pjetër Bogdani”



Fotografoi: D. Shamolli






Ndërtesa është vilë dykatëshe, rreth 200 m², me verandë të madhe përpara saj në formë L, që përshkon dy anë të ndërtesës, afërsisht 70-80 m². E vendosur buzë rrugës, ajo rrethohet nga një mur afërsisht 2 m i lartë, i dekoruar me punime hekuri dhe

gjelbërim. Fasadat kanë ruajtur pothuajse të njëjtin dizain. Brenda, ndërtesa ka pësuar ndryshime nga origjinali, duke filluar nga muret të rikonstruara dhe të zbukuruara me një arkitekture moderne të viteve të fundit.

Studim Vila nr. 12





Vila në studim ndodhet në rrugën “Vaso Pasha”. Është vilë banimi, e ndërtuar rreth viteve 1920-1930, periudhë, e cila përkon me stilin modern të arkitekturës. Vila është e projektuar për dy familje, i përket periudhës së kalimit nga arkitektura klasike në atë moderne. Gjenezja e kalimit nga arkitektura klasike në atë moderne ishte kalimi nga puna me dorë në të mekanizuar. Për shkak të vështirësisë së realizimit të ornamenteve me anë të makinerive si edhe faktit që ato nuk ishin të nevojshme, bëri shmangen e ornamenteve, të cilat nuk kishin një funksion dhe u kalua në arkitekturë të pastër. Arkitekti, i cili hodhi hapat e para për këtë kalim ishte austriaku Adolf Loos. Ai kritikonte ashpër çdo lloj ornamenti sipërfaqësor, madje konsideronte krim një gjë të tillë. Kështu, në këtë stil të arkitekturës dominojnë linjat e drejta e të pastra. Në këtë mënyrë arkitektët luajnë me volumet si edhe me çarjet e jashtme. Duke qënë se vila është e projektuar për dy familje dhe ka dy hyrje, në dy anë

të ndryshme, vërehet një planimetri, e cila përsëritet dy herë. Planimetria përsëritet e njëjtë si në hyrjen e parë, ashtu edhe në hyrjen e dytë, por thjeshtë pëson një rrotullim, që i jep një lloj lëvizje planimetrisë, që ajo të mos jetë e ngurtë. Sipërfaqja e vilës shpërndahet në katër kate, tre prej të cilave kanë funksion banimi dhe një kat nëntokësor, i cili shërben si bodrum. Në fasadë ka të vendosura dritare shirit, të cilat ishin karakteristikë e arkitektëve të asaj periudhe. Interesantë paraqiten ballkonet në formë të kurbëzuar. Hyrja në secilin apartament shoqërohet me shkallë dhe në njërin anë të derës së jashtme vendosen dritare në formë rrethore, të cilat mund të konsiderohen si zbukurime, por që kanë funksion. Në interior lidhja midis kateve bëhet me anë të një shkalle të brendshme, e veshur me mermer. Bie në sy hapësira shumë e vogël që zë shkalla në interior si edhe hapësira, ku janë pozicionuar shkallët duket edhe në eksterier, sepse është volum më i dalë se pjesa tjetër e objektit.

Studim Vila nr. 14





Objekti në studim është një vilë dykatëshe me bodrum, që ndodhet në rrugën “Nikolla Tupe”, rreth 50 m larg Fakultetit Juridik dhe Shkencave Sociale, në Tiranë. Ajo është ndërtuar rreth viteve ‘20, në kohën kur një mënyrë të tillë ndërtimi u bë shumë e zakonshme në qytet. Bëhet fjalë për ndërtimet masive të vilave, të lokalizuara në zona të ndryshme të barazlartuara nga qendra e qytetit. Dikur kjo zonë ishte e populluar vetëm nga vila të kësaj tipologjie. Ndërtimet e pallateve të mëvonshme gjatë periudhës së socializmit dhe mbingarkesa e ndërtimeve pas viteve ‘90 bëri që kjo zonë të humbasë tipologjinë e saj dhe vila të lihej në harresë dhe të mos mirëmbahej, ndonëse është ende e banueshme. Sistemi konstruktiv i saj është tipik për periudhën, mure mbajtës me gjysmë bodrum. Orientimi i vilës është nga perëndimi, ku ndodhet hyrja kryesore, gjithashtu ka hyrje tjetër nga jugu. Dritaret e mëdha janë të orientuara nga lindja, ku në katin e parë, për shkak të tendencave të kohës, ka një ndarje tjetër, me hyrje për dhomë të shfrytëzueshme për profesionin, që ushtronte banori i vilës. Bodrumi shtrihet në gjithë sipërfaqen e vilës, është me mure guri 40 cm, pra muret e themelit janë 50 cm, mënyra standarte e ndërtimeve të vilave të kësaj tipologjie. Ai lartësohet 1 m mbi nivelin e tokës dhe xokoli i tij është i veshur me gurë të çrregullt. Dritaret janë të vendosura paralel me ato të katit të

parë, të larta rreth 30 cm. Hyrja ndodhet në pjesën lindore të vilës, së bashku me hyrjen për në dhomën e zejeve. Duhet përmendur fakti se për shkak të armiqësive dhe konflikteve të kohës, zakonisht ndërtesat nuk orientoheshin nga rruga kryesore, në rastin konkret nga rruga “Dora D’Istria”, por në rrugët dytësore, kjo duhet thënë edhe për këtë vilë. Kati përdhe ka ngritje rreth 1 m mbi nivelin e tokës, me dy hyrje. Aksesueshmëria nga këto hyrje është e kufizuar për sipërfaqen e saj dhe ka të njëjtin dekor si fasadat e saj. Vila shërben si urë kalimi midis arkitekturës tradicionale, në Tiranë dhe asaj të periudhës së monarkisë. Ndërsa, dritaret në katin sipër në formë harku kornizat i kanë në formë kryqi, të ngjashme me dritaret drejtkëndore. Për mbajtjen e ujit dhe mbledhjen e shiut, përveç kullueseve, ndodhet një pus me diameter 1 m, në jug të vilës, i cili është ndërtuar me të njëjtin material si ndërtesa dhe ka të njëjtin dekor si fasadat e saj. Në pjesën perëndimore, ku ndodhet hyrja e saj është i lartë rreth 80 cm me kangjella metalike fine. Dera e këtij oborri ndodhet në veriperëndim. Ka rrugën e kalimit rreth 1.5 m deri në hyrje dhe përgjatë vilës, duke ruajtur gjerësinë e urezës. Gjelbërimi është i njëtrajtshëm, me pemë përgjatë perimetrit të parcelës dhe bimësi të ulët në sipërfaqe të saj.




Studim Vila nr. 17




Fotografoi: G. Struga

Vila ka shumë elementë të huazuar nga neoklasicizmi dhe arkitektuara eklektike, ajo u ndërtua në vitin 1931 dhe përfundoi po atë vit, në rrugën “Ibrahim Rugova”, në zonën e quajtur Tirana e Re. Në këtë zonë filluan të ndërtoheshin vila me një arkitekturë të re për periudhën në fjalë. Kjo është një ndër vilat e projektuara me arkitekt (nga italianin G. Marini). Vila u ndërtua për një nga funksionarët më të lartë të mbretërisë, gjeneral Xhemal Araniti, njëkohësisht dhe Ministër i Mbrojtjes i Mbretërisë së Shqipërisë.


Vila u banua nga familja e gjeneral Aranitit deri në fillim të luftës së dytë botërore, 1939. Më pas në periudhën e komunizmit u shtetëzua për të strehuar disa familje. Vila u shemb dhe mbi të u ndërtua godina, ku sot ndodhet Hotel President, i cili në rikonstruktionet e fundit ka imituar elementët arkitektonikë të vilës së mëparshme. Në kompozimin planimetrik vihet re një grupim i qartë funksional, podrimi, kati përdhe: nga grupi i pritjes përbërë nga parahyrja, salloni dhe veranda ose ballkoni.



Planimetri e katit përdhe



Planimetri e katit parë



Plani i taracës

Studim Vila nr. 2, rruga “Donika Kastrioti”



Planimetri

Vila është ndërtuar gjatë viteve 1936 më një stil modern. Numri i kateve është tre. Në fasadën verilindore janë pozicionuar daljet e ndërtesës (ballkonet). Vihet re një trajtim i veçantë në kompozimin e derës së jashtme si dhe në profilin e dritareve.

Studim Vila nr. 4



Kjo është një vilë, e cila ndodhet në fund të rrugës “Donika Kastrioti”. Është një ndërtesë paksa e veçantë, përse i përket kompozimit dhe elementëve të përdorur, në krahasim me vilat e sipër përmendura. Ruan format kuadratike, megjithatë nga vëzhgimi vizual mendohet të ketë një planimetri këndore të rregullt. Stili më i dukshëm është ai neoklasik dhe kjo

vilë ka ruajtur numrin e kateve (tre katëshe). Ka disa elementë të veçantë, të cilët nuk i shoh të përdorura në vilat e tjera. Mund të përmendim trajtimin e dritareve, përveç profilit me kornizë kemi edhe përdorimin e hekurit të rrahur. Dyert, të cilat dalin në ballkon, kanë po të njëjtin trajtim duke i dhënë uniformitet ndërtesës.

Studim Vila nr. 13



Fotografoi: D. Shamolli

Pas rrugës “Vaso Pasha” vijon rruga “Nikolla Tupe“, e cila përmban disa prej vilave më të rëndësishme të Bllokut. Kjo është një vilë e tipit modern e ndërtuar si shumë vila të Bllokut gjatë viteve ‘36- ‘38. Ndërtesë tre katëshe, me sipërfaqe relativisht të madhe dhe element arkitektonik të veçantë, si profilet e dyerve, dritare, parmaku i shkallës me hekur të rrahur.

Studim Vila nr. 18




Fotografoi: G. Struga


Ndodhet në rrugën "Vaso Pasha" dhe është ndër-tuar në vitin 1936. Kjo është një vilë dykatëshe me çati dhe me mur tulle. Dallohet për stilin funksional-ist, ku mungon dekoracioni.


Studim **Vila nr. 15**





Kjo vilë gjendet në kryqëzimin e rrugës “Vaso Pasha” dhe “Perlat Rexhepi” dhe është në pronësi të Martin dhe Mirash Ivanaj. Toka është blerë në vitin 1930 dhe vila u ndërtua në 1936-1937. Martin Ivanaj ishte Kryetar i Kasacionit. Mirash Ivanaj ishte Ministër i Arsimit Publik. Është një vilë dykatëshe dhe ka një sipërfaqe prej 2300 m². Është një shembull i arkitekturës moderne shqiptare. Fotografitë gjatë konstruksionit flasin për materialet e përdorura.






Studim Vila nr. 19



Vila nr. 19, rruga “Pjetër Bogdani”



Interieri



Skicë planimetrie / Skoci: G. Struga

Kjo vilë paraqet një rast të veçantë, ku katër seksioni të njehta janë bashkuar rreth një oborri të brendshëm. Secila familje kishte dy kate, ku në ato përdhe ishin ambientet e ditës dhe në të parin dhomat e gjumit. Banesat kanë bodrum.


Fotografi të vilave



Vila nr. 8 / Fotoqrafoi: D. Shamolli



Vila nr. 7 / Fotoqrafoi: D. Shamolli



Skicë planimetrie / Skoci: G. Struga

Kjo banesë pluri familjare ka patur 5 njësi banimi që posedonin secila tre kate.

Studim Pallatet e aviacionit



Rezidenca Nr.3, rruga "Gjin B. Shpata"



Rezidenca Nr. 1, rruga “Sami Frasheri”



Rezidenca Nr. 2, rruga “Andon Z. Cajupi”

Janë gjithsej dymbëdhjetë objekte të vendosura në mënyrë të rrafshët që formojnë një rrjet kuadratik ndërmjet tyre. Këto ndërtime janë veprimtari e arkitekteve të huaj, shkaku i projektimit (dhe zbatimit) të tyre ishte fakti i krijimit dhe plotësimit të kushteve të pushtuesit. Kështu që, në Tiranë qendra administrative më e rëndësishme në të cilin do të vendoseshin dhe pjesa më e madhe e kolonëve italianë parashikoj ngritjen e këtyre komplekseve të pallateve. Këto apartamente u ndërtuan në zona të gjel-

bërta dhe në pozicione të mira terreni, ku për këto zona dendësia shkon 200 banorë/hektar. Ndërtimi i këtyre apartamenteve ishte lluksoz, për vetë faktin se do të banonin njerëz të klasave të larta shoqërore, si oficerët italianë. Arkitektura e tyre mjaft lakonike ka në bazë konceptet funksionaliste. Këto banesa, ndonëse u ndërtuan sipas koncepteve të rrymës funksionaliste, përbëjnë një shprehje të qartë të diferencimit të theksuar shoqëror. Në secilin pallat ishte parashikuar banimi i jo më shumë se pesë familjeve. Ndërte-



Rezidenca Nr. 4, rruga “Gjin B. Shpata”



Rezidenca Nr. 5, rruga “Gjin B. Shpata”

sat janë trekatëshe dhe në katin e fundit, ndryshe nga të tjerët, vendoset ambient banimi vetëm për një familje. Pallatet kishin oborr të përbashkët, i rrethuar me mur dekorativ dhe brenda mureve ofronte komoditet për personat që banonin në të. Komoditeti në këto objekte duket fare mirë në materialet e përdorura në elementë, si shkallët e jashtme (të cilat janë punuar me mermer travertin).

Për të krijuar ambient të ngrohtë dhe në të njëjtën kohë mikpritës është vendosur një derë të dytë (dys-hemeja ndërmjet këtyre dyerve është trajtuar me mozaik). Fasadat kanë trajtim të ndryshëm në material, ndërsa në vëllime qëndrojnë format gjeometrike të rregullta duke i dhënë ndërtesës formën e një “korpusi”.

Vihet re se, në pjesën e parë të dalë ka një veshje me tullë të kuqe dekorative dhe pjesa tjetër është e lyer me bojë, ky lloj trajtimi bën, njëkohësisht edhe ndarjen vizuale të pjesës qendrore nga pjesa tjetër, duke i dhënë karakteristikat e një ndërtese italiane të kohës. Një element që i karakterizon këto ndërtesa është prania e xokolës, e trajtuar me mermer travertin duke e kornizuar dhe duke i dhënë një bazament të fortë vizual ndërtesës. Dritaret janë të trajtuara me kornizë guri, që bie në kontrast si me tullën e kuqe, ashtu dhe me pjesën tjetër të lyer të fasadës. Kujdes i veçantë i është kushtuar shkallëve, si atyre që i përkasin ambientit të brendshëm, ashtu dhe shkallëve të jashtme.

Vihet re se shkallët e përbashkëta që ka pallati janë



Rezidenca Nr. 6, rruga "Sami Frashëri"




Rezidenca Nr. 7, rruga "Sami Frashëri"

të punuara me gur dhe ka një parvaz të gdhendur dhe të trajtuar mjaft mirë. Shkallët dhe pjesët e tjera të brendshme janë, pothuajse, të njëjta në të gjitha palatet, por mund të ndryshojnë nga ngjyra ose nga motivet e punuara në to, por që kanë të njëjtën logjikë punimi. Në ditët e sotme e kanë humbur funksionin e tyre, tashmë kanë marrë funksione të ndryshme.

Disa prej tyre janë bërë zyra institucionesh, disa të tjera janë lokale duke u tjetërsuar krejtësisht nga pamja. Por, një pjesë e tyre mbeten shumë pak të ndryshuara dhe shpeshherë dhe të dëmtuara ç'ka në to vërehet më mirë originaliteti i tyre dhe kuptohet se sa luksoze kanë qënë ato për kohën.





Studim Pallatet e Xhenios



Rezidenca Nr. 2, rruga "Ismail Qemali" / Fotografoi: A. Lushi



Rezidenca Nr. 4, rruga "Ismail Qemali"



ZONA 14

Universiteti POLIS

Përpunoi: **Ada Lushi**

Punuan: *Ada Lushi, Adelina Ibrahim, Alba Kokomani, Aldin Kurti, Alma Hoti, Amanda Cici, Andi Pistoli, Anisa Hysesani, Atena Gjoka, Berald Zeko, Brikeni Miloti, David Kodheli, Dren Sopaj *Genc Tufi, Blerti Bajo (vila 2), Endrit Zeneli, Stivi Balli (vila 5), Ejola Doci, Ibralind Gjoka, Klaudia Veizaj, Jurgen Pashi, Olti Shabani (vila 10), Felissia Veliu (vila 8) Ada Lushi, Adelina Ibrahim (vila 15, 16, 28, 29)*



Tiranë - Boulevard Mussolini

Zona 14




Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoj: Gerti Struga

Karakteristikat e Zonës

Rruga e “Kavajës” është një nga rrugët më të vjetra të kryeqytetit. Zhvillimin më të madh e pati gjatë viteve 1920-1930. Një ndër planet kryesore për këtë rrugë ka qënë ai i vitit 1928, i arkitektit Kholer. Ky plan përfshinte një sërë ndryshimesh, si ndryshimi i emërimit të “Bulevardi Musolini” dhe e gjithë zona përgjatë këtij aksi do të zhvillohej sipas parcelave

drejtëkëndore, ku do të vendoseshin vilat. Më vonë, me pamjen e tyre me kopshte, vilat do të krijonin edhe të ashtuquajturin “Qytet Kopësht” të Tiranës. Mund të përmendim kafënë Kursal, që ndodhej në krye të rrugës, ku mblidheshin intelektualët e kohës, gjë që tregon për rëndësinë e kësaj trajektoreje në atë kohë.

Vendndodhja e vilave





Vila nr 11, rruga "Hilë Kolli"



Vila nr. 5, rruga “Nikolla Lena” / Fotografoi: A. Lushi



Vila nr 6, rruga “Nikolla Lena” / Fotografoi: D. Kodheli



Vila nr 10, rruga “Hilë Kolli” / Fotografoi: A. Gjoka



Vila nr 12, rruga “Islam Alla” / Fotografoi: D. Sopaj



Vila nr 17, rruga “Hilë Kolli” / Fotografoi: A. Pistoli



Vila nr 14, rruga “Hilë Kolli” / Fotografoi: A. Gjoka



Vila nr 20, rr “Sylejman Pitarka” / Fotografoi: A.Lushi



Vila nr 18, rruga “Hilë Kolli” / Fotografoi: A. Kokomani



Vila nr 22, rruga “Sylejman Pitarka”

Studim Vila nr. 8




Fotografoi: A. Lushi



Fotografoi: F. Veliu



Fotografoi: F. Veliu




Vend për skulpturë / Skicoi: A. Ibrahim


Kjo vilë ndodhet në anën e djathtë të kishës Katolike. Ajo e një shtëpie dy katëshe, me çati katër ujëse, me pjerrësi nga brenda. Për shkak të afërsisë me kishën, në katin e dytë del konsol për t'i dhënë vilës hapësirë, fenomen që vërehet në qytetin e Beratit. Vila shfaq një pamje eklektike me elementë klasikë dhe neoklasikë. Ajo është ndërtuar gjatë viteve 1930, por arkitekti nuk dihet.




Vila nr 8, rruga “Mujo Ulqinaku” / Fotografia: F. Veliu



Porta e jashtme / Skicoi: D. Sopaj



Dritare / Skicoi: D. Sopaj



Fotografoi: F. Veliu



Fotografoi: F. Veliu

Vila shfaq interes me interiorin e saj. Haset kuadratizim si në parmakët e shkallëve dhe në xhamat e dritareve. Parapeti i shkallëve prej druri është në formë rrjete, ndërsa xhamat janë polikromë dhe gjenden të vendosur pjesë-pjesë kompozuar me një paralele me pikturat e P. Mondrian. Oxhaku ndodhet në hollin e madh dhe është autentik i kohës së ndërtimit të vilës, por i rikonstruktuar. Veshja është realizuar me dru të zi dhe tulla të kuqe. Përdorimi i veshjes së tullës, e ngjashme me terrakotën, shihet si ndikimi i Italisë Fashiste në Arkitekturën Moderne shqiptare, s i mjet për të rievokuar shtrirjen e Perandorisë Romake. Dyshe-meja është me granil të derdhur shumëngjyrësh. Dallohen dy shirita jeshilë paralelë, që vijnë në anë të oxhakut. Tavani i vilës është i veçantë për shkak të përdorjes së tipologjisë së kasetoneve.



Fotografoi: F. Veliu



Fotografoi: F. Veliu



Fotografoi: F. Veliu

Studim Vila nr. 2



Vila gjendet në rrugën e “Kavajës”, pranë kishës Ortodokse. Vila është dy katëshe e ndërtuar në vitet '30. Karakteristikë e kësaj vile janë veshja me tulla dhe përdorimi i harqeve të shumtë. Në fasadën, që sheh nga rruga, harqet janë më të lartë dhe theksojnë hyrjen kryesore. Veçori tjetër e kësaj vile janë detajet e shumta të stilizuara, si parapetet e shkallëve dhe trajtimi i dritareve. Sot, kjo vilë përdoret nga kisha Ortodokse dhe në të janë bërë disa ndryshime. Ndërtimi i pallateve shumë pranë pengon vëzhgimin nga të gjitha anët.



Studim Vila nr. 13, rruga “Islam Alla”



Fotografoi: A. Gjoka



Fotografoi: A. Gjoka

Duke studiuar arkitekturën e vilës mund të thuhet se, i përket arkitekturës Moderne shqiptare, ndikuar nga ajo italiane. Dritaret janë dy kanatëshe me supra-luce. Elementi më spikatës dhe i veçantë që nuk haset në vilat e tjera është ai i vëllimit gjysëm-cilindrik. Për t’u përmendur janë parmakët e shkallëve të jashtme të përpunuara me hekur. Gjithë pjesa e shkallëve të jashtme është e mbuluar me gjelbërim, gjë që tregon për kërkesën e njeriut për të qenë pranë natyrës.



Skicoi: A. Gjoka



Skicoi: A. Gjoka



Fotografoi: A. Gjoka

Studim Vila nr. 10, rruga “Kavajës”



Projekt ide



Detaj pllakash

Kjo vilë e ndërtuar në 1920, ka një sipërfaqe prej 280 m² dhe katër hyrje. Për shkak të afërsisë me kishën Katolike, ka ndryshuar shpesh herë funksionin e saj nga ai i banimit. Megjithatë në arkitekturë nuk ka ndryshuar, duke ruajtur si pamjen, ashtu edhe shumicën e materialeve fillestare të kohës së ndërtimit, si betonin, tullën dhe drurin me të cilat janë dekoruar fasadat. Fasada balllore paraqet më tepër kompleksitet. Ajo që bie në sy është zgjidhja e hyrjes, e cila realizohet përmes një verande me dy kollona tetëkëndore, të cilat mbajnë pjesën e ballkonit në katin e dytë. Vlen për t’u përmendur edhe përpunimi i drurit në interior tek pjesa e shkallëve në formë rrethore, që shërbejnë për t’u ngjitur në katin e dytë si dhe përpunimi me dru i tavanit. Këtu hasen përsëri pllakat në forma gjeometrike.

Studim Vila nr. 24, rruga “Adem Kruja”



Fotografoi: A. Lushi



Fotografoi: A. Lushi

Kjo është një ndër vilat më të vjetra të zonës. Nga informacionet kemi zbuluar se ka shërbyer si shtëpi banimi për ish prefektin e Tiranës, Jonuz Tafli, para se t'i shitej pronarit të sotëm. Ajo ç'ka dallohet në arkitekturën e kësaj vile është elementi i harkut për të evidentuar hyrjen kryesore. Një tjetër element për t'u theksuar është trajtimi i oborrit të vilës. Siç mund të shihet edhe pranë rrugicave anësore është shfytëzuar toka për kultivim të kulturave bujqësore, ndërsa përpara shtëpisë oborri është trajtuar si lulishte. Ky trajtim haset edhe tek vilat e tjera, ku mbjellja e pemëve të ndryshme, si kumbulla, përforcon idenë se banorët e zonës e kanë dashur natyrës duke krijuar një ambient jo thjesht banimi, por edhe një vend që të jep kënaqësi dhe qetësi. Kjo ngjan me shprehjen: "Shtëpia ime, zakoni im".


Studim Vila nr. 5, rruga “Kavajës”




Kjo vilë është ndërtuar rreth viteve 1930 për të shërbyer si banesë për tre familje, me nga një kat banimi secila. Hyrjet realizoheshin në drejtime të ndryshme për katet e ndryshme. Për shembull, familja që jetonte në katin e dytë përdorte hyrjen nga ana e rrugës së “Kavajës”, ndërsa ajo e katit të parë hyrjen e kishte nga ana lindore.



Studim Vila nr. 4, rruga “Mujo Ulqinaku”



Montazhi: D. Kodheli




Montazhi: D. Kodheli




Veçantia e kësaj vile qëndron në rëndësinë e banorëve që kanë banuar në të. Gjatë historikut të saj vila ka pësuar disa ndryshime. Ndër to mund të përmendim shndërimin e shkallëve të brendshme në dhoma dhe shndërimi i ballkonit, që gjendej në katin e dytë, në sheshpushim për shkallët, të cilat u shndërruan në të jashtme. Në vitet e fundit, kjo vilë ka shërbyer edhe si kopësht për fëmijë. Vila gjendet e rrethuar nga vila të tjera edhe e vetmja mu dësi arri-teje është rrugica që formohet nga rrethimet përreth. Sot, vëmendja e njerëzve ka filluar të kthehet nga e

kaluara dhe rivitalizimi i objekteve të ndryshëm. Kjo vilë ka mundësi të ndryshme shfrytëzimi në krahasim me të tjerat pasi në të nuk jetojnë njerëz. Për të realizuar rivitalizimin, jo vetëm të këtij objekti, por edhe të zonës, vila mund të hapet për publikun në formën e një muzeu, ku të shfaqeshin foto dhe filmime historike që kanë lidhje edhe me ish banorët e njohur të godinës. Ose mund të përdoret edhe si qendër vullnetare për të moshuarit, ku të rinjtë mund të kontaktojnë me të moshuarit për nevoja apo ndihmesa të ndryshme.

Vila nr. 14, rruga “Mujo Ulqinaku”



Planimetria e katit përdhe



Planimetria e katit parë



Vila nr. 15, rruga “Hajdar Hidi”



Fotografoi: G. Struga

Vila nr. 16, rruga “Hajdar Hidi”



Ndërtuar në vitin 1931 / Fotoqrafoi: D. Shamolli

Panoramë e rrugës “Ibrahim Rugova”



Vila nr. 28 / Fotografoi: G. Struga



Detaje




Fotografoi: A. Lushi




Fotografoi: A. Lushi




Fotografoi: A. Lushi



Skicë planimetrike /Punoi: A.Hoti




Skicë planimetrike /Punoi: A.Hoti




Skicë planimetrike /Punoi: A.Hoti

Siç mund të shohim planimetritë e vilave në përgjithësi kanë të njëjtën zgjidhje të organizimit hapësinor, ku nga korridori bëhet shpërhapja e dhomave. Kjo flet edhe për shijet e njëjta të shtresës borgjese, që jetonin në këtë zonë si dhe në mënyrën se si bashkëvepronin me hapësirat kishin ngjashmëri.


Detaje



Punoj: A. Gjoka



Punoj: A. Gjoka



Punoj: A. Gjoka



Detaje dekori



Fotografoi: A. Ibrahim

Elementët nga mund të dallohen përpjekjet për të afirmuar Arkitekturën Moderne Shqiptare janë dekorimet, rozetat e stilizuara, dyert, dekorimet e dyshemeve, elementet e oxhakëve, etj. Vihen re përdorimet e pllakave me dekorime të gjometrizuara të shoqëruara me përdorimin e granitit. Grilat e dritareve punojnë me anë të një mekanizmi me rul, i cili vihet në lëvizje nga bastuni, ndërsa kafazi i grilave

gjendet në një kasë druri në brendësi. Dritaret, më së shumti, hasen me dy dhe tre kanate, ku haset edhe elementi i sopraluces në shumë prej tyre. Në disa nga vilat haset elementi i brugnato-s, gur i gdhendur që vendoset në qoshet e ndërtesave për të theksuar karakterin mbajtes të tyre. Në këtë zonë hasen dekorime të tipit klasik poshtë mbulesës së çatisë, që të kujtojnë frontonet e tempujve greke.


Detaje dekori



Fotografoi: A. Lushi




Fotografoi: A. Lushi



Fotografoi: A. Kokomani

Përmbledhje



Banka e Shqipërisë



Pamje panoramike 2011

Vilat që nisën të ndërtoheshin në këtë periudhë në “Bulevardin Musolini” ishin shumica të punuara sipas planeve italiane. Lartësia më e madhe që mund të arrinin ishte dykatëshe.

Sot, vilat që kanë mbetur krijojnë ishuj të vegjël, që rrethohen nga ndërtimet e larta shumëkatëshe, të cilat zotërojnë pamjen. Zona që studiam është e njohur për numrin e madh të vilave qytetare tiranase. Megjithatë, me kalimin e kohës ky numër është pakësuar. Vilat që i kanë mbijetuar ndërtimit të pallatëve të reja shumëkatëshe, janë jo vetëm trashëgimi historike, por edhe arkitektonike, si dokumentim i aftësive të arkitektëve modernë shqiptarë.



Rruga e Kavajës rreth viteve 1930



Sheshi Skenderbe & kafeja Kursal rreth viteve 1930

ZONA 15

Universiteti POLIS

Përpunoi: Ada Lushi, Drilon Shamolli, Gerti Struga

Punuan: Ana Shurdha, Arnisa Jahaj (vila 8), Orion Vesho (vila 3), Eges Madhi, Florian Hysi (vila15), Etrizena Ferraj, Arlinda Dulaj, Ada Lushi, Adelina Ibrahimimi (vila 1,2,3,4,5,6,12,13,14 & 18), Ada Lushi, Drilon Shamolli, Gerti Struga (nga vila 19 deri në vilën 36)



Zona 15



Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoit: G. Sruga

Karakteristikat e Zonës

Zona 15 gjendet ndërmjet rrugës së “Durrësit” dhe asaj të “Kavajës”. Kjo situatë territoriale përcakton edhe kohën në të cilën mori zhvillim zona. Edhe pse rruga e “Durrësit” dhe ajo e “Kavajës” janë ndër rrugët më të vjetra të qytetit, ato nuk paraqitën zhvillim të madh urban deri në fundin e viteve 1920, periudhë kur ndodhën ndryshime në zonë, si drejtimi i rrugës

së “Durrësit” dhe planet e ndryshme për rrugën e “Kavajës”, kjo edhe për shkak të vendodhjes së varrezave në këtë pjesë të qytetit. Në këtë periudhë, në zonë filluan të ndërtoheshin vila të shumta qytetare të bëra nga arkitektë moderne shqiptarë, të cilët për shkak të rrethanave historike ishin të ndikuar nga arkitektura perandorake italiane.

Vendndodhja e vilave



Studim Vila nr. 8

Gjendet buzë rrugës së “Kavajës”. Në ndryshim nga ndërtesat e tjera përreth nuk e ka hyrjen nga rruga, por nga lindja, gjë që favorizon diellëzimin. Vila ka qënë pronë e doktor Osman Jonuzit, me origjinë nga Durrësi. Vila filloi të ndërtohej në vitin 1928 nga Osman Jonuzi. Kjo godinë përveç banimit do të kishte edhe një dhomë që do të shërbente si klinikë për doktorin. Në vitin 1947 vila u konsiderua pronë e shtetit dhe u përdor si ambulancë, ndërsa më pas shërbeu si banesë për ish prefektin Abedin Nepravishtën, sepse i dhuroi tokën për ndërtim Osman Jonuzit. Arkitektura e kësaj vile i përket asaj neoklasike. E para gjë që bie në sy janë shkallët e mermerit me balustra. Gjithashtu, hasen edhe pilasta me kanelura zbukuruese si dhe dritaret tre kanatëshe me grila persiane. Dera kryesore është me dru dhe xham me hekur të rrahur, zbukuruar me motive gjeometrike e floreale. Në këtë vilë haset edhe elementi i frizës, i përdorur në pjesën e kontaktit me çatinë dhe është e orderit jonik, me dentikula të shumta që dalin në kornizat sipër parapetit. Në interior shkallët kryesore janë të punuara në dru dhe kanë formë elikoidale. Parapeti është i punuar me të njëjtët elementë gjeometrikë si dera kryesore. Dhoma, që shërbente si klinikë gjendet në katin përdhe, ku ndodhen sallloni, dy dhoma të tjera dhe banjoja.





Detaje



Shkallë të brëndshme druri



Detaj çatisë



Dritare me grila persiane



Detaj ballkoni



Derë e brëndshme druri me xham akulli në pjesën e poshtme dhe xham të thjeshtë në pjesën e sipërme

Panoramë e rrugës së “Kavajës”



Panoramë e rrugës së “Kavajës”, Vila nr. 17, Vila nr. 16, Vila nr 15, Vila nr. 10 / Fotografoi: G. Struga



Studim Vila nr. 10



Vila gjendet në kryqëzimin e rrugës së “Kavajës” me rrugën “Kont Urani”. Ajo është ndërtuar në vitin 1936 nga arkitekti italian Armando Brazini. Projektet fillestare parashikonin një vilë katërkatëshe, ku kryqëzoheshin funksioni i banimit dhe hotelit. Kjo gjë nuk u realizua për shkak të një konflikti me xhaminë për tokën. Vila ka arkitekturë italiane. Ajo u ndërtua me tulla të kuqe dhe paraqet thjeshtësi në eksterierin e saj, me dritaret në

formë drejtkëndeshi pa korniza rreth tyre. Në interior gjërat ndryshojnë. Zgjidhja arkitekturore bëhet më komplekse dhe kemi alternimin e harkut me format e rregullta gjeometrike. Skema planimetricke është simetrike kundrejt sallonit qendror dhe verandës. Në katin përdhe zhvillohet qendrimi dhe shërbimi, ndërsa në katin e parë fjetja. Në këtë rast të vilave qytetare tiranase kemi hasur edhe marrëdhënie të veçantë ndërmjet

arkitektit e investitorit. Abedin Nepravishta, që në ato kohë ishte prefekti i Tiranës, krijoi marrëdhënie të ngushtë shoqërore me arkitektin italian Brazini, i cili realizoi planin rregullues të qytetit. Kjo vilë tregon pikërisht marrëdhënien që ekzistonte ndërmjet këtyre dy personaliteteve duke supozuar që ka qënë ai dhe autori i veprës. Vila e tij në vitin 1945 dhe u përdor si kopësht deri me 1992, vit kur iu kthye pronarëve fillestarë.



Fotografoi: D. Shamolli




Fotografi nga ana perëndimore




Parapet & Dysheme me
çimento të derdhur



Planimetri dhe pamje



Planimetria e bodrumit



Pamje



Planimetria e katit përdhe



Planimetria e katit parë

Studim Vila nr. 15





Pas luftës së dytë botërore.

Kjo vilë gjendet në rrugën “Kont Urani”, e cila lidh rrugën e “Kavajës” me rrugën e “Durrësit”. Godina u ndërtua në vitin 1938 nga famija e pasur tiranase Kollçiu, me idenë për të jetuar dy vëllezër me familjet e tyre, gjë që vihet re në simetrinë e vilës. Megjithatë, vila u sekuestrua me urdhër të Mbretit Zog dhe u përdor si qendra e Radio Tiranës deri më 1965. Më

pas u vendos Instituti i Folklorit, që është edhe sot.

Vila është katër katëshe, ku njëri kat është nëndhe. Që në konceptimim fillestar të saj, vila është simetrike me dy hyrje kryesore dhe një tjetër nga mbrapa, që del në oborr. Vihet re përdorimi i granilit të derdhur në shkallët e hyrjeve dhe ato të brendshme, mermerit në korridorin kryesor, hekurit të rrahur në parmakët e

shkallëve, drurit në dyer e dritare. Kasa e grilës është prej druri dhe është vendosur në mur nga ana e brendshme. Hapësirat janë të trajtuara me pllaka e dekorime të ndryshme. Ngrohja bëhet me kaldajë dhe radiatorë. Vila është neoklasike për shkak të përdorimit të tri kollonave të orderit të madh në lartësinë e dy kateve. Ato janë pa bazë dhe kapitete të stilizuara.



Order / Fotoqrafoi: A. Lushi



Pllaka



Ballkoni / Fotoqrafoi: A. Lushi



Parapet shkallësh



Fotografoi: A. Lushi

Vila nr. 17



Vila nr. 17 - Kartolinë e vitit 1932

Kjo vilë është ndërtuar në vitin 1932 dhe ka shërbyer gjithmonë si shtëpi banimi. Pronari i atëherëshëm ka qënë doktori Jakov Bogdani dhe sot kjo vilë është në pronësi të birrit të tij. Ndërtesa është dykatëshe dhe është e ndërtuar me stil ekletik. Në këtë vilë me


kalimin e viteve janë bërë ndryshime në interior dhe në fasada nga planet origjinale. Një nga këto ndryshime është ai i hyrjes. Më parë hyrja bëhej nëpërmjet oborrit nga ana e rrugës, ndërsa sot bëhet nga rruga, pasi oborri është zënë nga ndërtimet e reja.



Vila nr. 17, 2006



Ballkon me hekur të punuar



Pllaka



Detaj i daljes së çatisë

Panoramë e rrugës së “Durrësit”



Panoramë e rrugës së “Durrësit”, Vila nr. 3, Vila nr. 2 & Ministria e Mjedisit / Fotografia: D. Shamolli



Vila nr. 1, rruga “Durrësit”



Fotografoi: A. Lushi



Vila nr. 2, rruga “Durrësit”



Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 3, rruga “Durrësit”



Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 7, rruga “Kajo Karafili”



Vila nr. 9, rruga “Mihal Duri”



Vila nr. 16, rruga “Kavajës”



Fotografoi: G. Struga



Panoramë e rrugës “Mihal Duri”



Panoramë e rrugës “Mihal Duri” / Fotoqrafoi: A. Lushi



Detaje të vilës nr. 4



Detaje të vilës nr. 5

Fotografi të vilave



Vila nr. 6, rruga "Durrësit" / Fotografoi: A. Lushi



Vila nr. 14, rruga "Kont Urani" / Fotografoi: A. Ibrahim



Vila nr. 20, rruga "Xhemzi Delli" / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 30, rruga "Naim Frashëri" / Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 31, rruga “Naim Frashëri” / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 32, rruga “Halim Xhelo” / Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 34, rruga “Kavajës” / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 35, rruga “Kavajës” / Fotografoi: G. Struga

Fotografi të vilave



Vila nr. 11, rruga "Mihal Duri"



Vila nr. 12, rruga "Kont Urani" / Fotografoi: A. Lushi



Vila nr. 13, rruga "Kont Urani" / Fotografoi: A. Ibrahim



Vila nr. 18, rruga "Edit Durham" / Fotografoi: A. Lushi



Vila nr. 19, rruga “Halim Xhelo” / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 21, rruga “Xhezmi Delli” / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 22, rruga “Xhezmi Delli” / Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 23, rruga “Xhezmi Delli” / Fotografoi: G. Struga

Fotografi të vilave



Vila nr. 24, rruga “Xhezmi Delli” / Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 25, rruga “Gjon Muzaka” / Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 26, rruga “Naim Frashëri” / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 27, rruga “Gjon Muzaka” / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 28, rruga “Frederik Shiroka” / Foto grafoi: G. Struga



Vila nr. 29, rruga “Halim Xhelo” / Foto grafoi: G. Struga



Vila nr. 33, rruga “Naim Frashëri” / Foto grafoi: D. Shamolli



Vila nr. 36, rruga “Mihal Ciko” / Foto grafoi: D. Shamolli

ZONA 16

Universiteti POLIS


Përpunoi: Ada Lushi, Drilon Shamolli, Gerti Struga

Punuan: Genc Tufi, Blerti Bajo (vila 1), Orion Vesho (vila 3), Florid Virjoni, Andi Qerosi, Serdi Fejzullai



Tirana. Boulevard Zog I.

Zona 16



Pozicionimi i zonës në raport me qytetin / Punoit: G. Struga

Karakteristikat e Zonës

Kjo zonë është një ndër zonat më historike të qytetit pasi përshkohet nga një trajektore shumë e rëndësishme dhe e vjetër. Rruga e "Durrësit" është një nga rrugët më të vjetra të qytetit të Tiranës. Kjo rrugë ka qënë konsideruar vazhdimi i të famshmes Via Appia dhe realizonte lidhjen e pjesës lindore të territorit me perëndimin. Moment i veçantë i historisë së saj ka qënë drejtimi dhe dhënia e rëndësisë edhe nga ana

arkitektonike kësaj trajktoreje. Gjithashtu vlen të përmendet edhe rruga tjetër e vjetër, që përshkonte zonën, ajo e Shkodrës, e cila bënte të mundur lidhjen e veriut me jugun. Sot kjo rrugë nuk është ruajtur, megjithatë gjurmët e vjetra të saj mund të lexohen në qytet. Këto dy rrugë e kanë formësuar këtë zonë duke i dhënë vlera të veçanta. Për këtë, në vitet 30, kur u bë edhe drejtimi i saj sipas planeve italiane për rregullimin e qytetit, filloi edhe ndërtimi i objekteve të

Vendndodhja e vilave



reja, kryesisht i vilave. Këto ishin vila të ndërtuara nga arkitektë dhe në përgjithësi ishin të ndikuara nga arkitektura perandorake italiane, megjithatë mund të hasen elemente të arkitekturës moderne shqiptare. Shumë personalitete të kohës, që kanë shënjuar historinë e qytetit me përkushtimin e tij ndaj tij kanë jetuar pikërisht në këtë rrugë, në vila të tilla, si Omer Fortuzi. Rruga e “Durrësit” e ka ruajtur rëndësinë e saj dhe disa nga këto vila mund të shihen edhe sot.

Megjithatë, të tjera vila janë në gjendje të mjerueshme pasi mbeten të pabanuara për shumë arsye, të tjera janë shembur dhe i kanë lënë vendin ndërtimeve të tjera me një tipologji krejt të ndryshme.

Panoramë e rrugës së “Durrësit”



Panoramë e rrugës së “Durrësit”, Vila nr. 1, Vila nr. 2 & ish-Ambasada Jugosllave / Fotografoi: G. Struga



Studim Vila nr. 1



Vila është ndërtuar rreth viteve '30 me arkitekt dhe mendohet të jetë bërë për një familje të pasur të kohës duke gjykuar nga arkitektura. Sot ajo nuk është e banuar dhe është në gjendje të mjerueshme pasi asnjëherë nuk është vënë dorë mbi të. Ajo është tre kateshe, ku njëri nga katet është nëndhe dhe shërbente si bodrum. Bodrumi përbëhet nga dy dhoma, që ajrosen nga dy dritare secila, që nga jashtë janë trajtuar me parvaze të zbukuruara. Kati përdhe hyrjen e ka nëpërmjet një verande të madhe. Dera kryesore të drejton tek holli, i cili bën ndarjen e katër dhomave të vendosura në të dyja anët e tij, si edhe

realizon lidhjen në vertikalisht. Shkallët janë druri me një sheshpushim me parapet të zbukuruar. Kati i parë, gjithashtu, ka një holl me të njëjtat funksione, ndryshon vetëm në madhësi. Në këtë kat kemi tre dhoma, dy banjo dhe një verandë. Në pjesën fundore të katit ka një ballkon të vogël, i cili është trajtuar me një gjysmë hark me të njëjtin ritëm të verandës në hyrje. Vlen të përmenden edhe detajet e shumta, jo të ngarkuara të vilës, ndër to vendet e oxhakëve, veshjet e dyshemesë realizuar me parket dhe pllaka argjile të thara të zbukuruara me mozaikë, korniza që konturon çatinë, trajtimi i verandës dhe ballkonit.




Planimetri e katit përdhe



Planimetri e katit të parë

Studim Vila nr. 3





Vila gjendet në ishullin që formohet nga trajektoret rruga e “Durrësit”, rruga “Milaim Shuflein”, rruga “Mine Peza” dhe rruga “Fortuzi”, me fasadë balllore në drejtimin jugor dhe me dalje në rrugën e “Durrësit”. Vila u ndërtua më 1931, fillimisht për të shërbyer si Legata Turke dhe pas vitit 1945 u shndërrua në Ambasadën Jugosllave. Godina përbëhet nga dy kate dhe një i tretë në kuotën e çatisë. Në katin përdhe kemi katër hyrje, dy në fasadën balllore dhe dy në atë veriore; secila realizuar sipas një rendi hierarkik të caktuar. Në këtë vilë haset përdorimi i harqeve a sesto acuto, në hyrjen nga fasada balllore, që shkarkojnë forcat në katër kollona me bazë jonike, pa kanelura dhe me kapitele dorike. Ky element arkitekturor është zakonisht i gjetur në kishat gotike, për arsye se lejojnë futjen e dritës në ambientet e brendshme si dhe shtrirjen në lartësi. Hyrja dytësore është realizuar me hark Arabo Mauresk me hapësirë drite më të madhe se harqet në hyrjen e parë. Pas një farë kohe lënë në rrënoja, vila u restaurua. Megjithatë, kjo nuk është bërë në bazë të rregullave të restaurimit.

Krahasimi në kohë 2006-2011



Ish-Ambasada Jugosllave, 2006



Detaje të vilës nr 3



Ish-Ambasada Jugosllave, 2011 / Fotografoi: D. Shamolli



Detaje të vilës nr 3



Studim Vila nr. 20



Fotografoi: G. Struga



Vila Fortuzi u ndërtua në vitet 1920 nga Omer Fortuzi, pjesëtar i familjes së vjetër latifondiste tiranase. Omer Fortuzi ishte një nga pinjollët më të suksesshëm të kësaj familjeje. Ai ka qënë ndër të parët inxhinierë ndërtimi shqiptar dhe si kryetar i bashkisë së qytetit ka punuar për të vënë në jetë shumë projekte italiane për ndërtimin e kompleksit të ministrive, ndërtimin e vilës së mbretit Zog, në Durrës etj. Ndër këto përfshihet edhe ndërtimi i vilës Fortuzi, e cila për kohën ishte një objekt inovativ. Vila është trekatëshe me planimetri në formë L, ku shpërndarja e shërbimeve bëhet nga ana e brendshme e ndërtesës me anë të korridoreve të gjatë dhe shkallë të brendshme që ndodhen në qendër të objektit. Hyrja është e mbuluar dhe mbahet nga tre kollona, që përshkojnë lartësinë e dy kateve. Mund të themi se ka qasje organike pasi kemi zevëndësimin e këndit të drejtë me harqe të theksuar, e bashkuar kjo edhe me futjen më shumë të dritës në objekt. Kjo realizohet me anë të përdorimit të dritareve të mëdha vertikale e horizontale si edhe fasada me xham në katin e tretë. Gjithashtu, drita është e pranishme edhe në sheshpushimet e shkallëve. Përdorimi i dritës si element arkitekturor mori rëndësi të madhe në këtë periudhë në Shqipëri, pasi u përdor në shumë vila të periudhës. Ballkonet e mëdha të shfrytëzueshme janë tipike e kësaj vile.

Detaje të vilës nr. 20





Dysheme me granil të derdhur




Parapet shkalle prej druri

Vila nr. 13



Vila nr. 26



Panoramë e rrugës “Mine Peza”



Panoramë e rrugës “Mine Peza”, Vila nr. 6 dhe Vila nr. 5 / Fotografoi: D. Shamolli



Detaje të vilës nr. 5

Fotografi të vilave



Vila nr. 4, rruga "Mine Peza" / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 7, rruga "Fortuzi" / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 6, rruga "Mine Peza" / Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 8, rruga "Mine Peza" / Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 9, rruga "Mine Peza" / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 10, rruga "Sylejman Pasha" / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr. 11, rruga "Sylejman Pasha" / Fotografoi: G. Struga



Vila nr. 12, rruga "Sylejman Pasha" / Fotografoi: G. Struga

Fotografi të vilave



Vila nr 14, rruga "Mine Peza" / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr 15, rruga "Kongresi i Tiranës" / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr 17, rruga "Kongresi i Tiranës" / Fotografoi: G. Struga



Vila nr 18, rruga "Fortuzi" / Fotografoi: G. Struga



Vila nr 19, rruga "Mailiq Muço" / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr 22, rruga "Fortuzi" / Fotografoi: D. Shamolli



Vila nr 23, rruga "Zydi Caslli" / Fotografoi: G. Struga



Vila nr 25, rruga "Zydi Caslli" / Fotografoi: G. Struga

Bibliografi

- Fragmente Kulturore nga “Qytete Shqiptare” Epoka University, MTKRS, Eagle, Tiranë 2012
Robert Harbison “Travels in the History of Architecture”, Londër 2009.
Emin Riza “Qemal Butka”, Tiranë 2010
Marius le Pont, Un architecture dans le siècle “Temoignages”, 1998
Emin Riza “Banesa në Qendrën Historike të Beratit” (Arti & Trashëgimi. No.1)
Gwathmey Siegl, “Ten Houses” Report Plus, 1995
The Dessau Bauhaus Buildings, 1926-1999
Le Corbusier; Modulor, Paris 1979
F.L.L. Wriqh; New York, 1999
Elisabeth Cromley, “The Architecture of American Houses and its Interpretation”; Blackwell Plus, 2004.
S. H. Eldem - Turk Mimari ESERKLERI, Istambul 1980
Fumarola, Interieri Di Salento, Lecce 2005
E. Ignacio, Ville del Salento, Lecce 2006.
Kahreman Ulqini “Gjurmime të Historisë Kombëtare me fototekën e Shkodrës”, Tiranë 1982.
Ali Muka “Banesa Fshatare dhe Familja”, Tiranë 2001
Emin Riza “Banesa Popullore Shqiptare”, Tiranë 2010
Rykwert “La maison d’adam au Paradis”, Paris 1976
Di Nardo “Trace di un future” Aud No 11, 2008.
S. Muratori “Studi per un operante di Storia di Venecia”, Roma 1959
S. Giedon “Spacio Tempo e Architectura”, Cambridge, 1956.
H. P. Flug “Ecran, Tur, Colines”, Bernard- Paris 1971
Laugier “Essau sur L’architecture”, Paris 1753
W. Curtis “L’architectura Moderna” Phaidon, 1997
Bruno Zevi “Storia del architectura moderna”, Torino 1955.
L. Benevolo “Hytje në Arkitekturë”, Tiranë 2011
Pier Luigi Nervi “Construire Corretamente”, Milano 1955
A. Sartoria “Le construzioni del Decennio”, 1920-1930

